



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 2 DHE 15 MARS 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 2. I 15. MARTA 2018. GODINE**

**MARS - MART
2018**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stichting Spark-ut të Holandës (SPARK) për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim, ADA,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA),
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produkte të ndërtimit,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet postare,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për metrologji,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe,
18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën,
19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shoqëritë tregtare
20. Përzgjedhja e një (1) kandidati për pozitën e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
21. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e dy (2) anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,
22. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
23. Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa,
24. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/21, datë 22. 12. 2017 në lidhje me Pallatin e Rinisë në Prishtinë,
25. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Dhënie të Provimit të Jurisprudencës,
26. Debat parlamentar sipas kërkesës të nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe pesë (5) deputetëve nënshkrues për debat parlamentar lidhur me takimin IV të përbashkët të Komisionit Parlamentar të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, BE-Kosovë, i mbajtur më 17-19 janar 2018, në Strasburg (Francë),
27. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e deputetëve në komisionet parlamentare,
28. Formimi i Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari nga radhët e komunitetit shqiptar dhe dy (2) anëtarëve nga radhët e komuniteteve joshqiptare të Komisionit të Pavarur të Medieve.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Međunarodnog sporazuma između Ministarstva za obrazovanje, nauku i tehnologiju Republike Kosova, (MONT) i Stitching Spark-a iz Holandije (SPARK) o podršci Međunarodnom koleđu biznisa u Mitrovici,
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Međunarodnog sporazuma između Ministarstva za obrazovanje, nauku i tehnologiju Republike Kosova, (MONT) Austrijske agencije za razvoj ADA,
5. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma o osnivanju Regionalne škole za javnu administraciju (ReSPA),
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o rudnicima i mineralima,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-025 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-225 o državnom tužilaštvu, izmenjenog i dopunjenog Zakonom br. 05/L-034,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Inspektoratu obrazovanja u Republiku Kosova,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti potrošača,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona o građevinskim produktima,
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona o naučnim inovacijama i transferu znanja i tehnologije,
12. Prvo razmatranje Nacrta zakona o tehničkim zahtevima o proizvodima i proceni konformiteta,
13. Prvo razmatranje Nacrta zakona o poštanskim uslugama,
14. Prvo razmatranje Nacrta zakona o metrologiji,
15. Prvo razmatranje Nacrta zakona o slobodi pristupa nevladinim organizacijama,
16. Prvo razmatranje Nacrta zakona o krvi i sadržaju krvi,
17. Prvo razmatranje Nacrta zakona o zaštitnim merama na uvoz,
18. Drugo razmatranje Nacrta zakona o glavnom gradu Republike Kosova/Prištinu,
19. Drugo razmatranje Nacrta zakona o trgovačkim društvima,
20. Izbor (1) kandidata za funkciju Guvernera Centralne banke Republike Kosova,
21. Razmatranje Predloga - Odluke Vlade Republike za imenovanje dva (2) člana borda Kancelarije regulatora energetike,
22. Izbor dva (2) člana Borda RTK-a,
23. Izbor jednog (1) člana Borda za žalbe,
24. Razmatranje Predloga – Odluke Vlade Republike Kosova br. 07/21 od 22.12.2017.god. u vezi Palate omladine u Prištini,
25. Razmatranje Predloga - Odluke Vlade Republike za imenovanje članova Komisije za polaganje pravosudnog ispita,
26. Parlamentarna rasprava na zahtev potpredsednika Skupštine g-dina Kujtim Shala i pet poslanika potpisnika za parlamentarnu raspravu u vezi IV zajedničkog susreta Parlamentarne komisije za Sporazum za stabilizaciju i pridruživanje EU-Kosovo, održanog 17-19 januara 2018.god. u Strazburu (Francuska),
27. Razmatranje predloga PG “Lëvizja Vetëvendosje”, za zamenu poslanika u parlamentarnim komisijama, i
28. Formiranje ad-hoc komisije za izbor člana iz redova albanske zajednice i dva člana iz redova nealbanskih zajednica u Nezavisnoj komisiji za medije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2018.

77 deputetë janë aktualisht në sallë.

Para se të futem në pikat e rendit të ditës, ne kemi sot një mori projektligjesh për trajtim.

Unë kisha dashur, kam pasur edhe si kërkesë nga disa kolegë deputetë, në qoftë se dëshironi, me marrëveshje mund ta përcaktoj kohën e votimit. Kohën e votimit kur i trajtojmë projektligjet i përcaktojmë dy raste, në qoftë se pajtoheni ju, në orën 16:00 votimin e parë të të gjitha projektligjeve të trajtuara dhe në orën 19:00 votimin e dytë. Të gjitha projektligjet që trajtohen sot, sepse sigurisht seanca do të vazhdojë deri vonë.

Janë vetëm pyetje parlamentare mbi 30, për fillim janë projektligje dyshifrorë. A dëshironi në këtë mënyrë, që deputetë ta dinë saktësisht kur do të jetë koha e votimit.

Urdhëro, zoti Avdullah Hoti, flisni edhe në emër të grupeve parlamentare, kolegë.

AVDULLAH HOTI: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në mbledhjen e Kryesisë ne kemi kërkuar tekstualisht që të mos ngarkohet seanca me kaq shumë ligje, sepse kjo seancë, si është kështu, tri ditë nuk mund të kryhet, po sido qoftë, Kryesia ka vendosur, ne do ta respektojmë atë.

Ne kërkojmë që seanca të zhvillohet normalisht, sipas pikave të rendit të ditës, pas çdo ligji, të organizohet votimi.

KRYETARI: A ka mundësi të kem deklarinimin e grupeve parlamentare, për arsye se deputetët duhen për kuorum, në momentin kur votohen, pastaj po lëvizin në momente të caktuara, disa kanë interes për të diskutuar për një projektligj, disa të tjerë për projektligjin tjetër.

Më lejoni të theksoj vetëm faktin e praktikave ndërkombëtare. Në shumicën e vendeve të botës kjo lejohet. Është çështje juaja, vetë jeni deputetë, unë do të jem me ju krejt kohën, varet prej jush si deputetë. Kush e dëshiron fjalën? Lëvizja “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Ne nuk duhet të harrojmë që kjo po na ndodh edhe për një arsye tjetër, për shkak që ka disa javë po na humb kjo seanca për demarkacionin, e cila nuk po përfundon kurrë. Duke u përqendruar vetëm në të, na kanë humbur nja katër apo pesë javë, në të cilat do të mund të shpërndaheshin krejt këto pika të ditës dhe do të mund t'i kishim përfunduar gradualisht.

Kështu, duke u përqendruar në një seancë, e cila nuk po përfundon që një muaj e sa, natyrisht që janë bërë 30 pika tash në rendin e ditës, të cilat unë nuk besoj fare që do të mund t'i përfundojmë brenda ditës së sotme. Mirëpo, prapëseprapë unë mendoj që duhet ta ndjekim praktikën të cilën e kemi pasur, që paralelisht me diskutimin, në fund të përmbylljes së diskutimeve, të shkohet me votimin e ligjeve.

KRYETARI: Faleminderit! Partia Demokratike e Kosovës, Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë mendoj që propozimi juaj është pragmatik dhe aspak i jashtëzakonshëm, sepse në fund të fundit, pikërisht në këtë Kuvend dhe në këtë legjislaturë ka pasur edhe raste të tjera kur ne kemi ezauruar të gjitha diskutimet për një sërë pikash dhe në fund kemi votuar, kur ka pasur shumicën e nevojshëm të deputetëve. Arsyja besoj e propozimit ndërlidhet me faktin e përvojave tona të përditshme në seancat që po i mbajmë kur ndonjëherë pikërisht për shkak të mungesës së deputetëve pas diskutimeve për një pikë të rendit të ditës, ne nuk po kemi shumicën, meqenëse po janë nën 61.

Ne si Grup Parlamentar do të jemi gjatë gjithë ditës këtu, po ashtu nëse ka disponim edhe nga grupet e tjera, ne do ta mbështesim dhe, përkundër faktit që kemi kaq shumë pika të rendit të ditës, edhe do të ishte më mirë ndoshta që të ketë më pak, prapë kjo nuk është e jashtëzakonshme tek e fundit janë pika të cilat i kanë përmbushur procedurat dhe është obligim yni që t'i trajtojmë edhe nëse janë 30, edhe nëse janë 20, edhe nëse bëhen 50 në të ardhmen.

Kështu që për hir të menaxhimit më të mirë të procesit dhe të kohës, ne pajtohemi edhe nëse mbetet që në orën 16:00 të votohen të gjitha projektligjet dhe pikat e tjera, të cilat kryhet debati dhe shqyrtimi i tyre deri në atë kohë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

AHMET ISUFI: I nderuar kryetar,

Edhe ne pajtohemi me kohën që e paraqitët ju për votim. Faleminderit!

KRYETARI: Kolegët e "Nismës", Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Kolegë të nderuar,

Qytetarë të nderuar,

“Nisma” po ashtu mbështet idenë që votimet të bëhen në një kohë të caktuar, mirëpo fakti që janë grumbulluar shumë pika në këtë seancë, s’ka të bëjë veç me seancën për demarkacionin, por edhe me debatet e shpeshta parlamentare që po e marrin nga një ditë, edhe me interpelancat e shpeshta, se opozita e fortë dhe po ka tema të ngritura një interpelancë, edhe atë e kanë bërë që çështjet e rëndësishme, siç janë miratimi i ligjeve, diskutimi dhe miratimi i tyre të dalin në plan të dytë. Mendoj që është koha e fundit që të bëjmë detyrën tonë për të cilën jemi këtu, të miratojmë ligje dhe të ratifikojmë marrëveshje, siç është për shembull, kjo e Ministrisë së Arsimit, të cilin sot e kemi në rend të ditës.

Pra, është mirë që të gjithë së bashku të merremi vesh t’i kthehemi detyrës parësore që e kemi si deputetë, ajo është kalimi i ligjeve në Parlamentin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, Albert, urdhëroni!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah këtë propozim tuajin, duke pasur parasysh se shpesh po na ndodh që rastet e caktuara kur duhet të ndodhë votimi, deputetët mungojnë, mirëpo ne mendojmë që duhet një harmonizim apo një marrëveshje mes grupeve parlamentare që kjo ide të realizohet.

Ne jemi për këtë idenë tuaj, është e mirëseardhur, e qëlluar dhe me vend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo praktikë, të cilën do ta vej tash në votim, është kërkesë e shumë deputetëve, të cilët duan ta dinë momentin kur duhet të jenë aty për votim. Edhe të kaluarën na ka ndodhur shumë raste, për projektligje të caktuara, në momentin e caktuar nuk ka pasur kuorum, pastaj në fund të ditës ose në ditën e nesërme i kemi votuar të gjitha bashkërisht. Sido që të jetë, është vendimi juaj, unë e bëra kërkesë pas një kërkesë të disa deputetëve nga të gjitha grupet parlamentare.

Votoni vetë po, jo. Përgatitem për votim, në orën 16:00 votimi i parë për projektligje të cilat janë shqyrtuar deri në atë moment, asgjë nuk përshpejtohet procedura e diskutimit, shkohet me rregull. Në qoftë se edhe asnjëri projektligj nuk ka kaluar deri në orën 16:00, nuk e vendosim asnjë. Pastaj në orën 19:00 është votimi i dytë, po ashtu në këtë seancë plenare për sonte. Ndërkohë pas orës 16:00 së bashku me ju votimin e fshehtë e bisedojmë kur dëshirojmë, në bazë

të dinamikës të trajtimit të projektligjeve, a dëshironi brenda orës 16:00 deri 19:00 të futemi në votim të fshehtë apo dëshironi pas orës 19:00, kjo do të jetë vendimmarrja juaj.

Përgatitemi për votim, kush është që këta terminë të përmbahen për votimin e projektligjeve, të cilat janë shqyrtuar. Votojmë tash:

Faleminderit! 46 deputetë kanë votuar, 42 për, 4 kundër.

A ka abstenim? Nuk ka.

Prezentë ishin 77.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, vendimmarrja e Kuvendit është se do të votojmë çdo projektligj, ta shohim sa janë korrektë deputetët të qëndrojnë, sa kemi kuorum, t'i shohim. Po këta të cilët kanë votuar, dihen, publike do të jenë.

Ta shohim sa jemi korrektë me atë çka deklarojnë për hir të konsumit publik.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

80 deputetë janë në sallë.

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, ora është 10:55, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Nezir Çoçaj deklarohet në emër të kujt e merr fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar i Kuvendit!

Unë fjalën e marr në emër timin personal si deputet, jo në emër të grupit. Faleminderit për mundësinë!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja që dua të ngre sot ka të bëjë me shqetësimin e shumë qytetarëve të Prizrenit lidhur me qentë endacakë, të cilat janë të shumtë në disa lagje të Prizrenit, e në veçanti në lagjen “Bajram Curr”.

E theksoj lagjen “Bajram Curr” për arsye se në këtë lagje gjenden tri shkolla, një shkollë fillore dhe e mesme e ulët, dy shkolla të mesme të larta dhe katër supermarkete, po ashtu gjendet tregu

dhe Qendra e regjistrimit të automjeteve që nënkupton një frekuentim jashtëzakonisht të madh të qytetarëve.

Rreziku më i madh është për nxënësit që gravitojnë në këtë lagje për të shkuar në shkollë, gjegjësisht qytetarët të cilët kalojnë nëpër këtë lagje apo frekuentojnë këto qendra tregtare, gjegjësisht për ata të cilët, sidomos në kohë të mëngjesit, shkojnë për të falur mëngjesin në xhami.

Dihet fare mirë se qentë po gjejnë ushqime të mjaftueshme nga hedhja e mbeturinave, kockave të ndryshme apo mishrave, të cilat hedhen nga këto markete.

Në të kaluarën ne kemi pasur hasur jo vetëm në Prizren, po edhe në disa qytete të Kosovës ka pasur kafshime, të cilat kanë qenë edhe me fatalitet. Pos kësaj të gjithë e dimë që mjafton vetëm frika e madhe e nxënësve kur kalojmë për të shkuar në shkollë dhe anasjelltas. Imagjinojeni si mund të koncentrohen nxënësit gjatë orarit të mësimit që mbajnë në shkollë.

Po ashtu nuk është kohë e gjatë që kanë përfunduar zgjedhjet edhe qendrore, e sidomos ato lokale, kur të gjithë jemi të vetishëm për premtimet e kandidatëve për kryetarë të komunave që kanë premtuar për strehimoret dhe përkujdesjen e qenve, por deri më tani nuk ka ndodhur asnjëherë.

Prandaj, i lus mekanizmat, Agjencinë e Veterinës dhe Ushqimit si dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike që të merren me këtë çështje për të bërë një zgjidhje sa më të shpejtë dhe sa më të volitshme për qytetarët. Faleminderit!

KRYETARI: Xhelal Sveçla flet në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”.

XHELAL SVEÇLA: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, Skandalet e njëpasnjëshme të drejtuesve dhe segmenteve në Policinë e Kosovës, përfshirë edhe segmentet prokurorisë e gjyqësisë, nuk po ndalen.

Edhe pa u harruar skena e rrahjes në qendër të Prishtinës, plasën skandalet si ai i regrutimit të inspektorëve të rinj në Inspektoratin Policor.

Përgjime herë me autorizim e herë pa të, arrestimi i dy policëve të nacionalitet serb në Policinë e Kosovës dhe arrestimet e zyrtarëve policorë të përfshirë në trafikim të narkotikëve.

Sigurisht që në asnjë çast nuk duhet harruar e nënvleftësuar kontributi i zyrtarëve policor të ndershëm e kurojozë për shoqërinë tonë.

Por mbi reagimet kur policia paraqitet si imune ndaj dukurive që përshkruajnë krimin e organizuar, të lidhur me konjunkturën e pushtetit, nuk është naivitet, por fshehje e qëllimshme e krimit.

Edhe reagimet nervoze ndaj reagimit të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe deputetit Selimi vetëm sa rrisin dyshimet edhe e bëjnë urgjente nevojën për mbikëqyrje strikte të këtij institucioni.

Sa u takon skandaleve në Inspektorat, Grupi Punues i Komisionit Parlamentar për Siguri ka filluar punën në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në këtë institucion.

Aktualisht mund të paralajmëroj të gjetura që vërtetojnë atë që e kemi thënë prej vitesh: gjendje e tmerrshme.

Në këto kushte i kam disa pyetje për Drejtorin e Përgjithshëm, zotin Shpend Maxhuni.

Njëri nga zyrtarët e përfshirë në rrahjen e drejtorit të postës dhe shoqëruesit të tij është ushtrues detyre i drejtorit të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion, Nazim Sahiti, i cili herë na paraqitet si i dyshuar, e herë si dëshmitar, herë kërkohet suspendimi i tij, e herë lejohet të punojë në funksionin aktual, varësisht linjës komanduese ilegale brenda Policisë.

Zoti Maxhuni, a e ka kaluar Nazim Sahiti verifikimin e AKI-së që bëhet për zyrtarë të lartë të sigurisë. Nëse jo, pse jo?

Së dyti, pse nuk është marrë parasysh vlerësimi negativ i AKI-së?

Sipas krimeve në media, a ka punuar Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, domethënë ju, së bashku me Nazim Sahitin tek Florim Maloku, i cili njihet si Flloki i arrestuar në Shkup për plaçkitje të “ProCredit Bank”-ës.

A ka qenë drejtor po në këtë drejtori Emin Beqiri, i suspenduar për dyshime në përfshirje në veprë kriminale që ka lidhje me punën e tij?

Në po të njëjtën drejtori, a ka punuar tashmë i suspenduari, ish-shefi ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës, zoti Ilmi Mehmeti, i cili vetëm sa ka ngritur pozitën e tij paraprake në këtë drejtori, apo më mirë të thuhet në këtë superdrejtori.

Nëse mes kreut të Policisë dhe drejtorisë për të cilën po flasim janë edhe tri hallka të ndërmjetme në hierarki, pse ne në vazhdimësi dëgjojmë lajme për këtë drejtori, pra Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsion, e nuk dëgjojmë e s’dimë asgjë për nivelet e tjera të ndërmjetme?

Tash një çështje që u takon edhe drejtuesve të Policisë si dhe Kryeprokurorit. Si ndodhi që dy policët në veri një herë arrestohen e pastaj lirohen, përkundër faktit se këta nga vendi i krimit vodhën gëzhjën e plumbit që vrau Oliver Ivanoviqin?

Të njëjtët ilegalisht ia dërguan forenzikës në Beograd, me ç'rast efektivisht MUP-in e Serbisë e kyç në hetimin e vrasjes së Ivanoviqit. Çka po ndodh me këtë rast?

Këto janë vetëm pak, shumë pak nga bëmat e rrjetit të krimit të organizuar në Polici e Prokurori.

Nuk ka as zhvillim vendor, e as integrim evropian sa herë, të nderuar deputetë, ju dhe subjektet tuaja heshtni dhe i nënshtroheni kësaj gjendjeje të padurueshme të kriminalitetit brenda institucioneve tona të sigurisë. Faleminderit!

KRYETARI: Zafir Berisha, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Unë do të merrem me një çështje shumë të rëndësishme për shoqërinë, edhe pse ky Kuvend është duke u marrë me gjëra madhore në këtë dimër të ftohtë me politika të nxehta, sido që të jetë, shoqërinë tonë përveç miqve e kanë kapluar edhe shumë probleme me të cilët duhet të merret edhe Kuvendi, po veçanërisht ekzekutivi i vendit. Unë mendoj se është momenti i fundit që të ndërhyhet në fenomenet negative në shoqëri, konkretisht në fenomenin e drogës, i cili tashmë është bërë më shumë se shqetësim për çdo familje në vendin tonë. Droga si dukuri devijante dhe fenomen tepër shqetësues e negativ, tashmë nuk mund të thuhet se është problematikë e qyteteve, përderisa i ka kaluar edhe kufijtë e qyteteve dhe është bërë problematike edhe në pjesët rurale.

Qeveria e vendit sa nuk është bërë vonë mendoj se duhet të marrë hapa konkretë dhe t'i ashpërsojë metodat e veprimit të organeve përkatëse për të luftuar këtë fenomen, sepse ky fenomen po prek në mënyrë të padrejtë edhe adoleshentët, po edhe më ulët se adoleshentët. Të dhënat tregojnë se përdoruesit e substancave narkotike janë edhe fëmijët 13 a 14-vjeçarë dhe nëse ne si shoqëri nuk ndërhyjmë në këto momente, dyshoj se dikur do të bëhet vonë. Në këtë kontekst kryeministri, Qeveria me të gjitha mekanizmat mendoj që ta ketë një program kombëtar për luftimin e këtij fenomeni, siç thashë, duke i ashpërsuar masat për shitësit dhe stërshitësit. Paralel me këtë, duke ndërtuar e funksionalizuar institucione për rehabilitimin e personave, të cilët tashmë janë përdorues kronikë të substancave narkotike.

Në qoftë se vonohemi në këtë drejtim, shoqëria do të ketë shumë probleme, duke përfshirë bërthamën e shoqërisë, familjen, siç është edhe duke ndodhur dhe kosto e rehabilitimit të personave, të cilët tashmë janë përdorues të substancave narkotike, do të jetë e madhe, e në një moment edhe e papërballueshme.

Siç e dimë të gjithë, përdoruesit e drogës dalin nga vetvetja dhe në momentin që dalin nga vetvetja, ju e dini si të gjithë qytetarët që situata sociale ekonomike është e atij niveli që përdoruesit e drogës të kalojnë edhe në kriminalitet, siç edhe ka kaluar një pjesë e madhe. Pra, mendoj se këtë fenomen negativ, këtë dukuri shqetësuese duhet ta luftojmë në rrënjë për të mundur t'i parandalojmë edhe fenomenet e tjera në shoqëri.

KRYETARI: Faleminderit! Islam Pacolli, fjala për ju.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar!

Përshëndetje, kryeministër!

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Kor diplomatik,

Medie,

Sot po më duhet ta bëj një kërkesë dhe një sqarim rreth çështjes së rrugës që është folur disa ditë më herët, rrugës që lidh Lipjanin, Bresalcin, Gjilanin, Dheun e Bardhë. Do t'ia bëja një lutje kryeministrit që të reflektojë, ta shqyrtojë, nëse gjejnë hapësirë për ndryshimin e kësaj çështjeje, edhe ministrit të Infrastrukturës, pasi që kjo rrugë që lidhet pikërisht në Lipjan, një qytetari që vjen nga Gjilani i zgjatet për dhjetë kilometra rruga. Merreni me mend, brenda dhjetë vjetësh është një kosto e rrugës komplet, një.

E dyta, fatkeqësisht, nuk lidh diçka kjo rrugë. Do të thotë, komplet ana e Gollakut, regjioni i Gollakut, është anashkaluar, ku ka qenë dhe është bërë projekti i kësaj rruge më herët, për 10 km është më e shkurtër për qytetarin dhe lidhet direkt me Prishtinën. Duke marrë parasysh që kjo rrugë tani që është aty e ndan edhe pjesën që lidhet me Ferizajn, Pozharan, Viti e Gjilanit, Kllokoti që lidhet me Gjilan. Do të thotë, do të ishte mirë të bëhet një reflektim, një shqyrtim i kësaj dhe të mos mbetemi ne si regjion të anashkaluar, se pastaj kjo rrugë pikërisht do të anashkalojë pjesën e Pozharanit, Vitisë së Gjilanit dhe deri në Gjilan me Kllokot që është e përfshirë dhe kjo pjesa tjetër e Gollakut. Duhet përkujtuar që regjioni i Gollakut i ka 4 miniera, 2 tani janë aktualisht funksionale, e 2 jo. Do të thotë, Miniera e Ajvalisë, Miniera e Kishnicës, Miniera e Artanës dhe ish-miniera e Strezovcit. Do të thotë, me gjithë këto pasuri dhe ne as infrastrukturën nuk po mund t'ua ofrojmë. Me vite të tëra nuk është bërë asnjë investim.

I kërktoj kryeministrit që të reflektojë në këtë drejtim dhe bashkë me ministrin e Infrastrukturës, me Kabinetin qeveritar, ta gjejnë një zgjidhje. Ju kish lutur shumë, nëse ka mundësi ende të ndryshimit, për arsye se me të vërtetë jemi të anashkaluar, nuk jemi në infrastrukturë dhe krejt kjo rrugë që është devijuar atje nuk i përfaqëson as 20 shtëpi. Do të thotë, është gjithë ai investim, lidhet rruga atje në Lipjan...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Islam, më vjen keq! Slobodan Petroviq, fjala për ju.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani predsedniče,

Poštovani predsedniče Vlade,

Ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Pre nešto otprilike dva meseca ubijen je Oliver Ivanović. Ono što je potpuno poznato svima da je od tada ne samo srpska zajednica, nego svi građani na Kosovu se osećaju, imaju dozu straha.

Ono što sam hteo pre svega da kažem kao, kao... danas u mojim javljanjem, imaću na kraju krajeva i pitanje i za premijera i za ministra Policije, jeste upravo poslednja runda dijaloga u Briselu između Beograda i Prištine, ono što je bio slučaj da upravo zbog ubistva Olivera Ivanovića je dovedeno bilo u pitanje i održavanje nastavka dijaloga i da se tada govorilo da će na tom procesu se pričati o ubistvu Olivera Ivanovića, odnosno o načinu pronalaženja počinioca. Tako da je iz Beograda stigla informacija da će na tom sastanku biti ljudi iz bezbednosnih struktura. Ono što imamo kao rezultat jeste jedna izjava potparola Evropske Komisije, Maje Kocijančić, koja između ostalog kaže da se razgovaralo o sporazumu o slobodi kretanja, zajedničkom upravljanju granica IBM-a, pravosuđu, asocijaciji zajednica opština, mosta u Mitrovici i energetici, ali nijedna jedina reč nije bila o ovom ubistvu.

Ono što mene, kao i većinu građana, ne samo Srpske zajednice brine, jeste upravo nečinjenje ili gotovo veoma malo se radi na pronalaženju počinioca, odnosno nalogodavca. Želim još jednom da kažem da ću na narednoj sednici postaviti i poslaničko pitanje na ovu temu, jer prosto ovo je tema koja ima širi značaj, koja je vezana ne samo za bezbednost, nego uopšte za sve procese. Zato sam želeo da sa ovog mesta izrazim svoju zabrinutost, pre svega zbog činjenice da i Evropska Unija, koja je moderator ovih dogovora u Briselu, da po ovom saopštenju koju je dala potparol Evropske Komisije, da se nijedna jedina reč progovorila na ovom poslednjem sastanku u Briselu. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit! Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të ndaj një shqetësim lidhur me kategorinë e fëmijëve të prekur me fibrozë cistike.

Është një sëmundje e rrallë që ka një kosto të papërballueshme për qytetarët e Republikës së Kosovës. Trajtimi për këtë sëmundje është tejet i kushtueshëm dhe si rrjedhojë shumë familje detyrohen që t'i dërgojnë fëmijët e tyre jashtë vendit.

E kam kontaktuar Shoqatën për fibrozë cistike, të cilët i kanë pasur edhe disa kërkesa që i kanë adresuar në Ministrinë e Shëndetësisë për t'ua lehtësuar veçanërisht prindërve që kanë fëmijë të sëmurë dhe të prekur me fibrozën cistike. Ata kanë kërkuar që të ketë mundësi që të dërgohen mjekë, të cilët do të trajtoheshin jashtë vendit për t'u marrë dhe për të trajtuar pacientët në Kosovë. Është kërkuar, po ashtu, edhe përfshirja e barnave në listën esenciale, ndonëse e thashë edhe në fillim, se kostoja është tepër e lartë, por është kërkuar që për të pasur lehtësira familjet të futen medikamentet e nevojshme në listën esenciale.

Në të ardhmen, institucionet, e veçanërisht Ministria e Shëndetësisë duhet të shohë edhe mundësinë që të krijojë një repart të veçantë për fibrozë cistike, një repart që duhet të jetë i ndarë nga Reparti i Pediatrisë, për shkak se kjo është sëmundje trashëguese dhe këta fëmijë kërkojnë një trajtim të veçantë, e në shumicën e rasteve mungojnë edhe barna që janë të dedikuara për këtë sëmundje.

Janë 8 lloje të barnave për trajtimin e kësaj sëmundjeje dhe kostoja financiare në baza mujore për familjet që kanë fëmijë të prekur me fibrozë është 1 600 euro, prandaj konsideroj se Ministria e Shëndetësisë duhet të shohë mundësinë që në të ardhmen t'i ndihmojë sadopak këto familje. Janë gjithsej 105 familje në Kosovë që kanë fëmijë të prekur me fibrozë dhe meqë buxheti për Ministrinë e Shëndetësisë është rritur nga 24 në 30 milionë, do të thotë është mundësi e mirë që të kenë parasysh edhe këtë kategori të fëmijëve të prekur me fibrozë në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Frashër Krasniqi e ka fjalën.

FRASHËR KRASNIQI: Të dashur qytetarë të Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Siç mund ta dini, të hënën që shkoi Gjykata e Apelit i liroi katër aktivistët e “Vetëvendosjes”, duke përfshirë edhe mua, nga rasti i montuar gjyqësor që na ka hipur mbi qafë gati tash e dy vjet.

Unë sot sinqerisht kam dalë këtu që t'ju shoh edhe një herë fytyrat juve deputetëve të PDK-së, e disa edhe prej juve të LDK-së, dhe t'jua bëj disa pyetje në mënyrë shumë të sinqertë.

KRYETARI: Regjia, ndalja fjalën! Ndale fjalën dhe shko në vend, edhe patriotizëm po na shet, a? Ndale fjalën, regjia, shko, kthehu në vend! S'i ke. E kreve.

Ndalet fjala. S'do të flasësh sa të jem unë kryetar sot. Po flas tash për treminutëshin. Andin Hoti e ka fjalën.

ANDIN HOTI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

Gjatë takimeve që kam pasur me familjarët dhe të tjerët që vijnë nga Turqia, kam hasur në një kërkesë të tyre që për mua është shumë e drejtë. Shqiptarët të dëbuar kohë më parë, do të thotë mbi 60 a 70 vjet, në Turqi, qoftë nga presioni i ndryshëm i ish-Jugosllavisë, apo nga arsye të tjera, siç është varfëria, nuk e kanë harruar gjuhën, traditën dhe kulturën tonë, duke i ruajtur me fanatizëm.

Kërkesa ose ankesa e tyre ka të bëjë me nënshtetësinë e Kosovës, sepse po hasin në vështirësi të shumta për të pasur nënshtetësinë e Kosovës. Kisha dashur, si Qeveri ta shqyrtoni mundësinë e lehtësive të procedurave, qoftë edhe përmes plotësimit-ndryshimit të ligjit apo edhe përmes dekretit t'u lehtësohet marrja e nënshtetësisë. Është obligim yni kombëtar, por edhe shtetëror që t'i trajtojmë në mënyrën më të mirë të mundshme bashkatdhetarët tanë, kudo që janë. Faleminderit!

Dhe, e dyta, që mendoj se është e rëndësishme prapë për këtë Parlament, mendoj se ne si deputetë kemi të drejtë të japim mendimin tonë për dialogun me Serbinë, që është biseduar edhe më herë këtu. Prandaj, kërkoj që të debatohet edhe në këtë sallë lidhur me tematikat që trajtohen në Bruksel. Dje kam dashur të marr një iniciativë që të futet në agjendën e bisedimeve edhe çështja e të zhdukurve, mirëpo kuptova se një kërkesë e tillë është bërë disa herë në këtë sallë nga disa deputetë të ndryshëm, por një temë, tematikë e tillë, nuk është biseduar ende në Bruksel. Prandaj, kërkoj që edhe çdo tematikë që bisedohet në Bruksel, të trajtohet edhe në këtë sallë. Faleminderit!

KRYETARI: Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Në radhë të parë dëshiroj ta sqaroj për opinionin lidhur me vizitën tonë në Mal të Zi. Ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës e kishim planifikuar atë vizitë dhe ne kemi ardhur në orën 16:00 në Prishtinë, por gjatë rrugës na kanë njoftuar se është shtyrë seanca, pasi që edhe zoti Behxhet Pacolli kishte paralajmëruar që nuk do të ketë votim, kështu që, kryetar i nderuar i Parlamentit, nuk ka qenë faji ynë, ne kemi qenë të gatshëm të votojmë edhe vota jonë është për, prapë po e deklaroj publikisht, kjo e para.

E dyta, dëshiroj t'i them Lidhjes Demokratike të Kosovës se ne, grupi "Nisma", dje kemi votuar për rezolutën tuaj dhe në bazë të një marrëveshjeje ka mundur të tejkalohet ai problem, mendoj që duhet të kemi bashkëbisedim në të ardhmen dhe t'i tejkalojmë problemet e bllokimit të njëri-tjetrit. Krejt në fund, kam një apel për kryeministrin e Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, që pavarësisht vendimit të Këshillit ndërministror që t'ia vazhdojnë mandatin edhe për tre muaj drejtorit të Postë-Telekomit të Kosovës, Agron Mustafës, i cili e ka shkatërruar Postë-Telekomin

dhe e ka fundosur, në bazë të raportit të auditorit, të mos e bëjë një veprim të tillë, pasi që është edhe kërkesë e Sindikatës së punëtorëve të Postë-Telekomit të Kosovës.

Gjithashtu, ky Këshill ndërministror, duhet ta dinë tani mediat, ka bërë falsifikimin e procesverbalit, duke mos e shënuar në procesverbal deklaratën e ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, zotit Bajram Hasani, i cili tekstualisht ka kundërshtuar vazhdimin e mandatit dhe ka thënë që nuk mund t’ia vazhdojmë mandatin një njeriu siç është Agron Mustafa që e ka shkatërruar Postë-Telekomin e Kosovës dhe që në listën e tij, përpos që është nën hetime të prokurorisë, ka plot skandale. Prandaj, u bëj thirrje edhe deputetëve të “Vetëvendosjes”, zoti Sveçla tha që ta kalojnë testin grupi hetimor, unë i nderuar koleg, të kallëzoj që edhe shefi i Policisë, drejtori i Policisë, vetë Shpend Maxhuni, nuk e ka kaluar atë testimin e famshëm, sepse testimet këtu bëhen vetëm në bazë të jaranisë, po jemi jarana, e kalon, po s’jemi unë e ti jarana, nuk e kalojmë. Prandaj, kjo ishte e tëra, edhe një herë, zoti kryeministër, bllokojeni një vendim të atillë dhe merr masa që të mos shkatërrohet Postë-Telekomi i Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!

Për arsye se jemi në përfundim të kohës, zoti deputet, mbledhja e Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur një ditë më herët, ka kërkuar që të kthehen deputetët të martën. Nuk jeni kthyer, jeni me shpenzimet tuaja, keni ndenjur për dëshirën tuaj, kjo është ajo çfarë dua të them. Jeni munduar të postoni foto patriotike nga ajo pjesë, ajo çështje e cila është e drejtë e juaja, rrogat s’i keni të këqija, por mëditja edhe qëndrimi atë natë, pastaj edhe bllokimi i Administratës së Kuvendit ka ndodhur, për hir të opinionit publik, për shkak të komisionit. Ky ka qenë një gabim, i cili nuk është mirë të përsëritet, a e votoni a s’e votoni është çështje juaj pastaj, kur vini, se aty keni qenë të të gjitha partive. Faleminderit!

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 39 pyetje parlamentare. Fillojmë me pyetjet e para nga seanca e mëparshme. Deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për ministren Albena Reshitaj. Urdhëro, deputet, se s’po dëgjohesh, e sqaron edhe në qoftë se e keni kryer.

HAXHI AVDYLI: Unë këtë pyetje e kam bërë, edhe pse s’ka qenë ministria, por po e përsëris edhe një herë. Ka të bëjë me një lumë që kalon nga Suhareka në disa fshatra të Anadrinisë dhe derdhet në Drinin e Bardhë, është lumi Toplluha, i cili gjatë sezonit të vjeshtës, për shkak edhe të keqpërdorimit të zhavorrit dhe ndotjes, për shkak të derdhjes së ujërave të zeza gjatë sezonit të vjeshtës dhe pranverës po shkakton dëme të mëdha në këto fshatra, të cilat janë kryesisht bujqësore dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me këtë lumë.

Pyetja ime ka qenë për ministren: a keni plan të ndërmerrni diçka për revitalizimin e këtij lumi? Çka do të ndërmerrni që të ndaloni derdhjen e ujërave të zeza dhe shkatërrimin e mëtutjeshëm të këtij lumi, i cili meqenëse edhe ministrja vjen edhe ajo zonë, e njeh mirë këtë lumë. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja ministre, fjala për ju.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar i Parlamentit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Lumenjtë e Republikës së Kosovës janë pasuri shtetërore e vendit, ekzistojnë hartat e sakta kadastrale dhe secili lumë ka rrjedhën e caktuar. Andaj, çdo degradim, çdo shfrytëzim i tij jashtëligjshëm është i dënueshëm. Referuar kërkesës së deputetit Avdyli për shqetësimin e banorëve të disa lokaliteteve të rajonit të Anadrinisë të fshatrave të komunës së Prizrenit, të banorëve të Mamushës dhe disa fshatra të komunës së Suharekës jemi në dijeni lidhur me ndikimet negative në shtratin dhe brigjet e lumit Toplluhë.

Nga informatat e marra paraprake prej komunave nëpër të cilat kalon ky lumë, vendet më të rrezikuara nga ngritja e nivelit të ujërave që ndodhin më së shumti janë fshatrat Piranë, Zojzë, Medvec, Arbanas, Smaq, Mamushë, Studenqan, Nepërbisht, Samadraxhë, Reshtan, Fushë e Therandës dhe në disa vende të tjera në përmasa më të vogla. Sa i përket trajtimit të kësaj çështjeje, më 2 nëntor të vitit 2012 ishte nënshkruar një memorandum i mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunës së Suharekës për bashkëfinancim në rregullimin e shtratit të lumit Toplluha. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor jo në planifikimin e buxhetit për investime kapitale ka paraparë për vitet 2018 dhe 2019 projektin për rregullimin e shtratit të lumit Toplluha. Për këtë vit janë ndarë 200 mijë euro, kurse për vitin 2019 janë ndarë 300 mijë euro, gjithsej kostoja e rregullimit të shtratit të lumit Toplluha për këto dy vjet është 500 mijë euro.

Për sanimin, pastrimin dhe zgjerimin e shtretërve të lumenjve, përfshirë edhe gjetja e zgjidhjeve për derdhjet e ujërave të zeza në këtë lumë, deri tash komuna ku kalon lumi Toplluhë nuk ka prezantuar ndonjë projekt-propozim. Sa i përket trajtimit të ujërave të zeza, ne jemi duke punuar në ndërtimin e impianteve, të cilat do të bëjnë përpunimin dhe trajtimin e ujërave të zeza. Tashmë, në regjionin e Prizrenit vetëm e kemi, i cili është një fondacion, donacion nga Zyra gjermane, kurse për komunën e Suharekës ende nuk ka diçka të paraparë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, kalojmë në pyetjen e dytë, deputetja Mimoza Kusari-Lila, pyetje për ministren Albena Reshitaj.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Ministre, kjo pyetje është bërë para 3-4 muajve, por për shkak të rrethanave në seancë të Kuvendit nuk ka ardhur, të njëjtën e ka pasur edhe ministri Valdrin Lluka. Megjithatë, në kuadër të kompetencave të ministrisë që ju drejtoni, ka të bëjë me një ndërtim pa leje në zonën e mbrojtur sanitare nga kompania rajonale e ujësjellësit “Radoniqi”. Pyetja për ministren është kjo: Vendimi i Qeverisë Nr. 09/127 i datës 24.03.2013, obligon Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të bëjë mbikëqyrjen e zonave të mbrojtura dhe zbatimin e masave mbrojtëse. Çfarë mase keni marrë ju, ministre dhe Inspektorati i ministrisë tuaj, për ndalimin e ndërtimit pa leje. A ka lëshuar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pëlqim apo autorizim mjedisor për këtë objekt? Më lejoni gjithashtu, ministre, t’ju rikujtoj që nga Komuna e Gjakovës më datë 27.05.2015 është ndërprerë procedura e iniciuar sipas kërkesës së aplikuesit për dhënien e lejes së ndërtimit për objektin e rojave në digë, si është prezantuar atëherë, nën ngastrën kadastrale me nr. 88/1, zona kadastrale Radoniq, meqenëse pala nuk ka prezantuar dokumentacionin e kërkuar.

KRYETARI: Zonja ministre, kur të jeni gati, mund të përgjigjeni në pyetje.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeparlamentar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Ujësjellësi rajonal “Radoniqi” është duke zhvilluar punimet ndërtimore për ndërtimin e fabrikës së ujit të pijes “Radoniqi”, faza e dytë, në Gjakovë. Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më 26 tetor 2016 ka inspektuar punimet dhe ka konstatuar se po zhvillohen pa leje ndërtimore dhe ka marrë të gjitha masat për ndalimin e punimeve në harmoni me bazën ligjore në fuqi.

Kompania ka respektuar urdhëresën e Inspektoratit dhe ka zhvilluar procedurat për pajisje me leje ndërtimore. Në inspektimin e radhës, më 21 mars 2017, Inspektoratit i është prezantuar leja ndërtimore, me të cilën organi kompetent i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lejon ndërtimin e stacionit për përpunimin e ujit KRU “Radoniqi”, faza e dytë. Ndërsa, sa i përket objektit të administratës, objekt ky i cili ka qenë ekzistues para luftës në Kosovë, i dëmtuar dhe i demoluar nga pasojat e luftës, është rindërtuar në themelet ekzistuese pa u ripajisur me leje ndërtimore në harmoni me Ligjin e ndërtimit, neni 25, pika 1.

Unë me të marr këtë post kam kërkuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor raport për të gjitha dhëniet e pëlqimeve mjedisore, lejeve mjedisore, lejeve ndërtimore dhe kam krijuar një grup të ekspertëve nga ministria, por edhe ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët i kam angazhuar brenda Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të rishikuar të gjitha lejet ndërtimore dhe lejet mjedisore që janë dhënë. Ata janë duke punuar, ekipet janë duke punuar dhe janë duke përgatitur, janë në fazën e përgatitjes së raporteve, normalisht të së kaluarës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministre! Ka pyetje shitesë nga zonja deputete, urdhëro.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, ministre, për sqarime, por më lejoni t'ju rikujtoj se flasim për një proces tërësisht të korruptuar, flasim për dezinformata dhe shtrembërim të informatave që ju janë dhënë. Ministre, ky është objekti i rojës që është për një person të qëndrojnë vetëm në digë, ose në afërsi të digës. Ky është objekti, ministre, që është ndërtuar, siç e potencuat ju, në themelet ekzistuese, flasim për një shtëpi të rojës dhe flasim për një objekt P+3 në njërën anë, dhe P+2 në anën tjetër, në afërsi 80 metra prej liqenit akumulues. Ende më tepër, drejtori ekzekutiv i po të njëjtës kompani u ka ofruar organeve ose kompanive hoteliere mundësi të afarizmit, e cila është shkelje e rëndë e ligjit dhe udhëzimit, të cilin Qeveria e Republikës së Kosovës, gjegjësisht ish-kryeministri në këtë rast, kryeministri Thaçi asokohe, e ka lëshuar për zonat e mbrojtura dhe regjimin e rreptë.

Më lejoni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zonja ministre, dëshironi të shtoni përgjigjen, apo është e kryer? Atëherë, vazhdojmë tutje. Deputeti Liburn Aliu ka pasur pyetje për ministren Albena Reshitaj, nuk është këtu, dy pyetje, në fakt. Deputetja Drita Millaku, pyetje për ministrin Deribor Jevtiq. Deputetja Sala Berisha-Shala, pyetje për ministrin Valdrin Lluka.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Ministri nuk është këtu, por unë do ta shtroj pyetjen, sepse është parashtruar shumë më herët kjo pyetje e s'i ka ardhur radha, por gjithmonë është aktuale.

Çështja është se Ligji për Trepçën ka hyrë në fuqi më 31 tetor të vitit 2016 dhe qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji ka qenë rivitalizimi i këtij kompleksi industrial që gjithmonë është llogaritur si shpresë për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm që do t'u hapte rrugë investimeve, që do ta rrisnin vlerën e aseteve, avancimin e kapitalit tekniko-teknologjik, ashtu që Trepçën ta shndërronte në një ndërmarrje të veçantë jetike për mirëqenie sociale dhe në interes të përgjithshëm publik. Për realizim të këtij qëllimi, ligji duhet të fillohet të zbatohet. Ligji nuk mund të zbatohet pa u themeluar së pari bordet që janë të parapara me ligj. Pyetja ime ka qenë dhe po e shtroj tani: a është duke u zbatuar Ligji për Trepçën, a mund ta dimë se ku ka mbetur procesi i formimit të bordeve që parashihen me këtë ligj? Edhe kisha kërkuar një dinamizim të procesit të themelimit të bordeve të Trepçës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete!

Ministri nuk është këtu, deputetja Xhevahire Izmaqu, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Këtë pyetje, të njëjtën, a ka bërë një koleg para meje, kështu që ministri është përgjigjur, të falënderoj, nuk kam nevojë të marr përgjigjen e njëjtë.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Skënder Reçica.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolege dhe kolegë deputetë,

I nderuar ministër, zoti Reçica,

Çështja për të cilën e kam drejtuar pyetjen tek ju është sot mosrespektimi i të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, aksidentet e shumta në vendin e punës, mbikëqyrja e sektorit privat në përgjithësi, konkretisht inspektimi i rregullt.

Zoti ministër, duke pasur parasysh raportimet e shumta për mosrespektim të të drejtave të punëtorëve në sektorin privat dhe parregullsive të shumta në këtë sektor, më intereson të di se cili është numri i inspektorëve të punës në nivel të Kosovës dhe a kemi kapacitete të mjaftueshme në inspektim, përderisa çdo ditë raportohet për shkelje të të drejtave të punëtorëve dhe incidente në vend të punës.

KRYETARI: Zoti ministër, fjala është për ju!

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryeministër,

Kolegë ministra,

E nderuar deputete Musliu,

Faleminderit për pyetjen tuaj, në fakt, pyetja juaj që ka të bëjë me mosrespektimin e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat, sigurinë dhe shëndetin në punë, rastet e lëndimeve dhe ato me fatalitet, e të tjera, që ndërlidhen me sektorin privat dhe me punëtorët, është një nga shqetësimet dhe preokupimet e mia që nga dita e parë kur e kam marrë mandatin dhe vazhdimisht me sinqeritetin dhe angazhimin më të lartë, jam duke bërë përpjekje konkrete që në të ardhmen sa më pak të kemi lëndime në vendin e punës, sa më pak të kemi raste me fatalitet dhe të drejtat e punëtorëve të respektohen tërësisht.

Inspektorati i Punës, bazuar në kompetencat që jep legjislacioni në fuqi, realizon inspektime të rregullta, të përsëritura dhe me kërkesë të palës, e cila konsideron që i janë shkelur të drejtat, si dhe bën inspektimin në bashkëpunim me institucionet e tjera, të cilat mbikëqyrin zbatimin e ligjeve në sektorin publik, por edhe në atë privat. Aktualisht, Inspektorati i punës ka gjithsej 41

inspektorë të punës dhe 7 koordinatorë rajonalë, të cilët kanë kompetenca edhe për kryerjen e inspektimeve. Duke u bazuar në numrin e bizneseve dhe institucioneve të tjera publike, Inspektorati i Punës aktualisht nuk ka kapacitete të mjaftueshme dhe kjo shkakton një problem të madh, i cili është bartur në vite. Për informimin tuaj, ne si ministri jemi në procedurë të hartimit të ligjit të ri për Inspektoratin e Punës dhe ky ligj do të jetë bashkëkohor, i bazuar në standarde ndërkombëtare të organizatës së punës, ILO. Me këtë ligj një vend të rëndësishëm së veçantë do t'i kushtohet edhe mbikëqyrjes së punës së inspektoratit që ata të performojnë dhe të zbatojnë ligjin në përgjithësi.

Në aspektin e sigurisë dhe shëndetit në punë, deri më tani Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka transpozuar gjithsej 25 direktiva, 19 rregullore të miratuara nga Ministria e Punës dhe disa nga Qeveria. Duhet të kemi të qartë se gjendja me sigurinë dhe shëndetin në punë nuk është më e mira, por kjo kërkon edhe një vetëdije të qytetarëve dhe zbatim të ligjit, ku secili mban përgjegjësinë e vet, si institucioni, po ashtu edhe punëdhënësi dhe punëmarrësi. Ne në bazë të Ligjit për siguri dhe shëndet në punë, Ligji Nr. 04/ L- 161, kemi filluar të certifikojmë persona në kompani të ndryshme, të cilët do të jenë përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve në kuadër të organizatave dhe kompanive të tyre.

Gjithashtu, ka filluar licencimi i bizneseve, kompanive të cilat merren në procesin e vlerësimit të rrezikshmërisë në vendet e punës, kërkesë kjo e përcaktuar me ligjin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë. Sa i përket...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zonja Ganimete, pyete edhe një herë, gjysmë pyetje, e ministri e ka edhe një minutë.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe kisha kërkuar prej regjisë të mos i ndërpritet fjala ministrit, për arsye se është një temë shumë interesante, me rëndësi të veçantë për qytetarët e Republikës së Kosovës. Ministër, e thatë se kemi vetëm 41 inspektorë në nivel të Kosovës dhe për mua kjo është shumë shqetësuese, sepse 41 inspektorë nuk mundën ta mbulojnë vetëm Prishtinën, e lëre më gjithë Kosovën. Prandaj, e thatë që edhe do ta bini Ligjin për inspektorët ose Inspektoratin e Punës, dua të di kur konkretisht është ky ligj dhe thjesht, kur e thatë edhe te vetëdija qytetare, te ngritja e vetëdijes qytetare rreth të drejtave të punës, unë mendoj se secilës kompani private i konvenon të bëjë nga pak shkelje për ta pasur fitimin e vet.

Unë konsideroj që nuk duhet të lihet në vullnetin e kompanive dhe bizneseve ose në vullnetin e atyre njerëzve, të cilët e udhëheqin sektorin privat, por thjesht...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETAR: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit, kryetar!

E nderuar deputete,

Ne jemi të vetëdijshëm që numri aktual të inspektorëve prej 41 sa e kemi nuk është i mjaftueshëm për të siguruar që të drejtat e punëtorëve, siguria dhe shëndeti, kontratat janë duke u bazuar sipas ligjit. Jemi të vetëdijshëm për këtë, ne e kemi trashëguar këtë situatë dhe në këtë vit kemi planifikuar që kontingjentit të inspektorëve t'i shtojmë edhe dhjetë inspektorë të rinj, për këtë shumë shpejt do të fillojnë procedurat e rekrutimit të tyre.

Aktualisht jemi duke punuar në Ligjin e ri të Inspektoratit të Punës dhe jemi në fazën finale para se ta nxjerrim në diskutim publik. Ky ligj, të cilin ne kemi punuar që nga dita e parë kur kemi marrë mandatin, është një ligj që do të jetë lehtësisht i zbatueshëm dhe do të jenë direktivat e Bashkimit Evropian ato të cilat do të na ndihmojnë që ky ligj të zbatohet në praktikë. Kur e përmenda të vetëdijesimi i qytetarëve, po e përsëris edhe një herë, është mirë të kemi një ngritje të vetëdijesimit të punëdhënësve, por edhe të punëmarrësve, qoftë në raportimin e shkeljeve të të drejtave të punëtorëve, qoftë edhe në raportimin e punëdhënësit për mosrespektimin e kontratave dhe marrëveshjeve në raportin punëdhënës-punëmarrës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputeti Rasim Selmanaj, pyetje për ministrin Mahir Jaghillar.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër, zoti Jaghillar, pyetja ime është: a keni paraparë rritjen e pagave të kryesuesit dhe të asamblistëve nëpër kuvendet komunale?

KRYETARI: Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Siç biseduam dje, edhe për çështjet sa u përket pagave do të hartohet ligji i ri, i cili do të përfshijë të gjithë punonjësit dhe përfituesit nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Sa u përket kryesuesve, si do të vendoset në ligjin, si do të jetë ajo zgjidhja tabelore në ligj, do të jetë edhe vendi i kryesuesve komunalë ose zëvendëskryesuesve. A do të jetë rritja, a do të jetë ndonjë ndryshim tjetër, nuk mund të paragjykojmë. Sa u përket asamblastëve, ajo varet prej Ligjit për vetëqeverisje lokale. Në qoftë se statusi i asamblastëve komunalë ndryshohet, atëherë mundet të ndodhë. Në këtë moment, derisa ekziston Ligji për vetëqeverisjen lokale dhe ka caktuar detyrat e asamblastëve, ne do të parashikojmë në ligj vetëm vazhdimin e pagesës për pjesëmarrje në seancë dhe komisionet komunale.

KRYETARI: Deputet, në qoftë se ke pyetje shtesë, urdhëro, fjala është për ju. Ministër, qëndro aty, vazhdon.

RASIM SELMANAJ: Unë mendoj se asamblastët nëpër kuvende komunale kanë pagesa jo të dinjitetshme, përderisa janë njerëz të zgjedhur, sikurse që jemi edhe në këtu deputetë në Parlamentin e Republikës së Kosovës, qoftë përmes Ligjit për vetëqeverisje lokale apo në cilindo formë, ju si ministri ose Qeveria duhet të gjejë një mënyrë që këta të trajtohen në mënyrë më të dinjitetshme, sepse edhe asamblastët janë të zgjedhur, njëjtë sikurse ne deputetët.

Prandaj, mendoj se do të ishte mirë të trajtohet seriozisht kjo çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, faleminderit!

Gjatë diskutimeve publike sa i përket Ligjit për pagat, sigurisht ne do të jemi në kontakt edhe me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, por edhe me komuna. Sidoqoftë, prapë varet nga vendimi se cili do të jetë statusi i asamblastëve sa i përket Ligjit për vetëqeverisje lokale.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Sinqerisht, kam pyetje për ministrin, por paraprakisht më vjen keq për manipulimet e ish-kryetares së Gjakovës, zonjës Kusari Lila, e cila po i bën në drejtim të një ndërmarrjeje, e cila për herë të katërt radhazi shpallet ndërmarrja më e suksesshme në Kosovë. Dhe, përderisa ka qenë dhe kanë pasur bashkëpunim me drejtorin, ka qenë drejtori shumë i mirë dhe gjithçka ka qenë në rregull, derisa i prishën muhabetet personale, tani të mos manipulojë me të tjerët.

Megjithatë, letrat dhe dokumentet i ka pasur si kryetare çdo herë për një mandat dhe kurrjë nuk ka bërë në atë drejtim, tash të mos manipulojë, thjesht, edhe pse nuk e beson kurrkush.

Megjithatë, pyetja ime drejtuar ministrit të Arsimit është: i nderuar ministër, ju keni formuar një komision për vlerësimin, kështu e keni quajtur, vlerësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së universiteteve publike. Pyetja ime është a keni në plan ju si ministri të formoni një komision profesional a politik, për të matur edhe performansën e kolegjeve private?

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

E nderuar deputete,

Faleminderit për pyetjen, realisht ne si Ministri e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë jemi duke bërë përpjekje në çdo drejtim që të kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së arsimit në të gjithë sektorët, në të gjitha sistemet, përfshirë edhe sistemin e arsimit të lartë, por edhe sistemin e arsimit parauniversitar.

Lidhur me vlerësimin e cilësisë së arsimit në kolegjet private, kjo do të kalojë përmes Agjencisë së Akreditimit, është kjo agjenci përgjegjëse që të do të mbikëqyrë dhe do të vlerësojë qëndrueshmërinë dhe cilësinë e kolegjeve private, qoftë përmes akreditimit të programeve, qoftë përmes vëzhgimit të vazhdueshëm të këtyre programeve, të cilët janë të akredituara. Konsideroj se do të jetë detyrë e agjencisë që ne mund ta mbështesim në çdo aspekt, në mënyrë që gjatë periudhës së monitorimit të përmbahet niveli i vlerësimit të programeve, të cilat janë të akredituara. Ne kemi nevojë për politika shtesë që cilësia në sistemin arsimor të lartë, qoftë në atë publik, qoftë në atë privat, të jetë në nivel shumë më të lartë sa që e kemi aktualisht.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, a ke pyetje plotësuese, por e ke edhe një pyetje tjetër, pse s'po ia parashtron ministrit?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Po, i nderuar ministër, por Agjencia për Akreditim mat cilësinë jo vetëm në programet në kolegjet private, por edhe në universitete publike. Megjithatë, ju e keni përmendur që keni formuar një komision për vlerësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë në universitetet publike, kjo agjenci është edhe për universitet publike, edhe për kolegjet private.

Pyetja ime është edhe një herë: a keni menduar, pra a keni formuar një komision për vlerësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë në universitetet publike, edhe për kolegjet private, sepse janë institucione brenda Republikës së Kosovës në arsimin e lartë.

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: E nderuar deputete,

Atëherë e konsideroj se pyetja duhet të ishte e shtruar ndryshe, pse është formuar një komision për vlerësimin e qëndrueshmërisë të universiteteve publike? Sepse universitetet publike janë nën menaxhimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, pra kanë një varësi, statuti i tyre është krejt ndryshe nga kolegjet private dhe kjo ka qenë arsyeja pse është formuar komisioni për matjen e cilësisë së institucioneve publike.

Pra, pikërisht për shkak të lidhshmërisë në mes të ministrisë dhe statutit që e kanë universitetet publike. Kjo për kolegje neve na vyen të ndërtojmë politika dhe jemi të gatshëm dhe jemi në vazhdimësi për të ndërtuar politika të reja në të mirën e ngritjes së cilësisë së këtyre universiteteve.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja deputete, pyetjen shtesë. Ministër, mund të qëndrosh aty, se ka edhe një pyetje.

TEUTA HAXHIU: Pyetjen e dytë, po e inkurajoj ministrin në pyetjen e parë që ta bëjë një hap që bashkërisht me profesionistët, pra të gjitha institucionet të trajtohen njëjtë, ashtu siç janë me ligj.

Pyetja e dytë për ju ministër është: pse ka zgjatur me vite procesi i nostrifikimit të diplomave të mësimdhënësve? Ka mësimdhënës që me vite të tëra nuk marrin përgjigje nga zyra, pra në kuadër të ministrisë suaj, ministër. Pse zgjat me vite, ka 3, 4 vjet personalisht kam shkuar brenda zyrës dhe nuk marrin përgjigje. Thjesht, pse zgjat me vite? A ka ndonjë afat ligjor që të gjithë ata që janë të interesuar dhe aplikojnë për nostrifikim të diplomave, të marrin një përgjigje brenda një afati apo duhet të presin me vite të tëra?

KRYETARI: Ministër, fjala është për ju!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

E nderuar deputete, ne e kemi diskutuar disa herë këtë çështjen e nostrifikimit të diplomave, edhe në Komisionin për Arsim e kemi trajtuar si temë goxha gjatë, arsyeja, Departamenti NARIC ka pasur probleme të jashtëzakonshme që nga momenti kur ne e kemi marrë përgjegjësinë e kemi gjetur në një gjendje jo të mirë këtë departament dhe keni qenë të informuar si komision se ne kemi marrë masa konkrete që të dalim nga kjo situatë. Së pari, është bërë një auditim i brendshëm pikërisht vetëm për NARIC-un, janë identifikuar shkaqet dhe tani jemi duke marrë masa që kjo pritje e pajustificueshme që ka ndodhur jo vetëm për mësimdhënësit, por për të gjithë qytetarët e Kosovës që kanë kryer një universitet jashtë vendit, apo një nivel tjetër master, apo doktoraturë, kanë pritur me vite të tëra.

Tani jemi në një fazë të konsolidimit dhe konsideroj që do të përcaktohen afatet e sakta dhe kjo dukuri negative do të eliminohet nga ky departament. Faza e parë vetëm ka filluar, pra jemi në eliminimin e disa problemeve që kanë ekzistuar me disa universitete të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, ka qenë një kaos i vërtetë dhe pas sanimit të kësaj situatë, ne do të jemi në gjendje shumë më të mirë dhe më qytetarët e Kosovës nuk do të presin me vite të tëra për nostrifikimin e një diplome.

KRYETARI: Pyetje shitesë? Nuk ka! Shkojmë tutje, deputeti Rasim Selmanaj, pyetje për...
Urdhëro, zonja deputete, kërkoj falje!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit!

Unë e falënderoj deputeten Haxhiu që rri pararojë e gjërave të jashtëligjshme. Ia rikujtoj që tërheqja e lejes për objektin pa leje të KRU “Radoniqi” ose KRU “Gjakova”, siç i është ndërruar emri, është bërë në vitin 2015, më 27 maj 2015.

Nëse Qeveria, niveli lokal, dhe Qeveria, niveli qendror, janë në procedurë të legjitimitimit të proceseve të jashtëligjshme, ajo nuk do të ndodhë, për atë arsye jemi këtu. Prandaj, të mos i përziejme gjërat edhe ta kemi të qartë se cili është roli ynë. Nuk ka nevojë të qëndrosh pararojë e secilit deklaram që e bëj. Pra, ia rikujtoj edhe një herë që e vetmja grua që ka arritur të zgjidhet kryetare e Komunës në Kosovë jam unë, ju pëlqej, apo nuk ju pëlqej dhe kjo ka ndodhur në vitin 2013. Tash për krejt çka ka ndodhur në atë periudhë sa kam qeverisur edhe për periudhën pasuese qëndroj përgjegjëse. Ndërsa ju gjithashtu duhet të qëndroni përgjegjëse, e për aktet tuaja po shihet çdo ditë, si në nivel lokal, si në nivel qendror. Faleminderit!

KRYETARI: Tani seanca ka marrë kah tjetër, kundër-replikë.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit për mundësinë, edhe një herë ia rikujtoj ish-kryetares, jam ndier tepër mirë, edhe sot ndihem të ketë më shumë femra kryetare, por kryetare të përgjegjshme dhe që kryen detyrën në interes të qytetarëve. Që nga 1983-a ka pasur leje nga zoti Vokshi, kryetarja i ka pasur të gjitha dokumentet në tavolinë, por e ka në strategjinë e vet demagogjinë, e cila nuk i pi ujë. Se sa ka pasur rezultate Komuna e Gjakovës në udhëheqjen e saj, e kanë parë qytetarët dhe tani për herë të parë normalisht se do të trajtohet për herë të parë në vazhdimësi, Komuna e Gjakovës do ta ketë tamam një trajtim çfarë e meriton qytetari i Gjakovës dhe bashkëpunimin që e ka pasur ish-kryetarja me këtë drejtor në fillim, krejt qytetarët e dinë, por në fund i prishën pak muhabetet, dhe tani del këtu. Mos manipulo pra në foltoren e Kuvendit, sepse është shumë keq të merresh me gjëra të tilla në Kuvend. Sinqerisht, më vjen keq!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja deputete, nuk kam mundësi rregulloreje, kaq parashihet deputete. Kjo është pjesë jashtë kësaj seance. Kërkoj falje! Për arsye se është replikë, kundër-replikë, ti kërkoje replikë, kundër-replikë.

Nënkryetar i Kuvendit, Kujtim, interpretoje si është Rregullorja. Interpretoje vetë, të mos jem unë politik, po replikë – kundër-replikë edhe... po më vjen keq, tash unë duhet t'ia jap fjalën prapë asaj, prapë... Dëgjo, të mos keqkuptohemi! Po flasim për Rregulloren. Po, s'mundeni në këtë seancë, se ju nuk e keni me fakte, e keni për shkak...

Rasim Selmanaj, pyetje për ministrin Kujtim Gashi. Kërkoj falje, zonja deputete!

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

Edhe pse një koleg para meje e ka bërë ditë më parë të njëjtën pyetje dhe me shtyrjen e seancave kjo pyetje tash është pak e vonuar, por unë megjithatë po e lexoj pyetjen.

Ligji për sponsorizim në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në janar të vitit 2017. Kuptohet, ky ligj është miratuar dhe mirëpritur nga subjekte të interesuara, sepse në mungesë të mbështetjes financiare shumë aktivitete kulturore, rinore e sportive po zhvillohen me vështirësi. Dihet mirëfilli se tani të gjitha federatat sportive të Republikës së Kosovës janë pranuar ndërkombëtarisht, prandaj për këtë edhe kërkohet buxhet shtesë.

Pyetja ime, i nderuar ministër: Cilat do të jenë aktivitetet e ministrisë për eliminimin e pengesave eventuale apo veprimet për implementimin e këtij ligji pas nënshkrimit të Rregullores ditë më parë nga ju?

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Me marrjen e mandatit si ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit e kam bërë të qartë se një nga prioritetet e mia më të rëndësishme është pikërisht kompletimi i infrastrukturës ligjore për sponsorizimin e aktiviteteve sportive, kulturore e rinore dhe normalisht ne si ministri kemi punuar në vazhdimësi dhe me përgjegjësi të madhe që ta finalizojmë këtë prioritet.

Siç keni mundur ta shihni edhe nëpër medie këtë javë, jam jashtëzakonisht i lumtur që edhe para deputetëve të Kuvendit të Republikës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe para qytetarëve të Republikës së Kosovës të ju informoj se para disa ditësh kam nënshkruar njërin nga aktet më të rëndësishme për financimin e sportit, kulturës dhe rinisë në vend - Rregulloren për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit si një obligim që del nga Ligji për sponsorizime. Duke pasur parasysh rregullimin që bën kjo rregullore, e që konsiston në përcaktimin e kritereve, procedurave dhe

formës së vërtetimit të sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, si fusha të interesit publik, ne jemi të bindur që miratimi i kësaj rregulloreje shënon edhe finalizimin e infrastrukturës ligjore, që e rregullon çështjen e sponsorizimeve.

Ne vlerësojmë që nënshkrimi i kësaj rregulloreje paraqet një nga momentet më të rëndësishme të fuqizimit të sportit në vend dhe nga kjo foltore e shfrytëzoj rastin të apeloj te të gjitha bizneset në Kosovë që t'i bashkohen kauzës së zhvillimit dhe avancimit të sportit, kulturës e rinisë nëpërmjet sponsorizimeve. Tani, i nderuar ministër, na ka mbetur edhe faza e sensibilizimit dhe jemi në komunikim edhe me komunitetin e biznesit dhe të gjithë donatorët që ta finalizojmë këtë proces shumë të rëndësishëm për zhvillimin edhe të sportit, edhe të kulturës, edhe të rinisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Ke pyetje shtesë?

RASIM SELMANAJ: Ministër,

Ju përgëzoj për nënshkrimin e kësaj rregulloreje për zbatimin e këtij ligji. Suksesi juaj nuk do të jetë vetëm ligji, por edhe implementimi dhe rezultatet në sportin e Kosovës. Prandaj, mendoj dhe ju propozoj që të keni takim me zyrtarët komunalë dhe përfaqësuesit e federatave, në mënyrë që të ndodhë sensibilizimi dhe të implementohet në mënyrën më të mirë të mundshme ky ligj për përkrahje të sportit në nivel të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Arbërie Nagavci, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Nuk është këtu. Deputeti Lutfi Zharku, pyetje për ministrin Valdrin Lluka. Urdhëro, zoti deputet!

LUTFI ZHARKU: Kryetar, e lëmë për seancën tjetër, kur të vijë.

KRYETARI: Si të dëshironi. Deputetja Valentina Bunjaku-Reshepi, pyetje për ministrin Kujtim Gashi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë dhe ju deputete,

Kabinet qeveritar,

Çështja e pyetjes është adresuar shumë herët, më 18. 1. 2018.

Dy shoqata të filmit, Unioni i Artistëve të Filmit të Kosovës dhe Shoqata e Autorëve dhe Producentëve të Filmit Arte7 e kanë akuzuar me një serë akuzash Qendrën Kinematografike të Kosovës. Në letrën e bërë publike këto dy shoqata e denoncojnë qendrën për konkurs të brendshëm për drejtorin e ri dhe për shpalljen e këtij konkursi në periudhën e shkurtër kohore në festat e fundvitit, përkatësisht prej periudhës 29 dhjetor 2017 deri më 5 janar 2018.

Me Ligjin për kinematografinë e Kosovës, në nenin 32.1 përcaktohet qartë: për emërimin e drejtorit, Ministria e Kulturës shpall konkurs publik, dhe pyetja konkrete është: Pse nuk e anuloni konkursin e brendshëm që ta shpallni konkursin publik për drejtorin e ri të Qendrës Kinematografike të Kosovës? A do ta shkarkoni edhe Këshillin Drejtues për të mbajtur përgjegjësi për këto zhvillime në Qendrën Kinematografike të Kosovës?

Meqë pyetja është bërë shumë herët, besoj se keni lëvizur pozitivisht.

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, kryetar!

E nderuara deputete,

Siç jeni në dijeni, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e ka publikuar konkursin për pozitën e drejtorit të Qendrës Kinematografike të Kosovës, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi. Duke u bazuar në Rregulloren për procedurat e rekrutimit nr. 02/2010, neni 4, ku theksohet se për pozitën e larta drejtuese dhe pozitën drejtuese, pranimi kryhet nëpërmjet ngritjes në detyrë të nëpunësve civilë ekzistues, që do të thotë nëpërmjet konkursit të brendshëm.

Pas përfundimit të afatit për aplikim për konkurs të brendshëm, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke u bazuar në evidentimin e aplikantëve që kanë aplikuar për këtë pozitë e ka anuluar konkursin, pasi ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet për të vazhduar tutje. Andaj, duke u bazuar në ligjet në fuqi që e rregullojnë këtë fushë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka shpallur konkurs publik me të drejtë pjesëmarrjeje për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe tani ky proces ka përfunduar dhe sipas rekomandimeve të Komisionit Përzgjedhës ne e kemi caktuar drejtorin e QKK-së.

Vlen të theksohet fakti se procedurat e rekrutimit tani e një kohë janë të rregulluara nëpërmjet sistemit informativ dhe menaxhues të burimeve njerëzore, andaj afatet dhe datat e konkurseve përcaktohen në mënyrë automatike, ashtu siç i cakton sistemi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë? Jo! Atëherë, deputetja Drita Millaku, pyetje për zëvendëskryeministrin Behgjet Pacolli. Nuk është këtu. Deputetja Arbërie Nagavci, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Nuk është këtu. Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Skender Reçica. Nuk është këtu. Deputetin Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Po ashtu, nuk është. Deputeti Xhelal Sveçla, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Nuk është.

Tani jemi te pyetjet e parashtruara për herë të parë. Deputeti Avdullah Hoti, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

AVDULLAH HOTI: Kryetar!

Duke qenë se ministri nuk është i pranishëm, unë kërkoj që kjo pyetje të shtyhet për seancën e ardhshme.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: E ke edhe një pyetje për ministrin Valdrin Lluka, a do ta bësh sot apo s' do, ai s' qenka këtu.

AVDULLAH HOTI: Duke qenë se as ky ministër nuk është këtu, që nuk ka kuptim realisht, se pyetja është bërë gati para dy muajsh, po e shtyjme për seancën tjetër, me shpresë që ata do të jenë në seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. S' janë këtu, as njëri, as tjetri. Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Nuk janë këtu. Deputeti Shemsi Syla, pyetje për ministrin Rustem Berisha. Nuk janë këtu. Deputeti Nezir Çoçaj, pyetje për ministrin Nenad Rikalo.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

I nderuar ministër Rikalo,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pyetja ime ka të bëjë me tokën që gjendet përreth shtratit të Drinit të Bardhë, që ka mbetur e papunuar një kohë të gjatë. Arsyeja për këtë është shfrytëzimi i egër i rërës dhe zhavorrit, e ku si pasojë kemi edhe prishjen e rrjedhës normale të shtratit të Drinit të Bardhë. Dalja e Drinit nga rrjedha natyrale e tij ka bërë që shumë toka bujqësore të cilësisë së lartë të mos punohen. Pllëshmëria e kësaj toke ka qenë e lartë dhe janë kultivuar disa kultura bujqësore në vit, ndërsa rendimentet e këtyre kulturave kanë qenë të larta.

I nderuar ministër, pyetja ime ka të bëjë: Çfarë do të ndërmerrni si ministri apo si ministër që kjo tokë të kthehet në bujqësore dhe të shfrytëzueshme? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rikalo, e keni fjalën.

NENAD RIKALO: Poštovani predsedavajući,

Poštovane poslanice i poslanici,

Članovi vlade,

Zahvaljujem se poslaniče Čočaj na ovom pitanju i na naporu da se što veći broj količina poljoprivrednog zemljišta, jel to jeste imamo bitnih problema i uticaćemo na to kako će poljoprivredni razvoj biti u budućnosti od toga koliko zemlje imamo na raspolaganju. A taj

problem je problem koji nije od danas, nego je malo širih razmera, konkretno kada se tiče vašeg pitanja, nadležnost Ministarstva poljoprivrede je ograničeno zato što u zakonskom rešenju i ostala ministarstva i opštine imaju svoju ulogu u tome.

Konkretno upravljanjem rečnih korita i zaštita od degradacije i eksploatacije za površinske minerale, kao što je kamen, šljunak i pesak, na osnovu važećih zakona glavnu nadležnost ima Ministarstvo životne sredine i prostorno planiranje. Međutim, kada se govori o zaštiti poljoprivrednog zemljišta o degradaciji eksploatacije, u Zakonu poljoprivrednog zemljišta postoji zakon koji nosi broj 02/L-26 u članu 38. se kaže da primena ovog zakona iznetih odredbi na njenoj osnovi će vršiti opštine kroz inspekcijski nadzor na poljoprivredu a samo ministarstvu će vršiti samo nadzor rada opštine.

Znači sam zakon o poljoprivrednom zemljištu nam ukazuje da i opštine imaju svoju ulogu, odnosno glavna nadležnost je na ministarstvu za zaštitu životnu sredinu i na opštine. Treba razlikovati ovde dve grupe zemljišta. Jedna grupa zemljišta je u slučajevima kada su ekonomski operateri dobili licencu za korišćenje površinskih minerala na poljoprivrednom zemljištu, i postoji druga grupa kada se radi o promeni toka same reke Beli Drim. Na osnovu ovih odredaba i važećih zakona, Ministarstvo poljoprivrede je uputilo jedan dopis Komisiji za rudnike i minerale, koja takođe ima nadležnost o izdavanja tih licenci, i uputila je dopis opštinama Đakovica, Orahovac i Prizren, gde ih je upozнала da se zaštita zemljišta koja je u procesu komosacije, a konkretno se ovde radi o sistemu za navodnjavanje Radonić i Dukađini, mi smo ih upoznali sa time da su u procesu komosacije to zemljište ne može koristiti za bilo koje druge namene, osim za namenu korišćenja poljoprivrednog zemljišta.

Mi smo spremni da kao Ministarstvo poljoprivrede, i ja lično kao ministar, komuniciramo sa ostalim ministarstvima i sa opštinama i da pomognemo da se ova inicijativa što pre reši, kako bi se čitav taj potez u tri opštine doveo u stanje kako bi moglo to da se zemljište koristi. Hvala!

KRYETARI: Pyetja shtesë, zoti Çoçaj?

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit për përgjigjen, zoti ministër!

Ky është një problem i gjatë, është realisht ashtu siç e thatë edhe ju dhe ka përfshirë tri komuna.

KRYETARI: Veç një sekondë, le t'i vërë dëgjueset.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar ministër, për përgjigjen që e dhënë.

Është shumë e vërtetë ajo që e thatë ju. Ky problem është i gjatë, ka një kohë të gjatë që kjo tokë ka mbetur kështu, e papunuar. Unë e di që Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural s'ka

mundësi për të ndikuar dhe për të ndihmuar që kjo tokë të kthehet në bujqësore. Ata qytetarë, produkti i tyre ka qenë i njohur, jo vetëm në Kosovë.

Unë mendoj se edhe ju edhe ministritë përkatëse të linjës që i përkasin, sidomos tri komunat që i cekët, ta kenë një koordinim shumë më të madh që ato toka përfundimisht të kthehen në tokë bujqësore, e jo të shfrytëzohen në mënyrën shumë të egër dhe shumë barbare. Besoj që ministrja ka qenë në atë pjesë, e ka vizituar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rikalo, e dëshironi fjalën? Regjia, fjalën zotit Rikalo.

NENAD RIKALO: Ovo pitanje zaista jeste za širi napor više ministarstva i opština, i same Agencije za minerale i za rudnike, i mi ćemo se potruditi kao Ministarstvo poljoprivrede da postavimo jednu radnu grupu, koja će se baviti ovim pitanjem, i ja se nadam da ćemo u nekom vrlo brzom vremenskom periodu moći da izađemo ovde u Skupštinu, i da izađemo pred javnost i da kažemo kakvi su rezultati napravljeni po ovom pitanju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputeti Nezir Çoçaj, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar ministër i Arsimit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse kohët e fundit po përballemi me disa probleme në arsim, por sido që të jetë, ajo që ka qenë një lajm i mirë për arsimin e lartë në Kosovë ka qenë rangimi i shumë universiteteve publike të Kosovës në janar të vitit 2018 dhe kjo është diçka shumë e mirë, e unë shpresoj shumë dhe duke pasur parasysh edhe angazhimin e ministrit për ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë, dua të bëj pyetje, sepse ne të gjithë e dimë se për të pasur cilësi në arsimin e lartë në Kosovë duhet që universitetet publike të kenë rritje shumë më të madhe të buxhetit të tyre, të kenë numër më të madh të profesorëve universitarë konform kritereve dhe standardeve të Bashkimit Evropian për numër të studentëve, të kenë buxhet më të madh për kërkime shkencore dhe hulumtime. Kjo është një komponentë jashtëzakonisht e rëndësishme, që fokusohet edhe në të gjitha universitetet, e sidomos në politikëbërjen e qeverive të ndryshme. Në këtë mënyrë, edhe universitetet tona do të gjeneronin të ardhura nga projektet dhe kërkimet e tyre.

Ne të gjithë e dimë se universitetet publike ballafaqohen me këto çështje që nga themelimi i tyre.

I nderuar ministër, pyetja ime është: Çfarë do të ndërmerrni ju si ministër lidhur me çështjet në fjalë? Pra, është fjala për rritjen e buxhetit për kërkime dhe hulumtime shkencore në universitetet publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I nderuar deputet Çoçaj,

Faleminderit shumë për pyetjen tuaj! Konsideroj se është një pyetje e rëndësisë së veçantë, realisht se gjithë sistemi arsimor është duke u përballë me një buxhet jo të mjaftueshëm dhe ne që nga momenti i parë kur kemi filluar të diskutojmë për buxhetin kemi kërkuar buxhet shumë më të madh për arsimin, sepse arsimit duhet të jetë prioritet i prioritetëve për Qeverinë e Kosovës.

Megjithatë, çdo ngritje e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë është për ta përshëndetur dhe ne të gjithë duhet të bëjmë përpjekje që kjo ngritje të jetë sa më e lartë, sepse vërtet kemi nevojë në veçanti në arenën ndërkombëtare sistemi arsimor i lartë t'i japë rezultatet e veta.

Lidhur me shkencën dhe hulumtimin, ku faktikisht nuk e kemi situatën e mirë, ky është në realitet i cili sot e kemi, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë i ka të rregulluara disa çështje bazuar në ligjet aktuale, e kemi Ligjin 04/L-135, i cili për veprimtaritë shkencore dhe hulumtime ndan fonde të veçanta. Tani ne vetëm e kemi hapur konkursin për pagesat e hulumtimeve shkencore. Konkursi është i hapur nga data 19. 2. 2018 dhe do të jetë i hapur deri më 30. ... 2018, ku të gjithë hulumtuesit mund t'i paraqesin hulumtimet e tyre dhe të cilët mund të financohen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me një buxhet i cili sillet diku rreth 300 mijë euro, që mund të financohen.

Megjithatë ne konsiderojmë që ky është një buxhet i vogël dhe ne duhet të bëjmë përpjekje më të mëdha.

Ajo çka është duke bërë aktualisht Ministria, ne më 28 tetor 2017, pra të vitit të kaluar, e kemi nënshkruar themelimin e Institutit Ndërkombëtar Evropian të Evropës Juglindore për Hulumtim. Ky është një lajm i mirë, sepse ne jemi anëtarë me të drejta të barabarta dhe jemi në pjesën e menaxhimit të këtij instituti. I kemi dërguar tre ekspertë nga universitetet tona që të janë pjesë e hulumtimeve të këtij instituti, për një institut që vërtet do të ketë të ardhura të mëdha dhe ne mund të jemi një pjesë e mirë për ta shfrytëzuar shkencën dhe hulumtimin, e cila është me seli në Mal të Zi.

Gjithashtu, ne jemi duke biseduar vazhdimisht me universitetet që brenda universiteteve, brenda fakulteteve, të fillojnë që institutet hulumtuese ta bëjnë punën e tyre për të krijuar të ardhura në hulumtime shkencore.

Ne jemi duke diskutuar që ta ndryshojmë edhe infrastrukturën ligjore, në mënyrë që të mos jetë pengesë në punën e këtyre instituteve dhe në krijimin e të ardhurave shtesë për universitetet publike.

Kemi diskutuar dhe i kemi inkurajuar që universitetet publike dhe universitetet tjera të bëhen pjesë e projekteve ndërkombëtare, siç është “Horizont 2020”.

Ne do ta mbështesim çdo institucion publik të arsimit të lartë dhe institucion privat të arsimit të lartë, të cilët dëshirojnë të futen në këtë projekt. Ne do të jemi në bashkë-projekt me këto institucione.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, ministër!

Unë dua ta theksoj edhe nevojën, e theksuat edhe ju, po është nevojë shumë imediate që edhe institutet brenda fakulteteve, por edhe vetë universitet të ndihmohen me fond të veçantë.

Ne e dimë sa ndahet për arsim, shkencë dhe kërkime shkencore nga GDP jonë si shtet. Kjo është një shumë qesharake. Të gjitha universitetet në praktikën e tyre e kanë që çdo herë kur universiteti ka buxhet për kërkime dhe zhvillon kërkime, gjeneron të ardhura, rritet edhe buxheti, buxheti i vetë universiteteve.

Unë mendoj se është nevoja dhe është shumë imediate për ta që universitetet të kenë buxhet ekskluziv për kërkime shkencore dhe hulumtime. Duhet të ketë mbështetje. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar deputetë,

E sqaruam se universitetet dhe fakultetet duhet t’i ngrënë institutet hulumtuese dhe duhet që në projeksionet e tyre buxhetore të bëjnë kërkesë në momentin kur diskutohet buxheti, edhe i universiteteve, edhe i ministrive.

Ne e kemi gjetur qarkoren e përfunduar të buxhetit dhe për vitin 2018 ka qenë e pamundur që të bëhen kërkesa shtesë.

Në këtë vit ne jemi shumë afër universiteteve që ato vetvetiu të bëjnë planifikime dhe vija buxhetore për hulumtim dhe shkencë.

Ne jemi të sigurt që në këtë drejtim mund të bëjmë shumë më shumë se që bëjmë aktualisht dhe ne jemi të gatshëm t'i mbështesim në vitin e ardhshëm, pra që të kemi buxhet shtesë për hulumtim dhe shkencë brenda universiteteve.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputetja Mimoza Kusari-Lila, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Pali nuk është këtu. A dëshironi ta bëni pyetjen?

MIMOZA KUSARI LILA: Jo nënkryetar, pasi nuk është ministri këtu, kur të kthehet e bëj pyetjen.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Kujtim Gashi.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër Gashi,

Çështja ka të bëjë me mosfunksionalizimin apo mosfillimin e implementimit të Ligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, një ligj të cilin Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka miratuar tani më shumë se një vit, pra prej 17. 1. 2017.

Ky ligj nuk po zbatohet për faktin se Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit nuk ka nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e ligjit, edhe pse ka qenë e obliguar që brenda gjashtë muajve të bëjë miratimin e këtyre akteve nënligjore.

Gjithashtu, nga debati i parë për sportin, që është mbajtur në vitin 2013, janë nxjerrë edhe disa rekomandime, të cilat do të duhej të zbatoheshin nga ministria kur kemi të bëjmë edhe me menaxhimin e objekteve sportive.

Sipas ligjit, ministria do të duhej që ta themelonte Këshillin Kombëtar për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, si dhe ta rregullonte këtë çështje me akte nënligjore.

Gjithashtu, edhe Komiteti Olimpik dhe federatat sportive do të duhej t'i harmonizonin statutet dhe rregulloret e tyre disiplinore konform këtij ligji për ta parandaluar dhe sanksionuar dhunën në ngjarje sportive dhe për t'i luftuar dukuritë negative, siç kemi të bëjmë me kurdisje dhe trukime, të cilat e kanë atakuar futbollin shqiptar, por që kësaj dukurie nuk mund të ikën as futbollin kosovar në veçanti kur i afrohem fundit të kampionateve sportive.

Prandaj, i nderuar ministër,

Pyetja ime ka të bëjë: Kur do të fillojë zbatimi i plotë i këtij ligji për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, sepse për Ligjin për sponsorizim i keni dhënë sqarimet e duhura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Haxhiu,

Sa i përket pyetjes për Ligjin numër 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, ashtu siç e thatë edhe ju, ky ligj është publikuar në Gazetën Zyrtare.

Nga ky ligj, konkretisht nga neni 7, Ministria themelon Këshillin Kombëtar për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës sport dhe dukurive tjera negative në ngjarjet sportive.

Ne jemi tani duke diskutuar me përfaqësues të institucioneve, të cilat, sipas këtij ligji, duhet të jenë pjesë e këtij këshilli dhe shumë shpejt do ta nxjerrim vendimin për formimin e këtij këshilli shumë të rëndësishëm për sportin.

Sa u përket detyrave dhe përgjegjësi të këshillit, ne vetëm e kemi formuar grupin punues, i cili është duke e hartuar draftin fillestar, të cilin pastaj do ta përcjellë tek anëtarët tjerë të këshillit.

Ky grup është duke u udhëhequr nga Departamenti Ligjor në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe në të njëjtën kohë bashkë me këtë grup punues do të nxirren edhe aktet tjera nënligjore, të cilat lehtësojnë që të përfshihen edhe akte tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Pra, jemi në proces të mirë, është fazë menjëherë pas Ligjit për sponsorizim dhe rregulloren që e kemi nxjerrë ditë më parë, tani ka mbetur pjesa e zbatimit edhe e këtij ligji. Besoj që shumë shpejt Ministria e Kulturës do ta ketë t'i gatshme edhe aktet tjera nënligjore, por edhe Këshillin Kombëtar për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: I nderuar ministër,

Ashtu siç jeni të informuar edhe ju, kryetari i Federatës të Futbollit të Kosovës ka kërkuar angazhimin e një prokurori që të jetë i angazhuar për çështjet e sportit, në veçanti për luftimin e

trukimeve dhe kur kjo çështje është e rregulluar me ligj dhe një prokuror nga Prokuroria shtetërore e Kosovës është i obliguar që të jetë pjesë e Këshillit Kombëtar, dhe gjithashtu edhe nga Policia e Kosovës dhe ministra, që do ta përbënin këtë këshill, atëherë mendoj që nuk do të ishte e nevojshme që kryetarët e federatave të kërkojnë angazhimin e prokurorëve, por është detyrim dhe obligim ligjor që një çështje të rregullohet dhe ministria të mos ngecë në këta hapa, sepse ne pothuajse çdo vit po kemi dhunë në sport, por ka edhe dukuri të cilat po e dëmtojnë imazhin e sportit në tërësi në Kosovë dhe kjo do të parandalohet me formimin e këtij këshilli, i cili ka detyra të përcaktuara me ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit!

Edhe një herë shumë shkurt,

I nderuar deputet,

Besoj që Këshillin do ta kemi të gatshëm gjatë muajit mars. Edhe prokurori dhe Policia e kanë mirëpritur këtë ligj dhe kanë shprehur gatishmërinë të jenë pjesë e këtij Këshilli Kombëtar, pra do të jemi shumë shpejt në implementim të këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sami Kurteshi, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Samiu nuk është këtu. Deputeti Rexhep Selimi, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Rexhepi nuk është këtu. Deputeti Shemsi Sylja, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Shemsi Sylja nuk është këtu. Deputetja Fitore Pacolli, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Nuk është këtu.

Deputetja Fitore Pacolli, pyetje për zëvendëskryeministrin Fatmir Limaj. Fitorja nuk është këtu, as zoti Limaj.

Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli, edhe këta të dytë nuk janë këtu.

Siç e dini, pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në Revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica

Sipas marrëveshjes që e bëmë në fillim, me një votim gjysmëformal, ne nuk kemi kuorumin e duhur, nuk kemi kuorumin për ta votuar këtë. Ishte vullnet edhe i Grupit Parlamentar Lidhja Demokratike të Kosovës që të mos i harxhojmë sot diskutimet për ligje dhe t'i votojmë pastaj, por t'i votojmë një nga një. Andaj unë e jap pauzën deri në orën 14:00. Nëse vijnë deputetët, vazhdojmë.

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës.

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Ju lutem, t'i zini vendet.

Kemi një situatë realisht vetëbllokuese, por sidoqoftë unë dua t'i mbetem besnik asaj që e vendosëm ose s'e vendosëm në fillim.

Unë kërkoj deklarin tuaj sipas grupeve parlamentare, pa votim, në fund të fundit, që si të bëjmë, të vazhdojmë debatin, t'i shqyrtojmë ligjet e t'i lëmë pastaj në një kohë të caktuar kur kemi kuorum që t'i votojmë, apo keni një mendim tjetër.

Sipas radhës, fjalën e ka Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, respektivisht zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Me të vërtetë kjo tash po duket është shndërruar në rutinë ikja nga përgjegjësia e kësaj mazhorance të brishtë, edhe vetë pamja tash tregon që nuk janë të interesuar të kalojnë ligjet, qofshin ato me prioritet të caktuar, sidomos këtë që po thirremi në përmbushjen e agjendës evropiane, por edhe ligje të tjera me rëndësi të veçantë, pa anashkaluar edhe pjesën e debateve dhe interpelancave.

Kështu që Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e Kosovës shpreh shqetësimin e saj me këtë gjendje dhe kjo tregon që mazhoranca nuk është e gatshme për të vazhduar.

Kështu që ne e lusim Kryesinë e Kuvendit që sa më shpejt të takohet dhe të caktojë seanca të rregullta dhe të kërkojë përgjegjësi nga deputetët e mazhorancës, nga grupet politike që e përbëjnë koalicionin qeveritar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Gjendja është e dukshme dhe ne po i numërojmë tash deputetët me përbindje, sa janë deputetë të PDK-së aktualisht, me numra dhe sa janë të LDK-së. Jemi të interesuar ta vazhdojmë seancën, t'i trajtojmë ligjet dhe nuk është mirë të merremi me çështje të paqena.

Dje janë larguar prej seancës pa arsye, pse nuk u ka kaluar një votim. Ndërsa i kanë bllokuar disa votime, përfshirë edhe buxhetin e shtetit. 61, unë po them për PDK-në, po flas tash këtu absolutisht.

A dëgjove, Driton, se ti nuk dëgjon mirë, unë thashë për PDK-në, ti e ke veç njërin vesh që dëgjon, veç njëren anë të veshit.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Ne jemi për të vazhduar seanca, për shkak se mund të debatohet për ligjet që janë në pikat e rendit të ditës dhe për votim është lënë edhe koha e caktuar, mund të jenë në orën 16:00 deputetët të gjithë për të votuar.

KRYESUESI: Jo, ora është kontestuar, veç një sekondë, ta kryejnë këta. Lista serbe, a ka dikush që do të deklarohet, kanë shkuar në pushim. “Nisma për Kosovën”, zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne mund ta shtyjmë siç po thonë kolegët e LDK-së, po prapë do të vijmë në këtë pikë, prapë këto pika të rendit të ditës vijmë. Kështu që tash po më duket se jemi bërë 61, ta hedhim në votim pikën të cilën e kemi diskutuar, nëse nuk ka vota të mjaftueshme për marrëveshjet, t’i shtyjmë ato ndërkombëtare që kërkojnë 80 vota, t’i shtyjmë për një seancë tjetër, po le të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës për të cilat ka deputetë të mjaftueshëm në sallë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë janë 52 deputetë. Grupi Parlamentar “6+”.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi Parlamentar “6+” ka qëndrim që të vazhdojë seanca e sotshme, për shkak se sinqerisht kjo është një joseriozitet i paparë, çdo seancë për mospjesëmarrje të deputetëve në sallë duhet të shtyhet, deri kur do të zgjatë kjo shtyrje nuk e dimë, ndërsa pikat po grumbullohen, mirëpo deri kur kështu deputetët duhet të vetëdijesohen dhe duhet të dinë të sillen konform përgjegjësive të veta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën edhe një herë.

ARMEND ZEMAJ: Ju sa e potencuat atë që unë e thashë paraprakisht, nuk ekziston kuorumi në mungesë të disiplinës edhe përgjegjësisë së kësaj mazhorance. Nuk po flasim për individë, as për grupe politike, po mazhoranca nuk e ka numrin e nevojshëm për të filluar në seancë të rregullt plenare.

Kështu që ky është shqetësim yni, ne kërkojmë përgjegjësi nga këto grupe politike dhe të mos sillen kështu shumë të papërgjegjshëm ndaj qytetarëve të vendit, po mbi të gjitha ndaj institucionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ju po e shihni dhe çka është shumë me rëndësi po e shohin qytetarët e Kosovës çdo ditë që Parlamenti ka vështirësi në funksionimin e tij normal dhe kryesisht për shkak të sabotimit që po ia bën opozita dhe kjo është evidente.

Ne me këtë propozim të LDK-së i bie që ta shtyjme edhe këtë seancë.

Më lejoni t'jua rikujtoj që një seancë që ka filluar më 8 shkurt, ka vazhduar më 9, ka vazhduar përsëri, ka vazhduar dje, është në gjysmë.

Një seancë tjetër për shqyrtimin e ratifikimit të Projektligjit për demarkacionin është po ashtu e mbetur në gjysmë.

Nëse doni edhe këtë seancë ta lëmë në gjysmë, ne i kemi tri seanca në gjysmë.

E kemi një kërkesë për një seancë të jashtëzakonshme, për të cilën duhet të vendosë Kryesia së shpejti.

E kemi një seancë solemne të hënën dhe nëse më kujtohet, e besoj ju kujtohet të gjithëve, ka pasur zëra pikërisht nga opozita që thoshin nuk po punon Kuvendi mjaftueshëm. Sot tash kur kemi seancë pas seance, ne kemi një sjellje, e cila kërkon pikërisht të mos funksionojë ky Kuvend, pikërisht të shtyhet tutje. Çka pengon sot, sipas Rregullores, t'i shqyrtojmë, meqenëse nuk e mbështetën propozimin e kryetarit për shqyrtim dhe votim sot në orën 16:00, t'i shqyrtojmë krejt këto projektligje, të cilat janë duke u zvarritur që sa kohë.

Ju e dini që si Kryesi keni kërkuar prej komisioneve për ta shtuar punën e tyre dhe të sillen ligjet dhe këto ligje tashmë i kemi në seancë dhe kërkesa për ta ndërprerë edhe këtë seancë është realisht kërkesë për të mos e kryer punën e deputetëve.

Ne me zor nuk mund ta mbajmë opozitën, as këta në anën e majtë, as ata në anën e djathtë. Secili deputet e ka përgjegjësinë e vet dhe është në ndërgjegjen e tij ta respektojë mandatin që e ka fituar prej qytetarëve dhe të vijë në seancë.

Ne kemi kushtet për ta vazhduar punën e kësaj seance që u shty pikërisht për mungesë të kuorumit dhe kush nuk do, me zor s'mund ta ndalim. Normalisht, nëse çohen LDK-ja e ta lëshojnë sallën sikur që e kanë lëshuar dje dhe herëve të tjera, ne s'mund ta vazhdojmë, se mbesim edhe pa minimumin e 40 deputetëve. Por, kjo do të ishte mungesë e përgjegjësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Çfarë propozimi ke, të vazhdojmë. Në rregull! Fjalën e ka zonja Emilija Rexhepi.

EMILJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Poštovani građani,

Kolege poslanici,

Trebamo svi snositi odgovornost za nefunkcionisanje svih redovnih sednica u ovom parlamentu, pre svega na vladajuću partiju mislim i na vladajuću koaliciju, ako nismo sposobni da imamo glasove u ovom parlamentu, ne možemo kriviti partije, političke opcije koje su opoziciji, zato svi koji smo u koaliciji sa vladajućem partijom na čelu želimo poručiti javnosti da snosimo odgovornost za nefunkcionisanje ovog parlamenta i redovnih sednica i Zakona koji su nam na snazi a ne možemo ih sprovoditi upravo zbog neodgovornosti svih nas kojih predstavljamo sve zajednica u ovom parlamentu a pre svega mislim na građane koje nas stalno slušaju i gledaju i dajemo jednu lošu sliku u javnosti. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kujtim Shala e ka kërkuar fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë, që mund të punojmë ju kërkoj që të jeni të saktë, nuk ka kurrfarë kërkesë të LDK-së që të mos vazhdojë seanca, po ka normë, ka rregull, domethënë kemi kaluar dy pika, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me rendin e ditës dhe sipas Rregullores së Kuvendit në këtë pikë ne duhet të kemi kuorum, kjo s'ka të bëjë me atë që kërkojmë ose që s'e kërkojmë ne. Do të thotë ne duhet të kemi së paku 61 veta në sallë që të mund të vazhdojmë punën.

KRYESUESI: 61 veta duhet të votojnë, unë për sot e respektoj kryetarin më shumë se tjetër kënd, por ne mund të vazhdojmë seancën edhe pa kuorum, por kur kemi votim, i kemi 61 vota. Zonja Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk është diçka që po ndodh për herë të parë, ka ndodhur edhe në legjislaturën e kaluar, ne mund ta vazhdojmë punën me projektligje. Votimin mund ta lëmë kur të doni, qoftë një ditë tjetër, por mirë është t'i diskutojmë pikat e rendit të ditës.

Nuk është hera e parë, ka ndodhur edhe në legjislaturën e kaluar, ne jemi deputetë që kemi qenë këtu, sa për numra nuk po flasim, por sinqerisht është në interes të Kuvendit, është në interes të secilit prej nesh që të vazhdojmë me projektligjet.

Kemi shumë pika të rendit të ditës, atëherë të mos ankojmë se shkel e shko më shumë po i diskutojmë shumë projektligje, vetëm sa për të thënë, apo nuk po i diskutojmë fare.

Të vazhdojmë te pikat e rendit të ditës, ato që kërkojnë votim, i shtojmë, në fund ta lëmë votimin. E mira e së mirës do të ishte që krejt një ditë të veçantë të votoheshin, nuk u përkrah as

ajo çka tha kryetari, por të ndërpritet puna e Kuvendit, sinqerisht është diçka shumë e keqe që po ndodh, ka ndodhur edhe herëve të tjera, por është mirë t'i themi stop.

KRYESUESI: Faleminderit! Armendi e ka kërkuar edhe një herë fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Kryesues, neve me të vërtetë po na vjen keq, edhe me qasjen, edhe me qëllimin për të devijuar prej kësaj problematike.

Esenca është që nuk kemi kuorum për ta miratuar rendin e ditës dhe për të filluar një seancë të rregullt plenare, këtë ju duhet ta konstatooni.

Sa është numri i deputetë në seancë plenare që të kalojmë te pikat e rregullta të rendit të ditës. Shikoni rregullën 42 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe aty është gjithçka e qartë. Ne nuk po flasim për ndërprerje apo për shtyrje, por po flasim për papërgjegjësi të deputetëve të mazhorancës, të cilët nuk janë 61 në sallë. Kaq!

KRYESUESI: Atëherë, unë i jep të drejtë zotit Zemaj. Tani për faktin që ne nuk e kemi miratuar rendin e ditës dhe e vazhdojmë këtë seancë, kur e kemi lënë, për nesër a të hënë, e vazhdojmë të hënë, pra, ose të martën. Me siguri që më mirë ia lëmë Kryesisë që ta lajmërojë seancën.

Unë nuk mundë, se ne duhet ta miratojmë rendin e ditës, nuk e kemi miratuar rendin e ditës, nuk kemi kuorum. Armendi ka të drejtë. Faleminderit!

Njoftoheni nga kryetari për situatën, nëse doni, marrim pauzë një orë. Qe, pauzë marrim deri në orën 15:00, dhe presim. Unë këtu po pres, unë nuk jam lodhur. Tash unë nuk di çka të bëj.

Pauzë deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës.

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Shumë mirë! Atëherë, zonja dhe zotërinj deputetë, në sallë i kemi 62 deputetë.

Rendin e ditës e keni marrë. Në qoftë se, ka dikush vërejtje për rendin e ditës? A ka? Nuk ka. Konsideroj se rendi i ditës është mira... Po! Zoti... me kartel të Arbanit je, po... me kartelë të Arbanit, Imet Rrahmani.

IMET RRAHMANI: Fjala është për pikën e rendit të ditës me numër 18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën.

Faktikisht ky projektligj nuk ka kaluar të gjitha procedurat dhe nuk është aprovuar nga Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Medie dhe unë konsideroj që nuk do të duhej të shqyrtohej sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Dakord. Propozimin e hedhim në votim. Realisht s'i ka plotësuar, edhe unë po them që s'i ka kushtet e plotësuara, nuk është shqyrtuar nëpër komisione. A jeni dakord që ta heqim pikën e 18-të të rendit të ditës?

Atëherë, është propozimi që pika e 18-të e rendit të ditës, që është Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, të hiqet nga rendi i ditës. Konstatimet tona janë që Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie nuk e ka parashtruar raportin për Projektligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, është edhe kërkesë e Lidhjes Demokratike të Kosovës, grupit parlamentar, që të hiqet. Unë jam dakord, por a jeni dakord edhe ju të gjithë, sepse s'i ka plotësuar kushtet. Në rregull, pra. Konsideroj që pika e 18-të e rendit të ditës hiqet nga rendi i ditës dhe po fillojmë me:

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacione dhe Ndërmarrësi e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zotin Shqyqiri Bytyqi që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në bazë të legjislacionit në fuqi ka zhvilluar të gjitha procedurat e parapara për miratimin në Qeveri të Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Shtiftung SPARK të Holandës, këtu më poshtë SPARK të Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë.

Qëllimi i miratimit të këtij projektligji është zhvillimi, rritja e kapaciteteve dhe mbështetja e veprimtarisë së Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë, një kolegji evropian shumetnik i Mitrovicës, i cili synon që:

- të nxjerrë nëpunës të rinj profesionalë dhe udhëheqës biznesi në regjionin e Mitrovicës, të prirë të punojnë në ekipe shumetnike;

- ta rrisë mundësinë e punësimit nëpërmjet programeve studimore me fokus kryesor në praktikën dhe shkathësitë, si dhe për t'u lehtësuar të diplomuarve nisjen e ndërmarrjeve të tyre private;

- të ndihmojë Kosovën në rrugën drejt integritimeve në Bashkësinë Evropiane duke ofruar kurrikula moderne për të bërë biznes në BE dhe trajnime të shërbyesve civilë për integritime në BE;

- të nxisë zhvillimin e sektorit privat në regjionin e Mitrovicës;

- të krijojë ura midis ndarjes së thellë etnike në qytetin e ndarë të Mitrovicës, që do të ndihmonte në normalizimin ngadalë të marrëdhënieve të tensionuara ndërmjet komuniteteve.

Obligimet e përgjithshme të MASHT-it në zbatimin e projektligjit janë:

- MASHT do të sigurojë fonde publike për Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë në mbështetje të objektivave të ministrisë të listuara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje. Kontributi financiar për IBMC-në pra Kolegjin në Mitrovicë, do të jetë në vlerë prej 600 mijë euro në çdo vit, në mënyrë që për çdo vit ky të jetë një buxhet si vit kalendarik.

- Mjetet e transformuara direkt në biznesin e Kolegjit në Mitrovicë në asnjë mënyrë nuk do të qarkullojnë përmes SPARK-ut për t'u destinuar në kolegjin në Mitrovicë.

- MASHT po ashtu e cakton personin kontaktues për përcjelljen e realizimit të kësaj marrëveshjeje për informimin dhe pikërisht rreth çfarëdo kushti që pengon apo që mund ta cenojë realizimin e kësaj marrëveshjeje.

- Obligohet në përgjithësi që SPARK-u ta zbatojë projektligjin në fjalë.

- Po ashtu, SPARK dhe donatorë tjerë duhet të tërhiqen nga financimi i IBMC-së, me ç'rast ka për detyrë që t'i transferojë IBMC-së të gjitha të mirat materiale dhe jomateriale, stafin punën dhe çdo aset tjetër që ndërlidhet me veprimtarinë dhe që është alokuar në IBMC.

- SPARK-u i transferon po ashtu IBMC-së të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga memorandumi paraprak të nënshkruar të referuara në hyrje të kësaj marrëveshjeje.

- Për realizimin dhe konkretizimin e këtyre transaksioneve si më sipër SPARK dhe IBMC do të nënshkruajnë një marrëveshje të ndarë, por që buron nga kjo marrëveshje.

- Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë nga neni 5 i kësaj marrëveshjeje do të jenë pjesë integrale e marrëveshjes në mes të SPARK-ut dhe IBMC-së.

- Me zbatimin e transaksioneve të mësipërme dhe marrëveshjes së ndërlidhur në mes SPARK-ut nuk i mbetet më asnjë obligim dhe përgjegjësi ndaj MASHT-it dhe IBMC-së.

Duke pasur parasysh rëndësinë e projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SPARK të Holandës për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit të Mitrovicës kërkoj nga ju, të nderuar deputetë, që ky projektligj të votohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini, Sport, Inovacione, zonjën Teuta Haxhiu, për arsyetimin e raportit të komisionit.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi në bazë të nenit 60 dhe 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2018, në cilësi të Komisionit FunkSIONAL shqyrtoi Projektligjin në fjalë dhe i propozoi rekomandimet Kuvendit, që të miratohet projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SPARK-ut të Holandës mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar, e shqyrtoi këtë projektligj dhe mbi këtë mbështetje i propozon Kuvendit që të miratojë dhe të japë votën për, si marrëveshje me rëndësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” nuk është paraqitur. Grupi Parlamentar i LDK-së, zonja Bunjaku-Rexhepi e ka fjalën.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Lidhur me miratimin në Parlament të Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SPARK-ut të Holandës, në mbështetje të Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica, në parim, po i përmendim edhe disa pika të dobëta të marrëveshjes dhe për apelin tonë që të ndihmohen më së pari universitetet publike dhe mandej universitetet dhe institucionet tjera arsimore.

E para, MASHT me sigurimin e fondeve publike në Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica në mënyrë të vazhdueshme për çdo vit akademik ndanë së paku 600 mijë euro. Janë ngarkesë e madhe financiare për një ministri, duke ditur se buxheti i ministrisë nuk është i mjaftueshëm për ndarjen e këtij fondi.

E dyta, problematikë mbetet jo vetëm se thuhet se do të ketë kontribut financiar mbi 600 mijë euro, por thuhet se më së paku 600 mijë euro, domethënë lihet hapësira që të ndihmohet më tepër se 600 mijë euro.

E katërta, edhe Universiteti Publik Isa Boletini dhe ai në veri do të mund të krijonin kuota për studentë të të gjitha minoriteteve që jetojnë në atë pjesë. Ndërsa, arsyet që na bëjnë ta votojmë në parim këtë marrëveshje në mes të MASHT-it dhe SPARK-ut janë këto:

- Universiteti Publik i Mitrovicës Isa Boletini me studentë kryesisht shqiptarë, si dhe universiteti në pjesën e veriut të Mitrovicës me studentë kryesisht serbë, janë universitete pothuajse monoetnike. Edhe nëse kanë studentë me përkatësi të tjera etnike si romë apo boshnjakë, kryesisht dominojnë studentë të një bashkësie kombëtare shqiptare apo serbe. Prandaj, akoma nuk është atmosferë e mirë dhe nuk ka besim, që të jetë mjaftueshëm ndëretnik për të qenë pjesë e këtyre universiteteve të gjitha komunitetet. E këtë mund ta lehtësojë ky kolegji multietnik.

- Themelimi i një Kolegji Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica, duke qenë me karakter multietnik, mund të jetë ndër hapësirat më të volitshme të integritimeve ndëretnike dhe pajtimin e dy pjesëve të qytetit.

- Themelimi i një kolegji multietnik mundëson tejkalimin e dallimeve duke u shkrirë në të përbashkët të tyre, rrugëtimi profesional, shkencor e akademik.

- Komuniteti i studentëve me të gjitha etnitë është mundësi e madhe e ndërveprimit, komunikimit, bashkëpunimit të ndërsjellë, pa dallim gjuhe, etnie e feje.

- Arsyeja e tretë, pse duhet të përkrahim këtë marrëveshje është fakti se elita dhe gjeneratat e reja të shkolluara në këtë kolegji multietnik ndërkombëtar mund të bëhen elita të ndryshme shoqërore, tejkalimin e ndarjeve etnike dhe fillimin e një rendi të ri të marrëdhënieve shoqërore ndëretnike në Mitrovicë.

Duke qenë se fatkeqësisht dhe padrejtësisht Mitrovica është një qytet i fuqishëm industrial, mineral e të tjera, vazhdon të jetë ndër qytetet më të varfra dhe me papunësi të të rinjve, me izolim dhe ikje të të rinjve jashtë vendit, me humbje të shpresës, me incidente sporadike ndëretnike, ose etnicizëm të çdo aktualiteti apo zhvillimi politik. Nëse do të themelohej një kolegji cilësor ndërkombëtar i biznesit me staf të kualifikuar dhe duke prodhuar gjenerata profesionistësh të vërtetë në fushën e biznesit, dhënia e mjeteve financiare për kolegji në realitet do të ishte edhe dhënie e mjeteve financiare për investime në biznesin e të rinjve në Mitrovicë.

Në të ardhmen ky investim në gjeneratat e reja do të ishte i dobishëm edhe ekonomikisht.

Dhe në fund, duke hapur një kolegji ndërkombëtar të biznesit Mitrovica, krijohet një mjedis i hapur më pak i izoluar i qytetit, duke ardhur profesorë nga vende të ndryshme të Botës, ardhja dhe prania e të huajve në këtë qytet ndihmon normalizimin e shumëllojshëm etnik, gjuhësor dhe kulturor.

Dhe krejt në fund, ne i kemi disa vërejtje sepse në marrëveshje në nenin 4 ndahen 6 mijë euro, por nuk janë të planifikuara këto 6 mijë euro në buxhetin tonë. Neni 10 i referohet nenit 5 ndërsa duhet t'i referohet nenit 6, neni 13 është shkëputur teksti dhe mungon një pjesë e tekstit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Nezir Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar ministër i Arsimit,

Të nderuar ministra të tjerë,

Deputetë,

Unë nuk dua të përsëris fjalët e ministrit, sepse ministri e bëri një arsyetim se përse duhet të përkrahet dhe të mbështetet ky projektligj për ratifikimin e marrëveshjes. Ne të gjithë e dimë që Bashkësia Ndërkombëtare këto vitet e fundit në shumë sfera dhe sektorë të arsimit ka dhënë një

kontribut jashtëzakonisht të madh në mbështetjen e shumë projekteve, andaj duke pasur edhe rëndësinë e këtij kolegji që të jetë sa më shpejt funksional, ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do t'i japim mbështetje në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah projektligjin në fjalë.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar "Nisma", zonja Balaj-Halimaj.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Grupi Parlamentar "Nisma Socialdemokrate" mbështet në parim Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të MASHT-it dhe SPARK-ut të Holandës mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica. Urojmë që marrëveshje të tilla të mos i pengojnë askujt dhe vlerësojmë se marrëveshje të tilla për t'u dalë në mbështetje institucioneve arsimore me qëllim të ofrimit të cilësisë janë të mirëseardhura. Prandaj, kurdo që kërkohet me qëllim të arritjes së rezultateve të duhura në çdo institucion arsimor, ne do ta japim kontributin tonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shinik, në emër të "6+"-it.

MÛFERA SERBICA-ŞINIK: Teşekkür ederim!

Uluslararası anlaşma çerçevesinde Holandanın desteklediği bu projeyi Mitroviçada uluslararası ekonomik koleji olarak başarılı olacağına inanmaktayız. Bu yüzden "6+" Parlamenter Grubu olarak bunu desteklemekteyiz, ancak multietnik adı altında çalışmalarını da multietnik olarak diğer toplulukların da eğitim gördükleri dillerde olmasının gerekliliğini vurgulamaktayız.

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Në këtë marrëveshje në mes Kolegjit të SPARK-ut ka qenë edhe në mandatin e kaluar dhe është një organizatë joqeveritare, që ka ndërtuar dy objekte atje në Mitrovicë, një në veri, një në jug. Është një organizatë që ka provuar edhe mësimin dhe edukimin atje dhe si organizatë e tillë ka falimentuar. Pas falimentimit ka kërkuar që këto dy objekte t'ia dhurojë Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së Arsimit dhe përmes një marrëveshjeje që ka ardhur në mandatin e kaluar ne e kemi refuzua. Ajo ka kërkuar që për çdo vit, për pesë vjet, t'i paguhen nga 600 mijë euro, që këto dy objekte Ministria e Arsimit t'ia blejë dhe t'i shndërrojë në objekte qeveritare të arsimit.

Prandaj, kjo është një shkelje e të drejtave ligjore të Ligjit të arsimit të lartë, për shkak se kjo e kundërshton në formën e angazhimit të drejtpërdrejtë në konkurrencën e lirë të arsimit. Nëse

Ministria e Arsimit do të ndërtojë ose do të blejë objekte, jo në këtë formën e kësaj marrëveshjeje, ose këso marrëveshjeje, por duhet të tregojë se është një formë tjetër të zgjidhet, por jo kjo formë neve të na mashtrorë edhe organizatat joqeveritare që kanë falimentuar e falimentojnë në Kosovë t'ia shesin këto objekte edhe si formë e edukimit. Mua po më vjen mirë që Komisioni i Arsimit tash paska përmirësuar këtë gjendje dhe paska bindur këtë formën e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit dhe Presidencës tash në këtë rast, ta zgjidhin këtë çështje, por kjo është e dëmshme për Kosovën. Është dëmshme, se krijon një gjendje, të cilën edhe organizatat e tjera kur dështojnë, kur falimentojnë, kur nuk mund të arrijnë objektivat e tyre, do të kërkojnë forma të tilla zgjedhjeje si marrëveshje ndërkombëtare dhe ta zgjidhin këtë çështje.

Ne kemi dy universitete në Mitrovicë, një e kemi në veri, një në jug dhe të dy universitetet kanë hapësira të mjaftueshme për edukimin dhe arsimin e të gjithë atyre qytetarëve që jetojnë, ndërsa të krijojmë edhe kësi forme të tillë, është një precedent që do t'i kushtojë Kosovës. Prandaj, unë mendoj që deputetët nuk duhet ta votojnë këtë dhe ato objekte nëse duhet t'i falen, le t'i falen Kosovës, por jo Kosova t'ia blejë ato objekte SPARK-ut, një organizate joqeveritare që mjaft dëm i ka shkaktuar Kosovës në raportin e diplomave dhe njohjes së tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Unë mendoj që për Mitrovicën ne duhet të bëjmë ende më shumë, sigurisht ka kritika, ato janë të tejkalueshme, por ne duhet t'i analizojmë mirë sendet dhe të bëjmë investime të dukshme për Mitrovicën, se ajo zonë ka nevojë për investime, ka nevojë për investim, ka nevojë për zhvillim dhe vetëm në këtë formë mund të bëhet integrimi i Mitrovicës ashtu si ne dëshirojmë të bëhet ai integrim.

Prandaj, çdo investim mendoj që duhet të jetë i analizuar hollësisht, në mënyrë të duhur, duhet të përkrahet dhe Mitrovica të shndërrohet me një zhvillim të përbashkët, unike, si Mitrovicë. Ne e përkrahim.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Bytyqi e ka fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Vetëm një sqarim të vogël, ndoshta për deputetin Hasani është e nevojshme.

Në marrëveshje është e qartë e shënuar se asnjë mjet nuk kalon në SPARK, në OJQ direkt, të gjitha mjetet kalojnë në universitet, pra në Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë.

Pra, kjo është e cekur saktësisht në marrëveshje dhe po ashtu MASHT-i do ta përcaktojë një përfaqësues të vetin, i cili e ka për obligim t'i përcjellë të gjitha shpenzimet që realizohen në këtë universitet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nait Hasani, ka replikë.

NAIT HASANI: Faleminderit, ministër, që ma dhe mundësinë edhe një herë të flas! Nëse ministër do të dështojë Kolegji AAB, do të falimentojë, a do t'ia blini objektin. Çka do të bëni me objektin e AAB-së, çka do të bëni me 27 kolegjet që janë, nëse do të dështojnë ata? Kush do t'i marrë ato, kah doni t'i çoni ato? A janë fitimprurëse ato? Jofitimprurës, në rregull jemi. 600 mijë euro në vit ne ia japim atij kolegji. Qeveria po e merr një kolegji privat, po e bën të vetin. Ne kemi universitete publike, tetë universitete publike i kemi, nuk e kemi një. Tetë universitete publike janë në Kosovë. Ky çfarë statusi do të ketë në bazë të ligjit, çfarë universiteti do të jetë ky, ngjitja emrin me ligj, futeni në proces të ligjit, jemi në rregull. Veç me këtë ju po e dëmtoni edhe konkurrencën, edhe të gjitha ato që do të dështojnë, do t'i shtini në formën e tillë.

Prandaj, mos kërkoni, se ne herën e kaluar e kemi kthyer pikërisht për këtë çështje, është në kundërshtim me ligjin. 27 kolegje janë në Kosovë, 8 janë universitete publike, të gjitha këto janë pjesë e sistemit të arsimit dhe ky kolegji tash kaloi, vetëm ky, e 27 të tjerë ku janë?

Mendoj që nuk e keni trajtuar mirë dhe në këtë po hyn në precedent, i cili do t'i kushtojë Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Po, gjithë kryetar i them, se më shpesh po rri ky se Kadriu këtu.

E para, dëshiroj të them që Partia Demokratike e Kosovës në mandatet e kaluara, së bashku me koalicionin që ka qenë Lidhja Demokratike, por në këtë rast do të flas pak për Partinë Demokratike që e ka pasur Ministrinë e Arsimit.

Nënkryetari i kësaj partie kishte thënë që janë bërë kolegjet si qebaporet, tekstualisht kështu kishte thënë profesor Enver Hoxha, po e citoj. Pastaj si duket, duke u hyrë në qejf qebaporet, u krijuan edhe pesë universitete publike pa pasur kurrfarë nevojë Kosova, në vend që të zhvillohet Universitetin publik në Prishtinë, duke e ditë që Kosova është një hapësirë shumë e vogël gjeografike, në vend që të investohet në Universitetin publik, t'i vijë era universitet, të bëhen kabinete, librari, u hapën krejt këto universitete publike vetëm të zbutet papunësia nëpërmjet studentëve.

Zakonisht qeveritë që nuk kanë vizion, që s'kanë plan të zhvillimit afatgjatë, besa as afatshkurtër për vendin, për popullin e vet, për të mos dalë të rinjtë nëpër demonstrata e të gjuajnë me gur, me 'patligjanë' e me 'kompira', këta hapin vende të punës, duke hapur universitete të reja, qoftë private, qoftë publike.

Prandaj, mbi bazën e kësaj që janë hapur vene e pavend në të kaluarën edhe universitetet private, kolegjet, edhe universitetet publike, unë po kërkoj një sqarim prej ministrit të Arsimit, në qoftë se këto para janë formë e kredisë apo në çfarëdo mënyre i kushtojnë buxhetit të Kosovës, unë personalisht nuk e votoj këtë ligj.

Nuk e votoj, sepse nuk jam fare i interesuar për kolegje private në Mitrovicë, nuk jam fare i interesuar për përrallat e ndërkombëtarëve që donë dhunshëm të na shtinë neve të krijojmë kolegje multietnike, ne boll multietnikë jemi këtu në Parlament e s'po merrem vesh hiq.

Kështu që ky farë multietniciteti është përrallë artificiale e këtyre politikanëve të moderuar të Kosovës, që ndërkombëtarëve u flasin për multietnicitet, e kur janë me ne paraqiten nacionalistë e fashistë, e janë krejt hipokritë. Ndërkombëtarët vijnë të bëjnë eksperimente këtu për të krijuar një shoqëri multietnike.

Ne nuk kemi nevojë në mënyrë absolute të harxhojmë para për kolegje të tilla, kemi nevojë të investojmë në Universitetin tonë publik dhe kemi nevojë ato kolegje private, të cilat veç janë hapur, të futen në brazë, të futen në terezi, të futen në autostradë të arsimit, sepse rrumbullak gjysma prej tyre nuk meritojnë të kenë as licencë të fermave, e le më kolegjeve private.

Prandaj, unë edhe një herë, i nderuar ministër, kërkoj një sqarim, këto para na kushtojnë a s'na kushtojnë? Që kemi para badihava, jepja, s'kam kurrfarë kundërshtimi. Në qoftë se ata kanë para të gjuajnë në kolegje, ama në qoftë se i kushton buxhetit, unë nuk e votoj.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Ministër i Arsimit,

Kjo marrëveshje mes SPARK-ut holandez dhe Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës, mbase koincidençë, por po vjen në një kohë kur arsimit i lartë në Kosovë, Ministria e Arsimit, komplet sistemi arsimor e ka marrë një lajm të keq lidhur me vendimin e EQUAR-it që në një farë forme është një alarm për Qeverinë e Republikës së Kosovës, për ne të zgjedhurit e popullit,

e në veçanti për ne disa që jemi këtu deputetë, por edhe jemi të angazhuar në mësimdhënie në arsimin e lartë.

Në këtë kuptim nganjëherë po i tejkalojmë edhe kompetencat, nganjëherë nuk po merremi sa duhet me infrastrukturën ligjore.

Unë dua të besoj fuqishëm që marrëveshja e Ministrisë së Arsimit e Republikës së Kosovës me SPARK-un holandez nuk e dëmton sistemin e arsimit në Kosovë, në radhë të parë, dhe dua të besoj që në Ministrinë e Arsimit dhe në Qeverinë e Republikës së Kosovës ka mjaft teknokratë dhe njerëz që një jetë e kanë lënë duke punuar në sistemin arsimor, në reforma, në trendët modernë. Nuk ka asgjë të keqe që kjo marrëveshje ta ndihmojë një kolegji privat ndërkombëtar, por që buxheti t'i transferohet direkt kolegjit dhe jo organizatave joqeveritare.

Si Grup Parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtuar në të gjitha aspektet këtë marrëveshje, ka pasur edhe hezitime, por për shkak të situatës në Mitrovicë, për shkak të nivelit dhe gjendjes në të cilat janë këto tetë universitete publike në Kosovës, për shkak të politizimit të skajshëm që u është bërë këtyre universiteteve, për shkak të një politike me dy kute, që fatkeqësisht Ministria e Arsimit deri më tani ka përdorur në mes të bartësve të arsimit të lartë universitar privat dhe atyre publik, me dallime enorme, me një amatorizëm të udhëheqjes së politikave për arsimin e lartë.

Prandaj, zoti ministër,

Kam kërkuar disa herë këtu, jo si deputet i opozitës, po si mësimdhënës i këtij niveli, kam kërkuar më shumë buxhet për Ministrinë e Arsimit, për Ministrinë e Arsimit të shtetit tonë, jo për ministrin, jo për atë infrastrukturë të establishmentit atje, por që ta zhvillojmë arsimin e lartë, arsimin universitar në vendin tonë.

Nën dy, duhet urgjentisht të fillojë një fizibilitet pragmatik për profesionet e 20 apo 30 vjetëve të ardhshme. Kur është bërë kjo analizë dhe kush duhet ta bëjë?

Prandaj, në parim shkëmbimi i kadrove universitare, shkëmbimet e studentëve, krijimi i një mjedisi normal edhe në Mitrovicë, sepse është ambient depresiv atje, i ndihmon integritit të komunës, i ndihmon integritit të Kosovës, e kemi shembull Universitetin e Shtullit në Maqedoni.

Në parim e mbështes këtë marrëveshje, por kërkoj që Ministria e Arsimit ta mbikëqyrë konform kompetencave kushtetuese ligjore dhe institucionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kam përshtypjen që ne në debatin që po e zhvillojmë për këtë pikë, kjo vlen në mënyrë të posaçme për ju, zoti ministër, pretendimet e deputetit Nait Hasani janë tepër serioze.

Ne po flasim, zoti Hasani, për pretendimet tuaja se fjala është për ta ndihmuar një organizatë joqeveritare, e cila ka falimentuar dhe për më tepër i ka shkaktuar dëm sistemit arsimor në Kosovë dhe ju, zoti ministër, por edhe Komisioni Parlamentar për Arsim që e ka trajtuar këtë temë është mirë të dilni në foltore dhe të na sqaroni se cila është e vërteta në këtë mes dhe nëse pretendimet e zotit Hasani janë të vërteta, atëherë mos na sillni në një situatë qesharake që ne eventualisht të diskutojmë për ratifikimin ose jo të kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare.

Nëse pretendimet e deputetit Nait Hasani janë të sakta, unë deklarohehem publikisht se nuk do ta votoj këtë marrëveshje dhe do të votoj ndryshe nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nezir Çoçaj, prapë e ke kërkuar fjalën?

NEZIR ÇOÇAJ: Po. Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Dua të jap disa sqarime shtesë, edhe njëfarë forme të bëj një farë replike a polemike edhe me deputetin e “Nismës”, Milaim Zeka.

Fillimisht dua ta sqaroj diçka, besoj se Naiti e di shumë mirë që kjo projekt-marrëveshje, kjo draft-marrëveshje nuk është antiligjore, përkundrazi ka bazë edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, edhe në Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare, po edhe në Ligjin për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës.

Të gjithë ne është mirë të kërkojmë edhe nga partnerët ndërkombëtarë që e kanë mbështetur sektorin e arsimit në Kosovë, jo vetëm këtë koleg të biznesit ta mbështesin, të mbështesin edhe të tjerë, edhe institucionet publike të arsimit të lartë. Ne kemi nevojë për mbështetjen e tyre, por nuk duhet të harrojmë ndihmën dhe mbështetjen financiare që kanë dhënë në çdo aspekt partnerët tanë ndërkombëtarë.

Është një marrëveshje që ka të bëjë me 3 milionë, ndërsa Kosova ka fituar në sektorin e arsimit shumë e shumë milionë të tjerë.

Unë besoj, në pikën e radhës e kemi prapë një marrëveshje, ku një partner ndërkombëtar i arsimit të lartë i jep një milion e 800 mijë euro për dy vjetët e ardhshme. Domethënë kjo nuk është diçka serioze që ne kërkojmë këtë nivel ta ulim.

Ju e dini se kjo marrëveshje fillimisht gjeneron me marrëveshjen që ka pasur edhe SIDA suedeze, Agjencia suedeze besoj se Milaimi e di mirë, se ka qëndruar në Suedi, ka ndihmuar jashtëzakonisht arsimin në Kosovë dhe për këtë arsye edhe SPARK-u ka kontribuar jashtëzakonisht shumë në Kosovë.

Për këtë arsye ne si grup, Naiti foli vetëm në emrin e vet si deputet, po ne si grup do ta mbështesim dhe do të mbështesim edhe projekte të tjera.

Po të njëjtën kohë po kërkojmë, edhe si deputetë, po edhe si grup, që çdo koleg sipas mundësive të mbështetet.

Duhet ta dimë që SPARK-u është organizatë jofitimprurëse, kolegjet private janë fitimprurëse, kjo është dallimi.

Sa i përket asaj që ka pasur nevojë për të hapur universitete, sot po dëgjoj në Kuvend të Kosovës, po edhe jashtë Kuvendit të Kosovës kam dëgjuar që ne s'kemi nevojë për universitete, më duket tepër absurde, jashtëzakonisht absurde. Ne kemi nevojë, por nuk e kanë mundësitë fëmijët e qytetarëve të Kosovës, as të Dragashit, po as komunave të tjera periferike t'i sjellin në Prishtinë. Unë kam mundësi t'i bie fëmijët e mi në Prishtinë të studiojnë, por ata nuk kanë mundësi. Ndryshe është kur një familje i shkollon tre apo 4 vetë në fshatrat periferike të Kosovës, ndryshe kur ka mundësi të shkojë vetëm një e vjen në Prishtinë. Ne kemi nevojë, rinia jonë e Kosovës ka nevojë për arsim dhe ka nevojë për diploma që njihen.

Ne po synojmë dhe tentojnë çdo herë në vazhdimësi ta ngremë cilësinë që këto diploma që fitohen në universitet tona, qoftë publike, qoftë private, të njihen kudo në botë dhe të rinjtë tanë të kenë mundësi të shkojnë në Evropë edhe për të punuar nëpër vendet e ndryshme të punës që kanë kredibilitet, jo të shkojnë qysh kanë punuar, me keqardhje e them, shumica e shqiptarëve deri vonë kanë punuar punëtorë krahu.

Partia Demokratike kurrë nuk ka hapur asnjë universitet sa për vende të punës.

Të gjithë ata profesorë a rektorë punojnë, kanë punuar, po qëllimi ka qenë arsimimi dhe të ketë një arsimim sa më të mirë. Këto dy vjetët e fundit secili universitet, edhe publik, edhe kolegjet universitare në Kosovë, kanë pasur rritje në vlerësimet ndërkombëtare që janë bërë, po këto vlerësime i kanë bërë ndërkombëtarët, nuk i ka bërë as Partia Demokratike, as Qeveria e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministri i Arsimit, zoti Shyqiri Bytyqi.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar deputet Zeka,
Për mua është me rëndësi që t'i sqarojmë gjërat, pastaj jeni ju deputetë dhe merrni vendimet.

Derisa ne themi që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në bazë të marrëveshjes do ta mbështetë financiarisht kolegjin në shumën 600 mijë euro, normalisht kuptohet që kjo është kostoja, nuk është kredi, është vijë buxhetore, e cila ndahet nga ministria për këtë kolegji.

Lidhur me çështjen e falimentimit apo jo të një organizate joqeveritare, besoj që edhe zoti Hasani, edhe zoti Nitaj, të dytë e dinë që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk merret me vlerësimin apo jo të një organizate, a është në falimentim apo jo.

Ne jemi duke financuar një kolegji arsimor, po bëhet një marrëveshje ndërkombëtare për financimin e këtij kolegji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë janë lajmëruar zoti Nait Hasani dhe Milaim Zeka.

NAIT HASANI: Faleminderit!

Për mua është me rëndësi që një qytet, si Mitrovica, që ka shumë pak banorë, i kemi tri universitete publike, dy etnike dhe një multi-etnik. Kjo është mjaft e rëndësishme për shtetin e Kosovës që po do të aderojë në Bashkimin Evropian.

Prandaj, unë e mbështes ministrin e Arsimit, ku thotë që ne do të financojmë, po kolegjet private nuk mund t'i financojë, Ligji i arsimit të lartë nuk e lejon, sepse e lejon konkurrencën. Janë 27 universitete ose kolegje të tjera që kërkojnë mbështetje ata si organizatë jofitimprurëse kanë dështuar në angazhimin e tyre edukativo arsimor multi-etnik dhe tash duan t'ia lëshojnë Kosovës këtë karrem që ta blejë për çdo vjet nga 600 mijë euro për 5 vjet. Kjo do të thotë është fitimi i Kosovës që ne duhet t'i paguajmë ata.

Unë falënderoj edhe kolegjin që e arsyetoi, që edhe ne jemi për universitete, por jo tri universitete publike në një qytet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Desha t'i përgjigjem zotit Nezir Çoça, që është pikërisht Partia Demokratike e Kosovës që e ka bërë sallatë të prishtë arsimin në Kosovë, sepse kanë udhëhequr Ministrinë e Arsimit dhe krimin më të madh kjo parti e ka bërë pikërisht në arsim, këtë e ka treguar edhe testi PISA, ku kemi dalë tamam pisa, budallenj.

Edhe tjetra është, po i tregoj Nezir Çoçës se organizata SIDA e Suedisë ka dhënë para për Qeverinë e Agim Çekut së bashku me “Riinvest”-in në kohën e Agim Çekut 1.8 milion euro, edhe me DFID-in anglez krejt këto para janë vjedhur.

Kështu që fare nuk është interesant për mua a jep SIDA suedeze, DFID-i a USAID-i amerikan. Për mua është interesant si deputet i Parlamentit të Kosovës të them publikisht se Ministria e Arsimit ka ku i çon ato 600 mijë euro dhe duhet t’i investojë në Universitetin Publik “Hasan Prishtina” në Prishtinë dhe unë edhe një herë po them si deputet nuk e jap votën pro pas sqarimit të ministrit, i cili deklaroi se këto para do të jepen nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe janë në vija buxhetore. Kaq për mua ka rëndësi. Të tjerat a e kemi arsimin e mirë, a kemi të keq, janë qytetarët e Kosovës që e përcaktojnë.

KRYESUESI: Kundër-replikë ka zoti Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë prapë po i them zotit Milaim Zeka, që nuk është sallatë, po përkundrazi, ne e dimë në çfarë rrethanash kemi dalë prej luftës, mësuesit e vitit 89-99 janë heronj të Kosovës, se nuk kanë shkuar as në Suedi, as në Gjermani, as në Zvicër, por kanë qëndruar me fëmijët përballë tankeve dhe përballë makinerisë serbe, kanë mbajtur mësim. Unë kam punuar si mësues dhe e di çka është të dridhet mësuesi në shkollë kur kalon një tank me 70 tonë. Këtë duhet ditur.

Në sistemin tonë arsimor ke pasur mësues me përgatitje të ndryshme, ne e kemi mundësuar që të gjithë të kenë fakultet katërvjeçar, është një kriter, pastaj kemi kërkuar dhe po kërkojmë në vazhdimësi Ministra e Arsimit që mësuesit të kenë edhe master, të kenë 6 vjet fakultet.

Sa për PISA-n, Milaim, e di që kam një minutë, se po më shkojnë sekondat, PISA, Gjermania, Amerika, Italia janë tmerruar nga hera e parë kur i kanë marrë rezultatet. Po të them, Amerika, Gjermani, Italia, shumë shtete të forta me rezultatin e parë. PISA është përgjigje konkrete e fëmijëve. Ne kemi ndryshuar kurikulën me bazën e kompetencave për këtë arsye.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri, zoti Ramush Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

E kemi sistemin tonë arsimor të ndërtuar në institucione prej nivelit parashkollor deri të atij të lartë universitar, por ka diçka që është me rëndësi të kihet parasysh.

Ka ndodhur disa kontribute në sistemin tonë arsimor ose në arsim, e kontributet të cilat ne mund t'i përvetësojmë, t'i marrim. Ky është një rast konkret, është institucion arsimor, i cili i kalon në pronësi Kosovës.

Çka merr Kosova me këto para që i ndan për disa vjet, për një periudhë të caktuar, e merr institucionin, infrastrukturën, e merr projektin në tërësi, pra brendin, dhe nuk janë para të hupëta.

Duke pasur parasysh që për disa vjet një qeveri e huaj ka dhënë jo kaq, po më shumë para pikërisht për arsim, pra për fëmijët tanë, ne duke e përvetësuar këtë projekt, besoni nuk po falim para, po përvetësojmë në këtë rast, një kontribut, një imput, një projekt për arsimin e brezave e fëmijëve tanë. Tani, e çka tjetër dhe pse më shtyri të dal? Unë shkurt po ju them, sa ishim në Ajova më bëri përshtypje shumë një institucion i arsimit profesional. Ta zëmë, fëmija kur e kryen shkollën e mesme mund të shkojnë dy vjet për arsim profesional, e nëse insistojmë pas këtyre dy vjetëve, mund të vazhdojnë prapë në arsim të lartë.

Po në arsimin profesional, ... siç i thoshin ata, shumë mirë e organizuar, merrnin profesione konkrete, direkt. Do të ishte diçka e mirë, lajm i mirë për Kosovën që disa projekte të tilla të aftësimi, pra që janë impute të cilat ne s'kemi mbërritur t'i krijojmë në arsimin tonë, në sistemin tonë arsimor përmes institucioneve tona, t'i përvetësojmë edhe nga këto të japim produkt dhe t'u mundësojmë të rinjve tanë të jenë kompatibil për punë, për treg. Tani unë e kuptoj logjikën që janë para të buxhetit, edhe ne po japim para buxhetit, por edhe këto paratë e buxhetit e kanë një qëllim, pra diku jepen. Nëse po i japim për të marrë një projekt të arsimit, të aftësimi të fëmijëve tanë, një infrastrukturë, një brend, krejt çka ekziston në të cilën është investuar ndër vite, besoni që s'po i humbim ato para. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konsideroj që diskutimet për këtë çështje janë shteruar, përveç nëse dëshiron ministri ta marrë fjalën. Jo!

Atëherë, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, këtë e lëmë për t'u votuar kur janë 2/3 e deputetëve të pranishëm, sepse për të votuar këtë ligj kërkohen 2/3 e votave, është marrëveshje ndërkombëtare.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës me Agjencinë Austriake për zhvillim, ADA

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacione dhe Ndërmarrësi e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Ftoj ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zotin Shyqiri Bytyqi që të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin në fjalë.

Zoti Bytyqi, fjala për ju!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Sot para jush paraqes për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA.

Për informacionin tuaj, ky projektligj ka kaluar të gjitha procedurat e parapara në legjislacionin në fuqi dhe ka marrë të gjitha dokumentacionet mbështetëse nga organet kompetente për miratim. Objektivi kryesor i këtij projektligji është financimi dhe udhëheqja e zbatimit të projektit “Arsimi i lartë hulumtues dhe shkencat e aplikuara në Kosovë”. Projekti mban shifrën 81160/2016, me përshkrimin ADK. Këtu e tutje referohet si projekt. Projekti do të financohet nga MASHT dhe ADA si në vijim: MASHT-i do të sigurojë fonde për masa plotësuese për projektin në shumën maksimale prej 200 mijë eurosh, kontributin nga MASHT-i do të plotësojë aktivitetin e projektit. Duhet të sigurohet para nënshkrimit të marrëveshjes së grantit ndërmjet ADA-s dhe një partneriteti për zbatimin e projektit në fjalë. ADA bie dakord që ta bashkëfinancojmë projektin në fjalë në shumën maksimale prej 1 milion e 800 mijë euro. Krejt në fund dua t’ju them se rëndësia e këtij projekti është e veçantë për ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë, në veçanti në shkencat e aplikuara në Kosovë, si një domosdoshmëri e zhvillimit të këtij sistemi.

Prandaj, të nderuar deputetë, kërkoj nga ju që ta miratoni këtë projektligj me rëndësi të veçantë për arsimin e lartë, projekt që do të jetë bashkëfinancim me një organizatë ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Ftoj përfaqësuesin e Komisionit Funkcional, respektivisht nënkryetaren e komisionit, zonjën Haxhiu që ta arsyetojë raportin e komisionit.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2018 shqyrtoi Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA, me referencë Nr. 8116 02/2016, nr. 2016. Komisioni vlerësoi se projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së mirëkuptimit për programin e projektit që do të financohet nga ADA dhe MASHT, andaj duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji, i rekomandon Kuvendit për ratifikim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare, Grupi Parlamentar i LDK-së, zonja Bunjaku-Rexhepi e ka fjalën.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër i Arsimit,

Në parim, do ta mbështetim këtë marrëveshje të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA. Ne vlerësojmë lart punën e Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA, sikur edhe punën e madhe që po bën në Kosovë USAID-i amerikan, GIZ-i gjerman e kështu me radhë.

Agjencia Austriake për Zhvillim ADA ka mbështetur komunat tona në shumë grante dhe projekte, siç është granti i fundit për zhvillim në komunën e Dardanës, punësimin e qytetarëve në komunën e Dragashit dhe Shtërpcës, ndihmën e fermerëve të Gjakovës, e shumë, e shumë projekte të tjera. Edhe këtë marrëveshje të bashkëpunimit në mes të MASHT-it dhe ADA-s do ta përkrahim në parim. Ne si deputetë dhe si Lidhje Demokratike besojmë se secila marrëveshje e Qeverisë së Kosovës me agjencitë qeveritare dhe joqeveritare të shteteve të zhvilluara evropiane, amerikane dhe më gjerë, të cilat ndikojnë në zhvillimin e fushave të ndryshme, e sidomos në fushën e arsimit, duhet të përkrahen. Prandaj, ne do të votojmë pro kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, a dëshiron dikush fjalën? Zoti Çoçaj e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Pa dyshim që ne do ta mbështesim dhe është një projekt i një partneri jashtëzakonisht të rëndësishëm ndërkombëtar, këtu e kemi me një farë forme kthimin e atyre parave që i dhamë në pikën e kaluar, e po shpresoj që edhe jashtëzakonisht shumë do të kemi mbështetje edhe në projekte të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i japim mbështetje të plotë kësaj marrëveshjeje, për dallim nga ajo që financiarisht i kushton buxhetit të Republikës së Kosovës, kjo i sjell shumë të mira Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “Nisma”, zonja Halimaj.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Ne zoti kryesues, kur marrim mjete, jemi të mirë, kur japim, pak e teprojmë ndonjëherë. Megjithatë, marrëveshja e MASHT-it dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA mbështet arsimin e lartë dhe hulumtimet në vlerë prej 1 milion e 800 mijë eurosh. Me këtë marrëveshje mbi të gjitha përfitojnë studentët, prandaj Grupi Parlamentar i “Nismës social-demokrate” e mbështet në parim Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet MASHT-it dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA.

KRYESUESI: Faleminderit! “6+” zonja Shinik.

MÜFERA SRBICA-ŞINIK: Faleminderit, kryesues!

Kosova Eđitim, Bilim ve Teknoloji Bakanlıđı ile ADA Avusturya Kalkınma Ajansı uluslararası memorandum anlaşması Yasa Tasarısının eđitim Komisyonunda gerekli tartışmayı yaparak 6+ Parlamenter Grubu olarak katkımızı sunduktan sonra bu anlaşmanın Kosova eđitim şartlarına uygun getirildiđinden dolayı kabul edilmesi gerektiđine inanmaktayız. 1.800 000 deđerinde olan meblađı yüksek öğrenime ciddi bir destek oladıđunu görüyoruz bu yüzden de 6+ Parlamenter Grubu olarak desteđimizi sunuyoruz.

Teşekkür ederim, faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur, nuk e ka kërkuar askush fjalën. Ministri s’e do fjalën shtesë. Atëherë, konsideroj se debati është i kryer sa i përket shqyrtimit të Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA, në mbledhjen e radhës kur bëhen 2/3 e votave dhe ky projektligj kalon, në qoftë se janë votat, ose nuk kalon.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike ReSPA

Të nderuar deputetë,

Zonja deputete,

Komisioni Funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin të marrëveshjes dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Ftoj ministrin e Administratës Publike, zotin Mahir Jagxhillar, që të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ju informoj se ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike ReSPA, me seli në Danilovgrad, në Mal të Zi.

Kjo organizatë është themeluar më 2 maj të vitit 2006, nga përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, Republikës së Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe administratës së atëhershme të përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK, që ka vepruar në emër të Kosovës, në prezencë të Komisionit Evropian. Por, deri tash nuk është nënshkruar as nga pala e UNMIK-ut, as nga Kosova. Pas aplikimit më 30 maj 2012, në nëntor të vitit 2013 Kosova ka përfutur status të anëtarit të plotë, por ende nuk është përfunduar procesi i ratifikimit dhe pagesës së anëtarësimit.

Me ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e shkollës, Republika e Kosovës është pjesëmarrëse në arenën e vendeve të rajonit, duke qenë e pranishme në forumet, vizitat studimore, trajnimet, si dhe në reforma të reja në administratën publike të vendeve të rajonit. Arsyeja kryesore e propozimit të këtij projektligji është që Kosova përmes përfaqësuesve të saj të jetë pjesëmarrës në aktivitetet që ofron ReSPA, pra në analizën e nevojave rajonale, trajnimin e punonjësve të shërbimit publik, sistemet e trajnimit, rrjetit, shkëmbimeve, komunitetet e praktikës, burimet e informacionit, metodologjitë dhe materialet e trajnimit. Kështu me këtë projektligj Kosova do të bëhet anëtare e rregullt të Organizatës Rajonale të ReSPA-s, e cila është mekanizëm rajonal që siguron trajnim dhe arsyen për administratën publike.

Projektligji përbëhet prej katër neneve, është hartuar në përputhje me Rregulloren e punës së Qeverisë, projektligji ka formën dhe strukturën standarde në pajtim me Udhëzimin Administrativ 03/2013, për standardet e hartimit të akteve normative. Për këtë projektligj janë konsultuar të gjithë organet, të cilat janë përcaktuara në nenin 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë. Projektligji është në pajtim me Kushtetutën dhe nuk cenon ndonjë nga parimet e përgjithshme të 'acquis communautaire'. Gjithashtu, sa i përket koston dëshiroj t'ju informoj se është anëtarësimi për të gjitha shtetet e njëjta, me shumën 150 mijë euro për një vit.

Të nderuar deputetë, në këtë aspekt ju propozoj që të aprovoni këtë projektligj, me qëllim që Kosova të bëhet anëtare e Organizatës Rajonale të ReSPA-s. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, zotin Hasani, për arsyetimin e raportit të komisionit.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni më 20. 02. 2018 ka shqyrtuar këtë marrëveshje për krijimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike ReSPA dhe ka vendosur që Kuvendit t'i kërkojë për miratim këtij projektligji. Edhe pse ka pasur disa hezitime në komision, për të cilat kur është themeluar kjo shkollë ka qenë viti 2006, ka qenë e nënshkruar nga UNMIK-u, dhe vazhdimësia e saj më 2009

po ashtu ka kërkuar që me asterisk të vendoset dhe kjo ka qenë një dilemë, ku e kemi pasur ministrin në komision dhe ka arsyetuar që këto janë marrëveshje, që duhet të barten si pjesë e saj, ndërsa shkolla funksionon në bazë të marrëveshjes, e tash Kosova është shtet dhe i plotëson të gjitha kushtet për miratim.

Prandaj, kërkojmë që deputetët ta miratojnë këtë marrëveshje që është në të mirën e krijimit të mundësive, edhe Administrata Publike të jetë pjesë e një shkolle të trajnimit dhe të plotësimit të kushteve më të mira për ngritje me standarde. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” nuk është paraqitur askush. Grupi Parlamentar i LDK-së, zoti Imet Rrahmani.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar marrëveshjen, sikur që kemi qenë edhe pjesë e shqyrtimit bashkë me komisionin kur ka qenë prezent edhe ministri dhe dilemat që i tha kryetari i komisionit i kemi pasur edhe ne. Meqenëse, janë dhënë sqarime se nuk kemi kurrgjë të bëjmë më me Administratën e UNMIK-ut, por marrëveshje është arritur në atë kohë kur ne jemi thirrur brenda asaj administrate dhe kemi kuptuar se shërbimet Kosova tashmë është duke i marrë brenda kësaj shkolle dhe kjo marrëveshje mundëson një plotësim të të gjitha aktiviteteve që i bën Instituti Kosovar për Administratë Publike.

Duke u nisur nga kjo, ne e mbështesim dhe do të votojmë pro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar marrëveshjen në fjalë dhe i gëzohet ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, sepse hap rrugë për anëtarësimin, apo më mirë të themi zyrtarizmin e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në një shkollë që ka një vlerë jashtëzakonisht të madhe në aspektin ndërkombëtar.

ReSPA do të ndihmojë veçanërisht në fushën e bashkëpunimit rajonal dhe integriteteve evropiane dhe ne konsiderojmë që përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të ReSPA-s do të jetë jashtëzakonisht i rëndësishëm për forcimin e Administratës Publike në vendin tonë. Pra, sot ne nevojitet që të votojmë, mirëpo sigurisht që si anëtarë të komisionit të fushës përkatëse do ta përcjellim edhe punën në vazhdimësi të shkollës në fjalë. I ftojme që të votojnë edhe kolegët, ne do të votojmë për. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zeka!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Ne si Grup Parlamentar e mbështesim për dy arsye: e para, për hir se dakordohemi me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe ministrin që dha arsyetimin e LDK-së, dhe e dyta, se konsiderojmë që ministri Jagxhillar ka përshkruar në mënyrë të mirë këtë shkollë dhe ajo është diçka që nuk na sjell dëm. Prandaj, ftojme edhe ne që të votohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli, në emër të “6+”.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike ReSPA, edhe pse gjatë punës në komision kemi pasur disa mospajtime, mirëpo duke falënderuar sqarimeve të nevojshme, të cilat kanë ardhur nga ana e ministrit Jagxhillar, gjithçka është evituar dhe është sqaruar në mënyrë më të mirë të mundshme.

Kështu që kemi pasur konsensus dhe si Grup Parlamentar “6+” e përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe unë dua të them që është shumë e qëlluar dhe shpresoj që vërtet do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së administratës dhe pjesës që do të rekrutohet dhe do të edukohet në këtë shkollë. Le të ndalen ato edukimi seminarik i administratës së Kosovës, ose më mirë të themi përmes seminareve dyditore dhe pastaj të na mbulojnë me letra koti.

Atëherë, nuk ka kuorum të mjaftueshëm, e lëmë që të votohet në 2/3 në seancën e radhës.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Ftoj kryetaren e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, zonjën Sala Berisha-Shala, që në cilësinë e propozuesit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zonja Shala, e keni fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Dhe ju të pranishëm,

Para se të hyj në ekspozenë e ligjit, më lejoni që t' i falënderoj anëtarët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, kolegët e mi deputetë, për mbështetjen që i kanë dhënë këtij ligji të ri me propozimin tim dhe kjo tregon një unitet të deputetëve, pavarësisht partive politike kur është në pyetje e mira e përgjithshme dhe zhvillimi ekonomik i vendit.

Duhet theksuar se para iniciativës për ligjin e ri, Komisioni për Zhvillim Ekonomik në legjislaturën e kaluar pati krijuar një grup punues, i cili ka monitoruar industrinë minerare, ku veç imputeve nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, si dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, kemi diskutuar edhe me kompanitë minerare. Me këtë rast është arritur pajtueshmëri unike për draftimin e projektligjit të ri, duke konsideruar si më të lehtë gjatë përdorimit praktik nga institucionet relevante, me çka nuk do të thirreshin në dy apo tre dokumente ligjore, duke eliminuar kështu edhe konfuzionet dhe gabimet e ndryshme.

Meqenëse legjislatura e kaluar e la në gjysmë ligjin, sepse shkuam në zgjedhje të parakohshme, prapë me propozimin tim para komisionit, me miratimin natyrisht të kolegëve të mi deputetë, i kemi hyrë punës për draftimin e ri të këtij ligji. Grupi punues ka realizuar takime, në bazë të cilave është hartuar ky draft që e kemi para nesh. Grupi punues në takimin e tij të parë, më 7 nëntor të vitit 2017, pas diskutimeve vendosi të përfshihen si pjesë e grupit punues përfaqësues nga institucionet relevante, si zbatues të ligjit, siç është Zyra e Kryeministrit, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Shoqëria Civile, e kështu me radhë. Kemi mbajtur mbledhje të njëpasnjëshme që nuk po dëshiroj t'ju humb kohë në këtë drejtim, mandej në mbështetje të shoqërisë civile, në këtë rast INDEP, kemi mbajtur edhe një punëtori dy ditore, në të cilin kemi punuar intensivisht dhe kemi hartuar këtë projektligj.

Nisma legislative e komisionit, më 30 nëntor 2017, në bazë të nenit 53, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, është proceduar në Kryesi të Kuvendit për procedim të mëtutjeshëm në Qeveri për mendim. Qeveria ka dhënë mendimin e saj më 15 janar 2018 dhe projektligji ka hyrë në procedura të rregullta të shqyrtimit në Kuvend. Cilat janë, në fakt, ndryshimet nga ligji aktual që është në fuqi? Me anë të këtij draft-ligji industria minerare avancohet më tutje. Në ligjin në fuqi aplikuesit është dashur që të aplikojnë në shumë institucione për kompletim të dokumenteve për licencë dhe leje, ndërsa me ligjin e ri që e kemi në shqyrtim tani, sot, Komisioni i Minerave do të kryente të gjitha procedurat administrative, që zhvillohen në kuadër të organeve tjera relevante aplikimi në një vend të quajtur “once top shop”. Ky fakt eliminon burokracinë dhe rritë efikasitetin që ndikon drejtpërsëdrejti në investime, për të cilat Kosova ka aq shumë nevojë.

Me ligjin në fuqi, zonat e shpallura nga Qeveria si zona me interes të veçantë minerar nuk janë vendosur afate për fillimin e zhvillimit të tyre, ndërkohë që me këtë ligj do t'u jepet mundësi zhvillimi të këtyre zonave që janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e industrisë minerare dhe në fakt për zhvillimin ekonomik të vendit. Më tutje me projektligj lejohet hulumtimi dhe shfrytëzimi për përdorim në shkallë të ulët i qymyrit për prodhimin e produkteve dhe nënprodukteve të qymyrit për qëllime komerciale, pasi që me zhvillimin e teknologjisë po krijohen mundësi për avancim të shfrytëzimit të qymyrit edhe për çështje tjera, jo vetëm për gjenerimin e energjisë elektrike.

Me ligjin në fuqi nuk parashihen dispozita për hulumtim të naftës dhe gazit për çka është paraqitur nevoja që të rregullohet edhe ky segment me Ligjin e minierave dhe tani draft-ligjin që e kemi para nesh e adreson edhe këtë problematikë. Me ligjin në fuqi garancitë bankare janë kërkuar në letra me vlerë të një cilësie të tri A-ve, të cilat janë kosto të larta dhe nuk mund të gjenden as në rajon, prandaj ka qenë pengesë për investitor serioz ky kush ligjor dhe ne me draftin që e kemi tani e kemi adresuar edhe këtë problem dhe është më atraktiv, si për kompanitë vendore, ashtu edhe për investitorë potencialë të huaj. Projektligji ka thjeshtuar procedurat për shfrytëzimin zejtar në shkallë të ulët të minerare dhe duke lënë që me akt nënligjor Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale të rregullojë mënyrën e dhënies së licencave të shfrytëzimit për qëllime zejtare, domethënë në masë të vogël.

Projektligji si pjesë të përgjithshme të reformave rregullon që një pjesë e të hyrave nga rentat minerare të investohet në zonën e komunitetit, ku ushtrohet aktivitetet minerar. Siç e dini, deputetë, me dy ligjet e mëparshme siç është Ligji për “Trepçën” dhe Ligji për Obiliqin, kjo dispozitë ligjore veçse është aty dhe prandaj për të mos përjashtuar të gjitha operimet minerare dhe zonat në Kosovë ku ka kësi aktiviteti, e kemi rregulluar edhe me këtë ligj për të gjitha operimet që të kenë kushtëzim që një pjesë e të hyrave nga rentat të investohet në zonën e komunitetit, natyrisht me specifika të caktuara.

Me projektligj është rritur përgjegjësia dhe llogaridhënia e Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale duke përfshirë dispozitat, që në rast të performansës së dobët për dy vite të njëpasnjëshme në zbatim të funksionit dhe përgjegjësi, Kuvendi i Kosovës mund të nisë procedurën për shkarkimin e anëtarëve të bordit. Kjo domethënë i sjell para përgjegjësisë këto agjenci që i përgjigjen Kuvendit dhe kemi mënyrë më të lehtë të kontrollit të performansës së tyre. Mandej, sa i përket parandalimit dhe ndalimit të operimeve ilegale, projektligji i jep kompetencë edhe Policisë së Kosovës dhe institucioneve tjera, që të ndërmarrin masa për ndalimin e operimeve minerare ilegale.

Meqenëse, iniciativa e hartimit të këtij projektligji ka qenë nga komisioni, gjatë gjithë procesit grupi punues ka bashkëpunuar ngushtë dhe është koordinuar me ministritë relevante, si dhe me

shoqërinë civile. Ju ftoj që ta mbështetni këtë projektligj dhe kontributin tuaj ju ftoj që ta jepni gjatë fazës së amendamentimit.

Nënkryetar, nëse më lejohet, edhe në emër të komisionit...

Komisioni pas shqyrtimit në parim të projektligjit vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-27 për miniera dhe minerale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Tani ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë për këtë projektligj. Ministri? Mirë! Atëherë, Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”. Lidhja Demokratike e Kosovës. PDK-ja foli, AAK-ja nuk ka, Lista serbe nuk ka. Zonja deputete, në emër të kujt? Të lutem, zonja deputet, e çmoj entuziazmin tënd të jashtëzakonshëm, por ta kryejnë grupet parlamentare njëherë. Njëherë grupet parlamentare të lutem. Vetëm ta përfundojnë grupet e pastaj si deputete flet prapë. Kërkoj falje!

Grupi Parlamentar Lista serbe. “Nisma për Kosovën”, zoti Enver Hoti, se jam te grupet parlamentare.

ENVER HOTI: Grupi Parlamentar “Nisma Socialdemokrate” e mbështet në parim Projektligjin për miniera dhe minerale dhe gjatë amendamentimit do ta japë kontributin e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “6+”, zonja Duda Balje.

DUDA BALJE: Hvala vam!

I Parlamentarna Grupa “6+” je vršila razmatranje ovog zakona i svoj doprinos naravno daće kroz rad u komisiji. Dugo smo pričali o ovome i mislim da je jedan oda zakona koji je jako potreban Kosovu. Daćemo svoj doprinos i glasaćemo u načelu za ovaj zakon. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Tanimë është radha e kolegëve deputetë. Kemi vetëm zonjën Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Kryetar, faleminderit për fjalën!

Një sqarim të shkurtër dua ta bëj.

Në emër të sponsorizuesit fola në foltore dhe në cilësinë e kryetares së Komisionit për Zhvillim Ekonomik. Jam e autorizuar edhe në cilësinë e përfaqësueses së Grupit Parlamentar, që përputhet mendimi im me mendimin e grupit, kështu që realisht ju nuk ishit këtu kur filloi shqyrtimi i këtij ligji, por s’prish punë.

Tani po dua t'i kthehem fjalës sime. Së pari dua të potencoj se Kosova vitet e fundit ka krijuar strukturë të avancuar të politikave minerare përmes strategjisë minerare 2012 – 2025 e aprovuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2012. Gjithashtu, edhe Ligji aktual i minierave i miratuar në vitin 2012 dhe i plotësuar në vitin 2013 me anë të Ligjit 04/L-158 për nga përmbajtja i përgjigjet nevojave për zhvillimin e industrisë minerare konform kërkesave dhe standardeve globale, fakt ky i cekur edhe në konferencat ndërkombëtare dhe forumet e ndryshme minerare, ku Kosovën e rangojnë si lider në rajon, sa i përket legjislacionit dhe politikave minerare. Megjithatë, krahas zhvillimit të sektorit minerar në vend, i cili nga renta minerare në vitin 2006 grumbullonte rreth dy milionë e gjysmë, ndërkohë që në vitin 2017 grumbullon më shumë se 31 milionë euro dhe po ashtu tani kemi edhe një numër të konsiderueshëm të kompanive me renome ndërkombëtare, siç është Kanadaja, Turqia, Polonia, Shqipëria e tjera, që janë duke kryer hulumtime gjeologjike prej të cilave ka arritur në fazën e para fizibilitetit.

Dua të theksoj se aktualisht sektori minerar punëson mbi 16 mijë veta. Praktikisht minerare ndërkombëtare tregojnë që një numër i punësuar në minierë gjeneron indirekt tre vende pune në veprimtari të ndryshme e që një kalkulim i thjeshtë do të thoshte rreth 50 mijë vende të tjera pune.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe në emrin tim personal kërkoj që ta mbështesim të gjithë dhe kërkoj nga Qeveria, që ta ketë një vëmendje shumë serioze në zhvillimin e sektorit minerar, duke i pasur parasysh të gjitha këto që u thanë edhe në ekspozitën e ligjit, po edhe në fjalën time në emër të Grupit Parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Duke pasur parasysh se kolegët deputetë aktualisht nuk janë prezentë në sallë për të votuar, votojmë në momentin kur të kemi numrin e mjaftueshëm.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që para jush të paraqes dhe ta arsyetoj Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034.

Në kuadër të këtij projektligji ka ndërhyrje në Ligjin bazë për Prokurorin e Shtetit, si dhe në amendamentet e vitit 2015. Ndërhyrjet janë bërë kryesisht në amendamentimin që i janë bërë ligjit bazë, pra në vitin 2015 dhe këto ndryshime janë:

- rishikimi i kriterëve për emërimin e prokurorëve në Prokurorinë Speciale dhe barazimi i tyre në kriteret për emërimin e prokurorëve në departamentin e krimeve të rënda;

- mundësinë që kryeprokurori i shtetit të mund të caktojë prokurorët në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, sipas nevojave urgjente dhe ngarkesës me lëndë në këtë prokurori.

Të nderuar deputetë, caktimi prokurorëve është i përkohshëm dhe atë deri në një vit, me mundësi vazhdimi plus një vit tjetër, me qëllim që stafi administrativ i prokurorisë të vazhdojë të ketë statusin e shërbyesve civilë është fshirë dispozita që i referohet nxjerrjes së një ligji të ri, pasi që kjo është parë si e panevojshme për faktin se legjislacioni për shërbyesit civilë është mjaft i avancuar në Republikën e Kosovës. Po ashtu, harmonizohet edhe aspekti i terminologjisë me ndryshimet sa i përket institucionit kompetent për trajnime, nga se tashmë është kompetent për ofrimin e trajnimeve Akademia e Drejtësisë.

Projektligji ka për qëllim ngritjen e efikasitetit në shkallë më të lartë të sistemit prokurorial, duke mundësuar caktimin e prokurorëve me qëllim të efektivitetit më të madh në punë. Me këtë rast, dëshiroj të theksoj se përmes miratimit të këtij projektligji në masë të madhe do të ndikojë në shtimin e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, do të bëjë të mundur që prokuroria të kompletohet me prokurorë, e cila mund t'i kryejë funksionet me qëllim të luftimit sa më të suksesshëm të korrupsionit, krimit të organizuar dhe përmbushjes së mandatit të saj.

Të nderuar deputetë,

Për njoftimin tuaj, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës në organogramin e saj ka pesëmbëdhjetë prokurorë specialë pra, mirëpo prej themelimit të saj, për shkak të kriterëve të rënda, asnjëherë nuk ka arritur ta përmbushë numrin e prokurorëve prej pesëmbëdhjetë, sa është në organogramin e saj. Po ashtu, ky projektligj është pjesë e obligimeve tona si shtet, që ndërliohen me agjendën evropiane të reformave dhe zbatimin e planit kombëtar për MSA-në. Duke pasur parasysh zëvendësimin e këtij projektligji, ju ftoj që ta përkrahni në leximin e parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Kryetarja e komisionit nuk është e pranishme. Hajdar Beqa, në emër të komisionit.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Legjislacion duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datë 6.02.2018 e shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 05/L-034.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare duke vepruar në pajtim me nenin 56, paragrafin 2 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi në parim projektligjin e theksuar dhe konstatoi se projektligji plotëson kushtet që t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim.

Për këtë arsye, i rekomandon Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin e Projektligjit në pajtim me rregullat e Rregullores së Kuvendit.

Nëse më lejohet, kryetar, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar ligjin në fjalë, i cili grup do të thotë do të jep edhe deputetët do ta japin kontributin në mes dy leximesh. Ky ligj i plotëson, thash edhe si komision, po edhe si grup, të gjitha kriteret dhe është në vazhden e reformës legislative, do të thotë që ka bërë Ministria e Drejtësisë, që është për t'u vlerësuar. Kemi pasur disa do të thotë dilema, siç është për shembull unë konsideroj te edhe i drejtohem ministrit te ajo pika ku ishte te angazhimi i prokurorëve në punë profesionale, kuptohet jashtë orarit të punës, që është pragu i pagesës te paga bazë deri në 25%, me këtë projektligj propozohet të hiqet pragu.

Në komision e kemi kaluar të hiqet pragu, por ne konsiderojmë që për të qenë në kontroll dhe me efikasitet puna e prokurorëve të Republikës së Kosovës, konsideroj se është të kanalizohet edhe një herë, ndoshta është më mirë të mbetet siç është në ligjin e vjetër pragu deri në 25%. Kur e them këtë e them se ne e kemi edhe ligjin e kemi edhe draftligjin në Kuvend, që është për konflikte të interesit, do të thotë edhe aty është e paraparë që do të thotë parandalimin e konfliktit të interesit në atë draft është e paraparë një prag dhe konsideroj se duhet të jetë pragu.

Megjithatë, ne presim edhe prej ministrisë ta shqyrtojë ose dhe do ta japim edhe kontributin tonë me amendamente ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Arben Gashi nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ne kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe kemi disa shqetësime lidhur me të.

Shqetësimi i parë dhe kryesor është lidhur me kompetencat e kryeprokurorit, angazhimi i tij në raste konkrete dhe po ashtu, kompetencat që kryeprokurori të caktojë lëndë dhe po ashtu caktimi i prokurorëve në Prokurorinë Speciale.

Këto janë elemente shqetësuese, por që mendoj se brenda dy leximeve ka mundësi komisioni në bashkëpunim edhe me propozuesin e ligjit t'i shqyrtojë dhe t'i përmirësojë. Realisht, në princip do të ishte shumë e arsyeshme për shkak të efikasitetit, që kryeprokurori i shtetit të ketë kompetenca edhe të merret me lëndë specifike, me raste specifike, të cilat mund të jenë të një rëndësie të veçantë, sidomos kur kemi të bëjmë me raste terrorizmi, të krimit të organizuar, luftës kundër korrupsionit, e tjerë..., të ngrihet niveli i trajtimit të këtyre çështjeve, por duhet të shihet një procedurë mbi bazën e të cilës kjo çështje duhet të procedohet.

Ekziston po ashtu, shqetësimi i bazuar se ky fuqizim i kryeprokurorit të shtetit mund të krijojë precedent për sjellje arbitrare të kryeprokurorit dhe kjo mund të bëhet rrezik për sistemin e drejtësisë, prandaj duhet të jemi të kujdesshëm në këtë fushë dhe sidomos, te pjesa e dytë kur është caktimi i prokurorëve në Prokurorinë Speciale dhe elementet tjera, duhet të jemi po ashtu të kujdesshëm.

Mendoj se brenda dy leximeve këto shqetësime do të trajtohen dhe tashmë në aspektin fillestar i plotëson kushtet formale-juridike dhe mund ta procedojmë për lexim të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Ahmet Isufi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Prokurorin e Shtetit me ndryshimet dhe plotësimet që duhet të bëhen dhe kontributin e vet do ta japë në procedurën e mëtutjeshme deri në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë! Bilall Sherifi nga "Nisma".

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Ligji për Prokurorin e Përgjithshëm, pra ndryshimet, unë jam po ashtu përpos në emër të “Nismës”, jam edhe anëtar i këtij komisioni dhe kemi pasur realisht, pothuajse sikur për asnjë ligj tjetër, debat brenda komisionit nga përfaqësues të partive politike, grupeve parlamentare, rreth disa dilemave, besa edhe ministri ka qenë një herë në një dëgjim, kur kemi biseduar gjerësisht, sepse është një ligj që realisht polarizon shumë.

Jo të gjithë mendojnë se këto ndryshime që parashihen përmes këtyre ndryshimeve të këtij ligji nuk ngjallin dilema. Dikush, për shembull unë, mendoj që fuqizimi i kryeprokurorit në përmasa siç parashihet tani me ndryshimet në këtë ligj, do të mund të dërgojnë neglizhencën e detyrës kryesore që ka kryeprokurori, që është menaxhimi i prokurorive, menaxhimi që ia përshkruan ligji. Mos këto ndryshime do të defokusonin institucionin e kryeprokurorit, që më shumë të merret me raste, siç parashihet tani që t’i jepet e drejta dhe të hetojë e të përfaqësojë raste në gjykata! Mos do të ndikonte që pësonte në rrafshin e administrimit dhe të menaxhimit të prokurorive në përgjithësi! Dilema se mos përmes këtij ligji do të fuqizohej dhe do të rritej arbitrariteti mund edhe të mbahen në kontroll përmes ndonjë amendamenti, përmes ndonjë neni të cilin do ta shtonim nga leximi i parë në të dytin, mirëpo për mua dhe për Nismën, dilema se do të mund të pësonte administrimi, menaxhimi i drejtë dhe efikas është më shumë në rrezik, se sa çështje tjera.

Në parim do ta përkrahim tani ligjin, me dëshirën, vullnetin dhe gatishmërinë që nga leximi i parë në leximin e dytë të shohim se si mund të gjitha këto dilema, së bashku me ministrin e me grupet tjera parlamentare, t’i zvogëlojmë sa më shumë që të jetë e mundur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bahrim Shabani, nga “6+”.

BAHRIM ŠABANI: Hvala, predsedavajući!

I Parlamentarna grupa “6+” razmatrala je Zakon o izmeni i dopuni ovog zakona o državnom tužiocu, s obzirom da znamo da ovaj nacrt-zakona ima za cilj osnaživanje Tužilačkog sistema u Republici Kosovo, kako bi bio spreman za borbu protiv kriminala i korupcije, Parlamentarna grupa “6+” će u načelu podržati ovaj zakon a svoj doprinos naravno, daćemo kroz rad u komisiji. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka më të lajmëruar për diskutim. Edhe kjo pikë e projektligjit mbetet për votim në momentin kur i kemi 61 deputetë.

Ju lutem, të nderuar kolegë, kryetarë të grupeve parlamentare, në qoftë se dëshironi mund ta lëmë, edhe pse herën e parë s’pranuat, në orën 18:00 votohen këto që po procedojmë, ose në 19:00, si të dëshironi.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Ftoj ministrin e Arsimit, zotin Shyqiri Bytyqi që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Sot para jush paraqes për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për Inspektoratin e arsimit në Republikën e Kosovës, me bazë të fushëveprimit dhe mandatit të saj Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me programin legjislativ për vitin 2017 ka paraparë miratimin e Projektligjit për Inspektoratit e arsimit në Republikën e Kosovës.

Për informimin tuaj, ky projektligj ka kaluar të gjitha procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi, sa u përket konsultimeve paraprake dhe publike. Objektivi kryesor i këtij projektligji do të jetë sigurimi i cilësisë së shërbimeve arsimore në arsimin parauniversitar dhe për të mbikëqyrur zbatimin e legjislacionit në të gjitha nivelet e arsimit. Fushëveprimi i këtij ligji është trajtimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit të aplikueshëm në institucionet arsimore publike dhe private në territorin e Republikës së Kosovës, të cilat i paraqesim si në vijim:

- Institucionin e arsimit parashkollor;
- Institucionin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët;
- Institucionin e arsimit të mesëm të lartë;
- Institucionin e arsimit të lartë;
- Institucionin e arsimit special;
- konviktet e studentëve dhe të nxënësve;
- Institucionin e arsimit të shtëpive korrektuese dhe burgjet;
- të gjitha institucionet tjera, që ofrojnë shërbime edukative, arsimore dhe aftësuese.

Në fund, dëshiroj të theksoj se është fjala për një projektligj të rëndësishëm, me të cilin do të arrihet të sigurohet cilësia e shërbimeve arsimore në arsimin parauniversitar, prandaj kërkoj nga ju që ta votoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Tani e hap debatin. Në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, zonja Teuta Haxhiu, fjala për ju.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Inovacion dhe Ndërmarrësi, në bazë të nenit 56, në mbledhjen e mbajtur më 6 shkurt i rekomandon Kuvendit të miratohet në parim Projektligji për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

Në bazë të këtij neni të paragrafit të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional shqyrtoi projektligjin në parim dhe pas shqyrtimit të parë, në mbledhjen plenare i paraqet Kuvendit dhe kërkon nga deputetët që ta votojnë në parim Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

Njëkohësisht, edhe në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i japim përkrahje në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani Valentina Bunjaku-Rexhepi, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë dhe ju deputete,

Projektligji për Inspektoratin e Arsimit në parim do ta përkrahim edhe ne si Lidhje Demokratike. Mirëpo e kemi shqyrtuar këtë projektligj edhe në Komisionin për Arsim dhe kemi dhënë propozimet dhe sugjerimet tona.

Ju e dini, e kemi parasysh se në Kosovë ka numër të vogël të inspektorëve dhe besoj që është paraparë edhe shtimi i numrit të inspektorëve në gjithë Republikën e Kosovës, sepse inspektorët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Ne në Komisionin për Arsim dhe tani këtu po propozoj që në këtë ligj të përfshihen edhe nxënësit dhe mësimdhënësit. Kur thuhet fjala që të përfshihen nxënësit nuk do me thanë që ata të jenë vendimmarrës, po të japin vlerësimin e tyre për mësimdhënësin në formë të pyetësorit, të parashihet një pyetësor me nxënës që të shpjegojnë performansën e profesorëve, arsimtarëve të tyre.

Realisht ne si Lidhje Demokratike e përkrahim këtë dhe propozojmë që edhe mësimdhënësit, njëri me tjetrin, të japin vlerësimin e tyre për kolegun e tyre, sepse kur një mësimdhënësi hospiton në shkollën tjetër mësimdhënësin tjetër, edhe merr përvoja nga kolegu i vet, edhe realisht inspektori nuk shikohet si polic, po shikohet sikur një inspektor profesionist që do ta mbikëqyrë mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Ne propozojmë që të parashihen edhe trajnime profesionale për inspektor, dhe fillimisht trajnimet të jenë në sektorë të ndryshëm për parashkollorë, për fillorë dhe për shkolla të larta e universitete. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Nezir Çoçaj, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, le të bëhet gati Albulena Balaj-Halimaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe si të tillë do ta mbështesë pa dyshim.

Në vazhdimësi deri në leximin e dytë ose gjatë leximit të dytë ne do të japim kontributin tonë në ato sugjerime që ne mendojmë se duhet të jenë.

E kemi diskutua po ashtu edhe në Komisionin Parlamentar për Arsim, aty i kemi paraqitur disa nga ato pak a shumë çështjet kryesore që duhen.

Dua ta them që ky projektligj është jashtëzakonisht i përgatitur mirë, por duke pasur parasysh rëndësinë që ka Inspektorati i Arsimit, ne e dimë që Inspektorati aktual i Arsimit ka qenë një drejtori i veçantë.

Me ligjin e vjetër të Inspektoratit të Arsimit ne kemi pasur faktikisht kemi pasur inspektorat të arsimit që janë marrë më shumë me çështje administrative, përkundër faktit se janë 24 inspektorë në këtë trupë që janë të përgatitur dhe të trajnuar.

Po, në anën tjetër, ne duke pasur parasysh edhe duke ditur detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit të Arsimit ne shpresojmë shumë që ky ligj sa më shpejt të hyjë në fuqi, në mënyrë që të kemi një numër jashtëzakonisht të madh të inspektorëve të arsimit, e kur e kemi parasysh faktin se në këtë projektligj parashihet edhe ndarja në dy organizma, inspektorë pedagogjikë dhe inspektorë administrativë.

Ne e dimë që sistemi arsimor i Kosovës ka nevojë për inspektorë të përgatitur, sidomos për inspektorë pedagogjikë, sepse kemi të bëjmë me vlerësimin e performansës së shkollave, e sidomos me vlerësimin e performansës së mësimitdhënësve.

Duke pasur parasysh që vlerësimi i performansës së mësimitdhënësve, të gjithë ata mësimitdhënës që do të kenë vlerësim pozitiv të performansës me automatizëm edhe do të bëhet sistemi i

licencimin të tyre, si dhe konsiderojmë që me automatizëm do të kemi ngritje të pagave meritore, jo siç kemi pasur deri më tash, rritje të pagave lineare të mësimdhënësve.

Me ministrin e kemi diskutuar po ashtu në Komision, edhe ne si Komision, ndoshta po edhe si grup parlamentar ta përkrahim idenë që Inspektorati të jetë agjenci e pavarur dhe Qeveria ta propozojë drejtorin e agjencisë, ndërsa ministri ta ketë zëvendësin e tij. Kjo praktikë është edhe me shtetet përreth dhe mendoj se ka treguar rezultat të madh.

Ne e dimë që shtetet e forta që kanë nivel të lartë të cilësisë në arsim, këtë çështje e ka ngritur edhe më lart, disa i përgjigjen drejtpërdrejt edhe presidentit të shtetit dhe kjo rezultuar të jetë më praktike dhe më pragmatike.

Unë shpresoj shumë që gjatë leximit të dytë edhe ne si grup parlamentar, gjegjësisht si pjesë e komisionit do të japim kontributin tonë. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Albulena Balaj-Halimaj, le të bëhet gati zonja Muferra Serbica-Shinik.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Duke e ditë rëndësinë e Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, ne në parim e mbështesim këtë projektligj dhe idetë tona ashtu siç i kemi dhënë në komision, do t'i japim edhe në leximin tonë të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Muferra Serbica-Shinik, edhe zoti Bekim Haxhiu.

MÜFERA SERBICA-ŞINIK: Faleminderit, kryetar!

Kosova Cumhuriyeti Eğitim Müfettişliği Yasa Tasarısının birinci okunuşunu 6+ Parlamenter Grubu olarak kabul ediyoruz. Ancak eğitim komisyonuna sunacağımız önerilerimiz olacaktır. Bu yasa tasarısında öğrencilerin öğretmenleri değerlendirmesi ya da öğrencilerin puanlaması yanlış olduğunu düşünüyoruz. Aynı zamanda müfettişlerin branşında uzman olmasıyla birlikte gideceği okullarda yapılan topluluk dillerini de iyi tanınması gerektiğini vurgulamaktayız. Ancak bu şekilde eğitimde kaliteye ulaşılabilir. Aksi halde müfettişliğin çalışması verimsiz olacaktır diye düşünüyoruz. "6+" Parlamenter grubu, komisyonda katkımızı sunacağız.

Teşekkür ederim!

KRYETARI: Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pasi që këtë projektligj e kemi shqyrtuar, është parapërgatitur në mandatin e kaluar dhe kam qenë pak i mishëruar me të, më duhet t'i them nja dy tri çështje sa i përket këtij projektligji.

Duke marrë për model sistemet arsimore dhe funksionimin e niveleve të tilla të inspektorateve në shtetet perëndimore, mendoj që qysh në start Ministria e Arsimit, bashkë me ne duhet të fokusohemi ose të përqendrohemi se cilin model të sistemit arsimor do të marrim themelimin e këtij inspektorati. Sepse e dimë që ne kemi një përzierje të sistemeve arsimore, nga ai parashkollor deri tek ai universitar, duke marrë një ligj nga sistemi arsimor i Finlandës, pastaj Gjermanisë, Austrisë dhe një kombinim të tillë të sistemeve arsimore që ka paraqitur vështirësi në funksionimin e tij dhe jep pastaj mundësi edhe në një politizim të skajshëm të sistemit arsimor.

Çka do të thotë që ne me këtë projektligj duhet të përcaktojmë kritere të sakta se kush mund të jetë inspektor arsimor, cila është përvoja e tij paraprake për t'u bërë pastaj inspektor arsimor dhe gjithsesi është menduar që me këtë projektligj të rregullohet edhe menaxhmenti apo përzgjedhja e menaxhmentit në shkollat fillore dhe të mesme. Me qëllim të ikjes së politizimit të skajshëm të drejtorive në këto shkolla.

Ne jemi dëshmitarë që pas çdo zgjedhjeve në nivelin lokal të gjithë kryetarët e komunave pastaj vazhdojnë me një ndryshim të të gjithë drejtorëve nëpër shkolla dhe ky politizim nuk arrin pastaj të ushtrojë funksionin e mirëfilltë të drejtorëve të shkollave dhe inspektorët e arsimit, të cilët në të gjitha sistemet arsimore inspektorët e arsimit janë ata vlerësues dhe monitorues të jashtë, ndërsa drejtorët e shkollave është vlerësimi i brendshëm, të cilin e bëjnë ata për kualitetet e mësimdhënies dhe performansës së mësimdhënësve.

Dhe kur një mësimdhënës merr performansë radhazi negative në vlerësimin e tij nga drejtori i arsimit, pastaj adresohet tek Inspektorati i Arsimit, të cilët pastaj bëjnë vlerësimin e performansës së atyre mësimdhënësve dhe kështu do të rregullohej sistemi i monitorimit të cilësisë dhe vlerësimet të mësimdhënësve dhe jo të ndodhë anasjelltas që nxënësit që ende s'kanë përfunduar vlerësimin fillor ta vlerësojë dikën i cili ka përvojë ndoshta 20-vjeçare në arsim dhe në inspektim.

Pra, mendoj këtu ne duhet të fokusohemi nëse dëshirojmë vërtet të kemi një arsim cilësor, të pavarur dhe të papolitizuar, atëherë këtë ta rregullojmë me një agjenci, e cila do ta rregullojë edhe fushën e inspektimit, po edhe menaxhimit të këtij niveli të arsimit, i cili është më se i nevojshëm që vërtet të kemi një arsim më të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe kjo pikë e rendit të ditës për votim mbetet pastaj, pasi nuk ka kuorum.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Bajram Hasani, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BAJRAM HASANI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që shkurtimisht ta paraqes qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit.

Arsyeja e parë për hartimin e Projektligjit për konsumatorë është adresimi i nevojës për përafrimin e ligjit ekzistues për mbrojtje të konsumatorit me legjislacionin e BE-së, me përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe planit të zbatimit të MSA-s.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është i vetmi organ kombëtar i pavarur për mbrojtjen e konsumatorit në Kosovë, përgjegjëse për plotësimin e nevojave të vendit për mbrojtjen e konsumatorit.

Ky projektligj është në harmoni me aktet ligjore të BE-së, në këtë fushë, respektivisht me kushtet e padrejta në kontrata, tregues të çmimeve mbi produktet e ofruara, shitja e mallrave të konsumit dhe garancive ndërlidhësve, tregtimi i shërbimeve financiare në distancë, praktikat e padrejtat tregtare, marrëveshjet e kredive për konsumatorë, ku ndarja e përdorimit të pushimit me afat, të produktit të pushimit afatgjatë, të rishitjes dhe shkëmbimit.

Gjyqësori ndaj konsumatorit të interesave të konsumatorit, mbrojtjes dhe interesat e konsumatorit, të drejtat e konsumatorit në relacion me kontratën.

Me harmonizimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit me direktiva të caktuara më lart, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit do t'i plotësojë të gjitha kërkesat dhe do të jetë në nivel të njëjtë me organizmat e tjerë të mbrojtjes së konsumatorit në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

Përpos kësaj, avancimi i infrastrukturës ligjore në këtë fushë ka ndikimin e vet praktik, reduktimin e barrierave teknike si në tregun e brendshëm, ashtu edhe atë të jashtëm.

Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit është në përputhje me politikat qeveritare karshi përmirësimit të përhershëm të kualitetit të jetës të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Këto politika parashihen në përputhje në plotë me kërkesa, nevojat dhe interesat vitale të konsumatorëve tanë, njëkohësisht, në pajtim me rrethana, specifikat dhe mundësitë tona institucionale dhe gjithëshoqërore.

Implementimi i politikave të reja përmes projektligjit të ri, ku afron një mbrojtje juridike, administrative dhe gjyqësore për konsumatorin.

Ky projektligj gjithashtu hap rrugë për implementimin e direktivave evropiane, të cilat rregullojnë fusha të ndryshme, duke marrë për bazë rregullat dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit është paraparë me programin kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, planin e punës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren numër 09/2011 për punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar deklarata financiare nga Ministria e Financës se nuk ka implikime buxhetore dhe opinioni i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit, ju propozoj që ta shqyrtoni dhe ta miratoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hap debatin. Zoti Memli Krasniqi, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në bazë të nenit 56, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt shqyrtoi në parim Projektligjin numër 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit.

Ky projektligj zbatohet për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet konsumatorëve, në njërën anë dhe prodhuesve, furnizuesve, shitësve apo afruesve të produkteve apo shërbimeve, në anën tjetër, për të mbrojtur konsumatorin nga praktikat e padrejta në tregun e Republikën së Kosovës.

Mbrojtja e konsumatorit është parim fundamental i të drejtave të konsumatorëve në të gjitha vendet e botës. Edhe në vendin tonë e drejta e konsumatorit njihet si e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe me ligjet e tjera në fuqi.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të arrihet avancimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit sipas standarde ndërkombëtare.

Pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit, ne vlerësojmë se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandojmë Kuvendit të miratohet në parim Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit.

Edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e konfirmojmë mbështetjen për kalimin në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të deklaruar për diskutim as në emër të grupeve, Bilall Sherifi, në fakt, nga “Nisma”.

BILALL SHERIFI: Në emër të grupit thashë të jap mbështetje, sikur të gjitha ligjeve.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe ky projektligj mbetet për t’u votuar.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produkte të ndërtimit

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Bajram Hasani, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BAJRAM HASANI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e projektit legjislativ që në pika të shkurtra të paraqes arsyen, qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për produktet e ndërtimit.

Arsye për hartimin e Projektligjit për produktet e ndërtimit janë rregullimi i kësaj fushe në bazë të kërkesave të tregut dhe harmonizimit sa më të përafërt me Rregulloren e Parlamentit Evropian numër 305/2011, e cila përcakton kushtet për vendosjen në dispozicion të tregut të produkteve të ndërtimit, duke vendosur rregullat e harmonizuara për kërkesat themelore dhe shënimin e produkteve të ndërtimit.

Kjo Rregullore e shfuqizon direktivën 89/106 EEC për produktet e ndërtimit CPD.

Ligji aktual numër 04/L-181 ka disa paqartësi dhe mangësi, të cilët në detaje janë përshkruar në koncept-dokument, ku si rezultat i tyre janë shfaqur pengesa në implementimin e tij.

Qëllimi kryesor për hartimin e Projektligjit për produkte të ndërtimit është krijimi i një baze të përshtatshme legjislative, mbi të cilën mund të bëhet i njohur sistemi për vlerësimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së performansës së produkteve të ndërtimit, duke mundësuar kësi soji zbatimin më të lehtë dhe respektimin e dispozitave ligjore të Kosovës për produkte të ndërtimit si dhe për mbushjen e obligimeve të tjera ligjore që do të paraqiten.

Arsyeshmëri tjetër e hartimit të këtij projektligji është kërkesa decidive, e cila rrjedh nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, neni 80, vlerësimi i konformitetit, në tetor të vitit 2015 nga Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian, kjo sjell përgjegjësi shtesë për Republikën e Kosovës në shumë fusha, ku njëra prej tyre është edhe fusha e produkteve të ndërtimit, e cila përbën një pjesë të madhe të tregut vendor.

Me asistencën e ekspertëve të BE-së, të kësaj fushe, domethënë të produkteve të ndërtimit, të cilët po vazhdojnë të mbështesin MTI-në është bërë vlerësimi i tërë pakos ligjore për produktet e ndërtimit në fuqi.

Nga ky vlerësim kanë dalë arsyetime dhe rekomandime se pakoja ligjore duhet të ndryshohet në tërësi, sepse si e tillë, është e pazbatueshme.

Gjithashtu me mbështetjen e fondeve të IPA-s projekti dhe lëvizjeve të lira të mallrave është hartuar Projektligji për produktet e ndërtimit si dhe janë dhënë rekomandime dhe asistencë të nevojshme për të proceduar më tutje.

Janë gjithsej shtatë kërkesa themelore: rezistenca mekanike dhe qëndrueshmëria, siguria në rast zjarri, higjiena, shëndeti dhe mjedisi, siguria në përdorim, mbrojtja nga zhurma, efienca e energjisë dhe ruajtja e nxehtësisë dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, kërkesa të cilat duhet t'i plotësojnë produktet e ndërtimit para se ato të vendosen në treg dhe punime ndërtimore.

Në këtë kontest, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka për detyrë të sigurojë qasje në tregun vendor për produkte të ndërtimit të importuar dhe produktet vendore të bëhen në mënyrë të duhur dhe përfundimisht kërkesa themelore teknike dhe pakoja ligjore për vlerësimin e verifikimit të qëndrueshëm të performansës janë të harmonizuara plotësisht me ato në vendet e rajonit dhe Bashkimit Evropian, përfshirë këtu edhe kërkesat teknike të standardeve të harmonizuara të BE-së, të cilët do të jenë pjesë përbërëse të projektligjit.

Po ashtu, me këtë ligj parashihet mbrojtja e produkteve ndërtimore, në rast se në tregun e Kosovës vërtetohet apo ankohen prodhuesit vendorë të produkteve ndërtimore se po importohen produkte ndërtimore nën koston e prodhimit vendor, duke mos shkelur apo keqpërdorur parimet e ekonomisë së tregut të lirë dhe MSA-s apo CEFTA-s.

Projektligji për produktet e ndërtimit ndërlidhet me objektivat e Qeverisë, respektivisht MTI-së dhe është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren numër 09/2011 për punën e Qeverisë së Kosovës.

Për fund, dua t'ju siguroj se Projektligji për produktet e ndërtimit është draftuar në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane dhe miratimi i këtij projektligji është i rëndësishëm për ngritjen dhe rregullimin e fushës së produkteve të ndërtimit dhe sistemin e mbikëqyrjes së tregut për këto produkte në Republikën e Kosovës.

Andaj, ju propozoj ta shqyrtoni dhe ta miratoni këtë projektligj në këtë seancë plenare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Me aq sa po shoh, në emër të Komisionit Funkcional, Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri e Zhvillim Rajonal, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt e shqyrtoi në parim Projektligjin numër 06/L-033 për produkte të ndërtimit.

Me këtë projektligj synohet arritje e një niveli më të lartë të produkteve të sigurta të ndërtimit në treg, nëpërmjet përcaktimit me ligj të kushteve për vendosjen apo vënien në dispozicion në treg të produkteve të ndërtimit, duke përcaktuar rregulla se si të deklarohet performansa, natyra dhe përshtatshmëria e produkteve ndërtimore në lidhje me karakteristikat e tyre themelore dhe përshtatshmërinë për përdorim në punimet e ndërtimit.

Ky projektligj zbatohet për të gjitha produktet e ndërtimit që vendosen në treg dhe të cilat i plotësojnë kërkesat themelore për përpunime e ndërtimit të përcaktuara me këtë projektligj.

Objektivat kyçe me anë të këtij projektligji janë përafrimi me legjislacionin e BE-së, krijimi i bazës ligjore të mirëfilltë për hartimin e deklaratës së performansës, shenjat CE dhe shenja e konformitetit të Kosovës, ku një produkt i ndërtimit mbulohet nga një standard i harmonizuar evropian apo është konform vlerësimeve teknike evropiane ose vlerësime teknike të Kosovës, të cilat janë lëshuar për atë produkt, ku prodhuesi duhet të hartojë deklaratën e performansës me rastin e vendosjes në treg të një produkti.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për produkte të ndërtimit, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit ta miratojë në parim Projektligjin numër 06/L-033 për produkte të ndërtimit.

Po ashtu edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, pas shqyrtimit, i jep mbështetje në parim këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj e ka kërkuar fjalën, askush tjetër.

TIME KADRIJAJ: Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës do ta përkrahë në parim, kontributin do ta japë në Komisionin Parlamentar.

KRYETARI: Faleminderit! Zotin Bilall Sherifi po e shoh nga “Nisma”, po urdhëro!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Edhe “Nisma për Kosovën” e mbështet dhe i jep përkrahje projektligjit në lexim të parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kjo pikë e rendit të ditës mbetet për votim po ashtu si të tjerat.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë

Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Arsimit, zotin Shyqiri Bytyqi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Sot para jush paraqes për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë në Republikën e Kosovës.

Në bazë të fushëveprimit dhe mandatit të saj, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në programin legjislativ për vitin 2017 ka paraparë miratimin e Projektligjit për inovacion dhe transfer të dijes dhe teknologjisë në Republikën e Kosovës.

Për informimin tuaj, ky projektligj ka kaluar të gjitha procedurat e parapara me legjislacionet në fuqi sa u përket konsultimeve të paraprahe me publikun.

Objektivi kryesor i këtij projektligji do të jetë i fushës së inovacionit, transferimit të dijes dhe teknologjisë në Republikën e Kosovës.

Sipas këtij projektligji bartës i inovacionit do të jenë Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë, institucionet kërkimore-shkencore, qendrat e inovacionit, kompanitë dhe ndërmarrjet, personat e tjerë fizikë dhe juridikë, vendorë dhe të huaj, institucionet e arsimit parauniversitar.

Institucionet e tjera publike ose private që merren me veprimtarinë e inovacionit janë: institucionet e zhvillimeve prodhuese, institucionet hulumtuese kërkimore, institucionet e inovacionit.

Institucionet mbështetëse për ofrimin e ndihmës infrastrukturore në fushën e inovacionit janë: inkubatorët afaristë teknologjikë, ... shkencore teknologjike, akselorët e inovacionit dhe të tjera.

Transferimin e teknologjisë së dijes mund të bëjnë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, universitetet, institutet kërkimore shkencore, kompanitë dhe ndërmarrjet, personat juridikë dhe fizikë që merren me transferimin e teknologjisë.

Dëshiroj të theksoj se ky projektligj nuk prek në kompetencat e asnjë institucioni tjetër të Republikës së Kosovës, sepse normohet vetëm pjesa e cila është me kompetencën e MASHT-it.

Për këtë mund të bindemi nga pjesëmarrja e grupeve punuese të projektligjit që në fazën e diskutimit paraprak e deri në finalizimin e projektligjit kanë marrë pjesë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Oda Ekonomike, Ministria e Integritimit Evropian si dhe shumë profesorë e ekspertë të tjerë të kësaj fushe.

Të gjitha komentet që kanë ardhur në lidhje me këtë projektligj i kemi në memorandumin shpjegues të projektligjit.

Krejt të fund dëshiroj të theksoj se është fjala për një projektligj me rëndësi për fushën e inovacionit, transferit të dijes dhe teknologjisë në Republikën e Kosovës, prandaj kërkoj nga ju që ta votoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Në emër të komisionit nuk ka të lajmëruar. Në emër të grupeve parlamentare, Teuta Haxhiu. Urdhëro, fjala për ju, prezanto pastaj qëndrimin.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Komisionit për Arsim, njëkohësisht edhe në emër të grupit parlamentar.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2018 shqyrtoi në parim Projektligjin për inovacion shkencor, transfer të dijes dhe teknologjisë dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim, pra të miratohet në parim Projektligji për inovacion shkencor, transfer të dijes dhe teknologjisë.

Komisioni vlerësoi se Projektligji numër 06/L-049 për inovacion shkencor, transfer të dijes dhe teknologjisë i plotëson kushtet e parapara në bazë të nenit 54 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Njëkohësisht edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës e përkrahim në parim këtë projektligj dhe normalisht gjithë kontributi do të jetë në grupet punuese dhe në Komisionin Funkcional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Abdyl Salihu, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

ABDYL SALIHU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne në grupin parlamentar e kemi debatuar dhe kemi shqyrtuar Projektligjin Nr. 06/L-049 për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë dhe si grup parlamentar e mbështesim në parim dhe do të japim kontributin tonë në komisionin përkatës, si dhe këtu në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe ky projektligj mbetet për votim në momentin kur kemi kuorum.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Bajram Hasani, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BAJRAM HASANI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e projektit legjislativ, që në pika të shkurtra të paraqes arsyen, qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për kërkesa teknike për produktet dhe vlerësim të konformitetit.

Arsye për hartimin e Projektligjit për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit janë: rregullimi i kësaj fushe në bazë të kërkesave të tregut dhe harmonizimi sa më i përafërt me Rregulloren 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 9 korrik 2008, që ka të bëjë me përcaktimin e kërkuar për akreditimin dhe mbikëqyrje të tregut për vendosjen e produkteve në treg dhe Vendimit 768/2008 EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 9 korrik 2008 për një kuadër të përbashkët për marketingun, tregtimin e produkteve. Ligji aktual Nr. 04/L-039 ka disa paqartësi dhe mangësi, të cilat në detaje janë përshkruar në koncept-dokument dhe si rezultat i tyre po shfaqen edhe pengesa në implementim.

Qëllimi kryesor për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit është krijimi i një baze të përshtatshme legjislative, mbi të cilët mund të vlerësohet dhe bëhet i njohur konformiteti dhe kërkesa teknike të produkteve industriale joushqimore, duke mundësuar kësisoj zbatimin më të lehtë dhe respektimin e dispozitave ligjore të Kosovës për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësimin të konformitetit, si dhe përmbushjen e obligimeve të tjera ligjore që do të paraqiten.

Arsyeshmëri tjetër i hartimit të Projektligjit për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësimin e konformitetit është kërkesë decidive e cila rrjedh nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, neni 80, Vlerësimi i konformitetit, në tetor të vitit 2015, nga Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian. Kjo sjell përgjegjësi shtesë për Republikën e Kosovës në shumë fusha, ku më e rëndësishmja ndërlidhet me kërkesat teknike për produktet industriale joushqimore, të cilat tregtohen. Siguria dhe mbrojtja e shëndetit, mjedisit, pronës, mbrojtja e konsumatorit dhe përdoruesit e tjerë në Republikën e Kosovës varen nga karakteristikat dhe kërkesat teknike, të cilat duhet t'i plotësojnë produktet para se ato të vendosen në treg dhe përdorim. Në këtë kontekst, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka për detyrë të sigurojë qasje në tregun vendor për produktet e importuara.

Projektligji për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësimin e konformitetit ndërlidhet me objektivat e Qeverisë, respektivisht Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që është në program për reformat ekonomike dhe është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren Nr. 09/2011 për punën e Qeverisë së Kosovës.

Për fund, dua t'ju siguroj që Projektligjit për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit është draftuar në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane dhe miratimi i këtij koncept-dokumenti është i rëndësishëm për avancimin e fushës së vlerësimin të konformitetit dhe sistemit të mbikëqyrjes së tregut të produkteve teknike

joushqimore në Republikën e Kosovës. Andaj, ju propozoj që ta shqyrtoni dhe ta aprovoni këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Tani hap debatin për shqyrtim në parim. Në emër të komisionit, Memli Krasniqi, urdhëroni, fjala për ju.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në mbledhjen e mbajtur më 21 shkurt 2018 e shqyrtoi në parim Projektligjin Nr. 06/L-041 për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit. Me këtë projektligj synohet arritje në nivelin më të lartë të sigurisë dhe cilësisë së produkteve joushqimore në treg dhe në përdorim, me qëllim të ruajtjes së shëndetit dhe jetës së përdoruesve të produkteve, nëpërmjet rregullimit me ligj të mënyrës së përcaktimit të kërkesave teknike për produkte, mënyrës së vlerësimit të konformitetit të produkteve me kërkesa teknike, përcaktimit të detyrimeve të operatorëve ekonomikë, si dhe nëpërmjet mbikëqyrjes inspektuese në zbatimin e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve teknike që kanë të bëjnë me përputhshmërinë dhe sigurinë e produkteve joushqimore.

Ky projektligj zbatohet për të gjitha produktet, me përjashtim të produkteve, të cilat janë të rregulluara me ligje të veçanta dhe rregullore teknike të miratuara në bazë të ligjeve të tilla. Komisioni pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformiteti vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara dhe i rekomandon Kuvendit të miratohet në parim ky projektligj, njëjtë edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep mbështetje miratimit të tij në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Time Kadrijaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar, do të thotë e përkrahim në parim dhe e votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe ky projektligj, pasi nuk ka të paraqitur për diskutim, kalon për votim në momentin kur të kemi kuorumin e deputetëve.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet postare

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj ministrin e Zhvillimit Ekonomik, i cili nuk është këtu, zoti Valdrin Lluka, të marrë fjalën. Vazhdojmë më tutje.

Kryetarja e Komisionit Funkcional nuk është, zoti Memli Krasniqi në emër të komisionit.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë...

KRYETARI: Kërkoj falje, pasi nuk qenka ministri, menduam të shkojmë edhe mekanikisht, të mos procedohet fare. Në qoftë se kolegët ministra, njëri prej tyre e paraqet...

(Ndërprerje e incizimit)

Urdhëro, ministër, në emër të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, ministri i Tregtisë dhe Industrisë.

MINISTRI BAJRAM HASANI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të ministrit të Zhvillimit Ekonomik ta paraqes projektligjin. Qëllimi i këtij projektligji është përmirësimi i ofrimit të shërbimeve postare nëpërmjet vendosjes së rregullave për sigurimin e ofrimit të shërbimeve postare dhe shërbimeve universale postare në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Nëpërmjet përcaktimit të kushteve për qasjen në rrjetet postare, nxitjes së konkurrencës së lirë, përcaktimit të parimeve për tarifën, sigurim të transparencës së llogarive të ofrimit të shërbimeve universale postare, përcaktimit të standardeve për shërbimin universal postar dhe vendosja e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me këto standarde. Ky ligj zbatohet nga të gjithë ofruesit e shërbimeve postare vendore, si dhe shërbimet ndërkombëtare. Nga kjo nuk është e rregulluar ndryshe me aktet e Unionit postar universal. Ofrimi dhe sigurimi i shërbimeve postare bëhet në tërë territorin e Republikës së Kosovës nga personat fizikë dhe juridikë, mbi bazën e parimeve të ligjshmërisë, mosdiskriminimit, objektivitetit dhe transparencës.

Ofrimi i shërbimeve postare duhet të garantojë fshehtësinë e korrespondencës dhe mbrojtjen e të dhënave personale, vazhdimësinë në ofrimin e shërbimeve universale postare, mbrojtjen e interesave të shfrytëzuesve dhe sigurimin e trajtimit të barabartë të tyre sipas legjislacionit në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Komisionit Funkcional, Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Faleminderit ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar edhe këtë projektligj në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt dhe ka vlerësuar se ky ligj

duhet të kalojë në miratim dhe i ka rekomanduar seancës që të votojë në favor. Njëjtë dhe Grupi i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet miratimin e këtij projektligji në leximin e parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërisë së Kosovës, zoti Bekë Berisha.

BEKË BERISHA: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar dhe e përkrah në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të paraqitur, përfaqësuesi i Qeverisë nuk ka kërkuar fjalën. Edhe kjo pikë e rendit të ditës kalon për votim në momentin kur kemi kuorum.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për metrologji

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Bajram Hasani, që para deputetëve të Kuvendit të na e prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BAJRAM HASANI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është bartëse e projektit legjislativ, më lejoni që ta paraqes në pika të shkurta arsyen, qëllimin, rëndësinë dhe fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për metrologji.

Arsyeja për hartimin e Projektligjit për metrologji është rregullimi i kësaj fushe në bazë të kërkesave të tregut dhe harmonizimit sa më të përafërt me direktivat e Parlamentit Evropian për fushën e metrologjisë, të cilët përcaktojnë kritere dhe kërkesa relevante teknike për vlerësimin e konformitetit për mjetet matëse, të cilët do të jenë të harmonizuar plotësisht me kriteret dhe kërkesat relevante teknike, të cilët përdoren në vendet e BE-së. Ligji aktual, Nr. 03/L-203 për metrologji ka disa paqartësi dhe mangësi, të cilat në detaje janë përshkruar, ku si rezultat i tyre janë shfaq pengesa në implementimin e tij. Qëllimi kryesor për hartimin e Projektligjit për metrologji është rregullimi i sistemit të njëjësive matëse, etalonët për matje, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e para të paketuara, autorizimet në fushën e metrologjisë, mbrojtjen e konsumatorëve dhe sigurisë së përgjithshme nga rezultatet e pasakta të matjeve.

Arsyeshmëri tjetër e hartimit të këtij projektligji është kërkesa decidive që rrjedh nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në tetor të vitit 2015 në mes të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës. Kjo sjell përgjegjësi shtesë për Republikën e Kosovës që nënkupton harmonizimin e legjislacionit të BE-së me atë të Kosovës, respektivisht implementimin e direktivave të BE-së nga fusha e metrologjisë, si rregullore teknike, të cilat do të aplikohen nga Agjencia e Metrologjisë në territorin e Republikës së Kosovës, për çka ligji aktual për metrologji ka mangësi të shumta, të cilat do të pengojnë në transpozimin dhe implementimin e direktivave në fjalë.

Projektligji për metrologji është i hartuar në mbështetje dhe asistencë të ekspertëve të BE-së të kësaj fushe, të cilët janë financuar përmes projektit IPA 2012 dhe të cilët kanë dhënë kontributin e tyre që ky projektligj të jetë sa më kompakt që është e mundur, duke ofruar mjaft detaje për të adresuar politikat e shtetit, ku involvohen matjet. Është hartuar në përputhshmëri me edicionet e fundit të dokumenteve të aplikueshme ndërkombëtare për fushën e metrologjisë, dokumenti D1 i versionit 2012 i Organizatës Botërore për Metrologji ligjore dhe po ashtu do të jetë në përputhje me zhvillimin e politikave shtetërore me qëllim që të jetë në gjendje të mbështetë një infrastrukturë efektive të sistemit të metrologjisë në Kosovë. Projektligji për metrologji ndërlidhet me objektivat e Qeverisë, respektivisht MTI-së dhe është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren nr. 09/2011 për punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Andaj, ju propozoj që të miratohet ky projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit FunkSIONAL, fjala për ju.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Kabinet qeveritar,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 21 shkurt 2018 shqyrtoi në parim Projektligjin për metrologji dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim: i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

A mund të flas edhe në emër të grupit, kryetar?

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për metrologji. Metrologjia është shkenca mbi matjet. Me këtë ligj rregullohet sistemi i njëjësive matëse, etalonët për matjet, procedurat e vlerësimit, konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike dhe produktet e parapaketuara, autorizimi në fushën e metrologjisë, mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurisë së përgjithshme nga rezultatet e pasakta të matjeve. Bazuar edhe në ekspozenë që e bëri ministri, nuk do të dëshiroja të marr shumë kohë, ne si grup parlamentar e mbështesim në parim dhe kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës do ta përkrahë në parim, do ta votojmë dhe kontributin do ta japim në komisionin parlamentar.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe kjo pikë e rendit të ditës mbetet për votim në momentin kur të arrijmë numrin e duhur të deputetëve për kuorum, për të votuar.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Bajram Hasani, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BAJRAM HASANI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht ta paraqes qëllimin dhe rëndësinë e Projektligjit për masat mbrojtëse në importe.

Ligji për masat mbrojtëse në importe përcakton parimet dhe procedurat përkitazi me zbatimin e masave mbrojtëse në rast kur një produkt importohet në Kosovë në sasi më të madhe që shkakton dëmtim apo kërcënim për shkaktim të dëmit në tregun e brendshëm të Kosovës dhe ndaj prodhuesve vendorë të mallrave të njëjta apo të ngjashëm. Gjatë implementimit të ligjit aktual janë paraqitur vështirësi në procedurat e vendimmarrjes, përbërja e mekanizmit vendimmarrës, afatet kohore të marrjes së masave dhe shumë të tjera. Ligji për masa mbrojtëse në importe duhet të jetë në pajtim të plotë me marrëveshjet dhe direktivat e OBT-së, përkatësisht BE-së dhe dispozitave të CEFT-ës, prandaj synimi i Projektligjit të ri për masat mbrojtëse në importe është që të përafrohen legjislacioni kosovar në fushën e mbrojtjes së tregut me atë të OBT-së dhe të BE-së, respektivisht Rregulloren 2015/478 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 mars 2015 dhe Rregulloren 2016/1036 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 8 qershor 2016 mbi mbrojtjen nga importet e dampuara nga vendet joanëtare të BE-së, i cili do të ndihmonte në mbrojtjen e prodhuesve vendorë nga importet e pakontrolluara.

Një zhvillim ekonomik më të lartë, rritje të konkurrueshmërisë dhe vendeve të reja të punës. Një pjesë kryesore e këtij përafrimi ka të bëjë me afatet dhe procedurat e hetimeve dhe mungesën e komisionit për vlerësimin e masave mbrojtëse në importe. Projektligji ka harmonizuar kërkesat e rregulloreve të Bashkimit Evropian dhe të Organizatës Botërore të Tregtisë. Pjesë e këtij

përafrimi ka qenë edhe krijimi i obligimit për themelimin dhe përbërjen e komisionit ndërinstitucional për vlerësimin e masave mbrojtëse në importe, megjithëse pjesa më e madhe e dispozitave të harmonizuara me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe OBT-së ndërlidhet me afatet dhe procedurat e hetimeve. Janë harmonizuar dhe pjesa tjetër e ligjit që ndërlidhet me konsultimet me palët e përfshira në hetim të një rasti.

Projektligji për masat mbrojtëse në importe përmban dispozita, të cilat rregullojnë afatet dhe procedurat e hetimeve, themelimin dhe përbërjen e komisionit dhe procesin e konsultimeve. Me anë të ndryshimeve të propozuara është paraparë hartimi i Rregullores së punës së komisionit dhe hartimi i pyetësorit për prodhuesit, eksportuesit dhe importuesit. Ky projektligj është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren Nr. 09/2011 për punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe është pranuar deklarata financiare dhe opinioni ligjor. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji në fushën e ekonomisë, ku Projektligji për masa mbrojtëse në importe do t'u shërbejë autoriteteve të Kosovës drejt arritjes së objektivave të modernizimit të ekonomisë së vendit dhe krijimit të vendeve të reja të punës, ju propozoj që ta shqyrtoni dhe ta miratoni këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Në emër të Komisionit FunkSIONAL, zonja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për masat mbrojtëse në importe e vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit të miratohet në parim Projektligji për masat mbrojtëse në importe.

Tani, kryetar, po flas në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për masat mbrojtëse në importe. Ky ligj rregullon parimet dhe procedurat për marrjen e masave mbrojtëse në rastet kur një produkt importohet në Republikën e Kosovës në sasi të rritur sa që shkakton dëm apo kërcënim për dëm serioz të prodhuesve vendorë që prodhojnë mallra të ngjashme ose identike dhe që janë drejtpërdrejt konkurrese. Ky ligj zbatohet për aplikimin e masave mbrojtëse në import dhe mbrojtjen e prodhuesve vendorë në rastet kur ata dëmtohen apo kërcënohen për dëmtim serioz nga importi i mallrave, të cilat ndikojnë në çrregullimin e tregut. Ne e mbështesim në parim si grup parlamentar dhe kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Mimoza Kusari-Lila e ka kërkuar fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket Ligjit për masat mbrojtëse, më duhet të them se ne prej fillimit të punës së Komisionit për Zhvillim Ekonomik kemi pasur kërkesë për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë që të vijë pakoja e përbashkët e ligjeve për masat mbrojtëse, Ligjit për tregti të brendshme dhe Ligjin për masat antidamping.

Një gjë e tillë jo që nuk është bërë, gjegjësisht nuk është përfshirë në agjendë legislative, por në kuadër të ligjit ose draft-ligjit që është sjellë para nesh mbrojtja e produkteve vendore gati se është mision i pamundur. Këtë vetëm afatet të cilat janë përcaktuar në draft-ligj për trajtimin e ankesave, për kthimin e përgjigjeve neni 8, pika 8 pas konsultimeve me komisionin duhet t'i dorëzohet përgjigja brenda 30 ditëve palëve ankuese. Neni 11: "Hetimet mund të parashihen brenda afatit 90 ditor". Neni 12: "Mbledhja e informatave në kuadër të Ministrisë zgjat 30 ditë", e kështu me radhë deri te kur ministria duhet të kthejë përgjigje në afat prej 180 ditëve.

Tani të gjithëve ju thërras vetëm të mendoni se nëse kemi një problem ose një vërshim të tregut të Kosovës në një produkt sezonal, themi në periudhën e verës, deri në momentin kur afatin ligjor e ka ministria për kthim të përgjigjes 180 ditë, i bie 6 muaj. Ne sinqerisht mund ta mbysim një industri komplet ose një sektor bujqësor, përderisa Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të marrë iniciativën për të aplikuar masat mbrojtëse. Gjithashtu, në kuadër të afatit dhe zbatimit të serishëm parashihet që zbatimi i këtyre masave mund të bëhet në industri të caktuar në kuadër të një viti ose pas një viti kalendarik. Mendoj se nëse e kemi seriozisht si institucione të Republikës së Kosovës, si Parlament dhe si ekzekutiv mbrojtjen dhe ofrimin e një mbështetjeje të mirëfilltë produkteve vendore, duhet trajtuar këtë me seriozitet të plotë dhe ky seriozitet do të nisej së pari prej ndryshimit të agjendës legislative të ekzekutivit, me iniciativë të ministrit të Tregtisë dhe Industrisë që të bëhej pakoja e përbashkët e Ligjit për masat mbrojtëse, Ligjit për tregti të brendshme dhe Ligjit për masat antidamping dhe, tjetra që në kuadër të afateve të përcaktuara për Ligjin për masat mbrojtëse të kemi shkurtime të afateve dhe reagime më të shpejta.

Reagimet, të cilat i kemi pas deri më tani janë në mbrojtje vetëm të disa ose shumë pak, në numër njëshifror të kompanive, të cilat në masë mund të jenë lobuese ose shtytëse për masat mbrojtëse përderisa ende sot nuk e kemi në ekuilibër të mirëfilltë të mbrojtjes së produkteve vendore, duke e ditur se prej vitit 2006 disbalanci tregtar prej nënshkrimit të marrëveshjes CEFTA në Kosovë vazhdon. Ne do të vazhdojmë kontributin në kuadër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, në kuadër të shqyrtimit të afateve, të cilat janë të parapara në kuadër të ligjit, përderisa unë e mirëkuptoj ministrin kur thotë se është bërë në përputhshmëri me kërkesat e BE-së dhe të Organizatës Botërore të Tregtisë, por mendoj se parimi kryesor për Ligjin për masat mbrojtëse duhet të jenë në mënyrën e mirëfilltë mbrojtja ose krijimi i sistemit mbrojtës për industrinë kosovare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministri do ta plotësojë zonjën deputete rreth kësaj çështje, e kemi edhe leximin e dytë.

MINISTRI BAJRAM HASANI: Faleminderit, deputete!

Po, ka qenë kërkesë për t'i sjellë në pako ligjet, sa i përket Ligjit antidamping realisht nuk kemi çka të sjellim ndryshime. Ne mendojmë se ai ligj përveç disa afateve ndoshta amendamenteve të vogla, sa i përket Ligjit për tregti të brendshme jemi duke punuar, por ju e dini që nuk mund të bëhet ligji brenda javës ose muajve, ai merr kohë. Ne po mundohemi që Ligjin për tregti të brendshme ta sjellim gjatë këtij viti, por me qëllim që Ligji për produktet e importit, ne kemi dëshmuar edhe me këto ligje që i keni lënë ju, të gjithë ish-ministrat, ne jemi duke i përdorur dhe duke i mbrojtur prodhuesit.

Dhe, qëllimi ynë është edhe hartimi sa më i shpejtë i këtij ligji që sa më shumë t'i mbrojmë prodhuesit vendorë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë edhe zoti Bekë Berisha nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka fjalën.

BEKË BERISHA: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar me shumë kujdes këtë ligj dhe e përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi nga "Nisma" e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm desha të nënvizoj se në Komisioni për Zhvillim Ekonomik ka pasur një gatishmëri që, së bashku pozitivë e opozitivë, të bashkëpunojnë në drejtim të krijimit të një pakoje të përbashkët të ligjeve, të cilat ndihmojnë prodhuesit vendorë, i mbrojnë dhe i ndihmojnë ata. Rrugën që e ka zgjedhur Qeveria, përkatësisht ministria nuk është se del shumë larg kësaj, por do të ishte më mirë sikur të ishte vepruar në mënyrën siç ka sugjeruar komisioni.

Megjithatë, i sugjeroj ministrit dhe Ministrisë së tij, i sugjeroj edhe Qeverisë që në muajt në vijim të kenë parasysh vërejtjet, të cilat i ka dhënë edhe komisioni, vërejtjet dhe këshillat të cilat i kanë dhënë deputetët, sepse në fund të fundit, të gjitha këto nuk kanë qenë as kushte, nuk kanë qenë as kërkesa, por kanë qenë një ofertë që ka bërë komisioni në drejtim të Qeverisë, përkatësisht në drejtim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Pra, le të shihet kjo oferta për ndihmë ministrisë dhe Qeverisë, për të ndihmuar në drejtim të harmonizimit dhe të ndërtimit të një pakoje ligjore që ndihmon kompanitë dhe produktet vendore dhe le të veprohet, edhe nëse vijnë ligjet veç e veç, së paku esencën, përmbajtjen e të gjithë asaj, të cilën kemi biseduar në

komisione, ta përmbajnë ligjet në fjalë, edhe nëse nuk kanë ardhur si paketë, kur të vijnë veç e veç. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, edhe ky projektligj mbetet për votim në momentin kur pozita i bën 61 veta.

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut

Komisioni Funkcional për Shëndetësi e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin Abelard Tahiri që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Të nderuar deputetë,

Para jush keni Projektligjin për gjakun dhe përbërësit e gjakut. Me këtë projektligj rregullohet furnizimi i qytetarëve me gjak dhe përbërësit e gjakut. Pra, garantohet e drejta e barabartë e qytetarëve të Republikës së Kosovës për trajtim transfuzionologjik, vetëmjaftueshmëria me gjak dhe përbërësit e gjakut, veprimtaria transfuzive si fushë me interes të veçantë nacional, kushtet dhe standardet e cilësisë së sigurisë me qëllim të mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve, mënyra e mbikëqyrjes së institucioneve që ushtrojnë aktivitetet dhe veprimtarinë transfuzive, nxitja e përdorimit racional të gjakut dhe përbërësve të gjakut përmes praktikës së mirë klinike dhe nxitjes së zhvillimit të mjekësisë transfuzive.

Pra, të nderuar deputetë, ky projektligj rregullon, po ashtu, dhurimin, grumbullimin, testimin, përpunimin, kontrollin e cilësisë, ruajtjen dhe menaxhimin e shpërndarjes dhe lëshimin e gjakut, si dhe të përbërësve të tij. Dhe, e gjithë kjo që përmenda ka të bëjë me përmbushjen e detyrave tona në procesin e integriteteve, pra edhe kjo po u lidhka me integrimin. Të nderuar të pranishëm, në emër të ministrit të Shëndetësisë, ju ftoj ta përkrahni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A do të flasë dikush në emër të komisionit? Nuk ka! Atëherë, Bekim Haxhiu, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës dhe Time Kadrijaj bëhet gati në emër të Aleancës.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Faleminderit për prezantimin në emër të ministrit të Shëndetësisë, bazuar në Ligjin e shëndetësisë, neni 30 grumbullimi, kontrolli, ruajtja, shpërndarja dhe transfuzioni i gjakut dhe produkteve të gjakut rregullohet me ligj të veçantë, andaj edhe Ministria e Shëndetësisë e ka paraparë që këtë fushë ta rregullojë me ligj të veçantë, dhe Grupi Parlamentar i Partisë

Demokratike jep mbështetjen në parim të këtij projektligji, duke shpresuar që bashkarish në komision të gjitha subjektet politike të japin kontributin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Time Kadrijaj, në emër të Aleancës.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ashtu qysh edhe u prezantua, ky ligj rregullon furnizimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës me gjak dhe përbërës të gjakut. Është një projektligj i rëndësisë së veçantë dhe kjo fushë ndërlidhet edhe me programin kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, neni 106, kompletimi i kornizës ligjore parasheh miratimin e Projektligjit për transfuzionin e gjakut, lidhet po ashtu me strategjinë kombëtare për integrimet evropiane, me programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Raporti i Progresit 2014 për Kosovë ka konstatuar se në lidhje me indet dhe qelizat është miratuar Ligji për transplantimin e indeve dhe qelizave, mirëpo jo edhe për produktet e gjakut.

Andaj, grupi parlamentar, duke parë se është një projektligj i rëndësisë së veçantë, e ka shqyrtuar, e përkrah në parim dhe do të japim kontributin tonë në komisionet parlamentare.

KRYETARI: Zoti Fikrim Damka, në emër të “6+”.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Değerli milletvekiller kan ve kan maddeleri kanunu “6+” Parlamenter grubu tarafından incelendiğini ve bu kanun ile birlikte Kosovadan kan bağıışı, kanların toplanması, kan dağıtımı, kanların kaliteli bir şekilde korunması açık bir şekilde düzenlenmektedir. Aynı zamanda yeniden transfuzion merkezlerinin hem merkezi düzeyde hem de bölgelerde yeniden düzenlenmesi bu kanun ile öngörülmektedir. “6+” Parlamenter grubu kendi önerilerini komisyonlara sunarak bu kanunun en iyi bir şekilde düzenlenmesini sağlanmasını ve destekleyeceğini ilan etmektedir.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe ky projektligj mbetet të votohet në momentin kur e kemi numrin e nevojshëm të deputetëve në sallë për votim.

25. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të paraqes para jush për miratim vendimin për emërimin e anëtarëve të rinj të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, ashtu siç e parasheh neni 4 i Ligjit 04/L-141 për provimin e jurisprudencës.

Siç e dini, provimi i jurisprudencës është parakusht kryesor për ushtrimin e profesionit të gjyqtarit, prokurorit apo avokatit, dhe hap i parë drejt ndërtimit të karrierës profesionale të një juristi.

Si ministër i Drejtësisë jam i përkushtuar në ngritjen e cilësisë në organizimin e provimit të jurisprudencës dhe rrjedhimisht kam përcjellë nëpërmjet Qeverisë propozimin për formim të komisionit, i cili kësaj radhe në përbërjen e tij ka figura eminente të sistemit të Drejtësisë në Republikën e Kosovës. Për anëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës propozoj këtë përbërje:

1. Aleksandër Lumezi, kryetar i komisionit, pyetës i lëndës E Drejta Penale; kurse për zëvendësanëtar të komisionit - Besim Kelmendi;
2. Haxhi Gashi, anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E Drejta Civile; kurse për zëvendës Albert Zogaj;
3. Nebojsa Boriçiq, anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E Drejta Tregtare, kurse për zëvendës Gazmend Nushi;
4. Zonja Afërdita Bytyqi, anëtare e komisionit, pyetëse e lëndës E Drejta Kushtetuese, Organizimi i Sistemit Gjyqësor të Kosovës, Bazat e Sistemit të Bashkimit Evropian dhe të Drejtat e Njeriut, kurse për zëvendës Qerim Fazlijaj; dhe
5. Enver Peci, anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E Drejta e Punës dhe E Drejta Administrative, kurse për zëvendës zonja Emine Kaçiku.

Unë besoj fuqishëm që pa humbur kohë do të mund ta organizojmë provimin e jurisprudencës për të gjithë ata që duan të kontribuojnë në transformimin e mëtejshëm të sistemit të Drejtësisë për ta mbështetur edhe drejtpërdrejtë konsolidimin e shtetit të së drejtës. Prandaj, për këtë qëllim, ju ftoj që ta mbështetni me votën tuaj përbërjen e këtij komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Në emër të komisionit nuk ka të paraqitur. Nga grupet parlamentare nuk ka të paraqitur.

Edhe kjo pikë e rendit të ditës mbetet për votim në momentin kur të kemi kuorumin.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare

Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj ministrin e Administratës Publike, në fakt në emër të ministrit, zëvendëskryeministrin zotin Enver Hoxhaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Para jush e keni një projektligj, i cili pas një debati shumë të gjatë me shoqata dhe asociacione të ndryshme në Kosovë, që janë pjesë e shoqërisë civile, synon ta rregullojë në një stad më të mirë dhe më të avancuar, edhe regjistrimin, edhe funksionimin, edhe pezullimin, edhe shuarjen, por edhe ndalimin e veprimit të organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Meqë nocioni “shoqëri civile” nuk është shumë i qartë dhe nganjëherë ka keqkuptime të caktuara politike, më lejoni të them që ky ligj nuk zbatohet për parti politike, nuk zbatohet për bashkësi fetare dhe nuk zbatohet për sindikata dhe organizime të tjera, të cilat janë të ngjashme me organizatat joqeveritare, por të cilat nuk janë të njëjta.

Pas një debati të gjatë, që ministri Jagxhillar ka bërë me shumë shoqata dhe asociacione në nivel vendi dhe pas një trajtimi të gjatë që kemi pasur në Qeveri të Kosovës, më lejoni që të ju ftoj juve dhe ta votoni këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Tani e hap debatin në parim.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, zotin Nait Hasani, ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat!

Komisioni për Administratë Publike më 20. 2. 2018 e ka shqyrtuar Projektligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare dhe është një nga projektligjet mjaft të rëndësishme që bën funksionalizimin e këtyre organizatave.

Në Kosovë ekziston një numër i madh i organizatave joqeveritare, diku rreth 9 mijë sosh, veprimtaria e të cilave është e ndryshme dhe me anë të këtij projektligji kërkohet që ato të rregullohen dhe të paktën të kenë edhe një llogaridhënie. Kjo do të thotë, që të paktën të jenë të menaxhueshme edhe nga ministria, edhe nga Kuvendi.

Prandaj, besoj që me këtë projektligj do të rregullohet edhe çështja e tyre. Kërkojmë që në parim t'i mbështetim dhe plotësim-ndryshimet mund t'i bëjmë më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Veç në emër personal, jo qëndrimin e grupit.

KRYETARI: Atëherë, më vonë. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Xhevahire Izmaçu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar me vëmendje dhe shumë seriozitet Projektligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.

Më lejoni që ta përshëndes punën e mirë të Qeverisë në këtë drejtim, pra e ka sponsorizuar një ligj, i cili për herë të parë trajtohet në mënyrë shumë serioze. Ne e dimë që nga paslufta se kemi shumë, me qindra organizata joqeveritare që veprojnë në vendin tonë dhe shpeshherë ndoshta për mungesë të qartësisë së ligjshmërisë në njëfarë forme shpeshherë na ka degraduar qëllimi shumë i mirë që duhet ta ketë një organizatë joqeveritare.

Në këtë ligj është shumë mirë e theksuar edhe mënyra se si duhet të funksionojnë, të regjistrohen, të shuhën, të veprojnë dhe si t'i respektojnë edhe ligjet tjera në fuqi, për të cilat duhet të ketë një funksionalitet, apo një balancim në raport me funksionimin e organizatave joqeveritare. Në këtë drejtim, është shumë mirë e theksuar në ligj edhe mënyra se si duhet të konceptohet aftësia për të qenë jo përfituese, mirëpo përfitimi të jetë në aspektin publik. Në këtë drejtim, ne si grup parlamentar do t'i shfrytëzojmë krejt mundësitë tona në çdo komision funksional që ta japim kontributin dhe që të kemi më në fund një ligj kualitativ, ashtu siç e ka sponsorizuar Qeveria. Pra, i falënderoj kolegët për kontributin që kanë dhënë edhe në mbledhje.

KRYETARI: Faleminderit! Rasim Selmanaj, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

RASIM SELMANAJ: Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah në parim këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim ndërmjet dy leximeve.

KRYETARI: Igor Simiq, nga Lista serbe.

IGOR SIMIĆ: Poštovane kolege,

Srpska lista je razmatrala ovaj nacrt zakona, i ono što možemo da kažemo u ovom trenutku jeste da je rad nevladinih organizacija od ogromnog značaja za unapređenje ovog društva, i zahteva našu podršku kroz donošenje ovog zakona.

Stav Srpske liste je da podrži u načelu ovaj predlog zakona, ali ćemo svoj doprinos dati radom kroz skupštinske odbore. Ono što moramo da naglasimo kod ovog zakona jeste da ovakav predlog zakona na žalost ne ispunjava minimum poštovanja pravopisa srpskog jezika, i zahteva ogroman broj jezičkih ispravki, kako bih zakon bio jasan, funkcionalan i upotrebljiv u praksi, kako od strane nevladinih organizacija, tako od strane institucija. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka, në emër të “Nismës”.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Ne si “Nismë” mendojmë se njëri prej ligjeve më të rëndësishme që i ka ardhur Parlamentit të Kosovës është Ligji për OJQ-të.

Në Kosovë momentalisht janë mbi 9 mijë organizata joqeveritare, të cilat në ranglistë, pas qeverive të pasluftës, e zënë vendin e dytë në korrupsion. OJQ-të, 90% e tyre kanë funksionuar si ombrella për shpëlarje të parave, për futje në treg të ideve të ndryshme, rrymave të ndryshme politike e fetare, kështu që mendojmë se me këtë ligj do të vihen në autostradë këto OJQ dhe do të dihet se kush ka përfituar e kush nuk ka përfituar.

Prandaj, duke e mbështetur edhe atë pjesën për integritet evropiane, që është te Ligji i shëndetësisë, që tha ministri i Drejtësisë, edhe ne e mbështetim edhe për hir të integriteteve evropiane këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Rasim, në emër të AAK-së, fole? Korab Sejdiu e ka fjalën. Bëhet gati Islam Pacolli.

KORAB SEJDIU: Të nderuar qytetarë,

Kolegë të nderuar,

Kryetar,

Është koha që më në fund të adresohet, ose të ndryshohet, ose të bëhet një ligj i ri që adreson lirinë e asociimit në organizata joqeveritare. Ligji aktual, edhe pse ka ofruar elementet bazike të operimit të OJQ-ve në Kosovës, besoj se të gjithë pajtohemi që ka qenë i pamjaftueshëm dhe ta them të drejtën ekziston një vështirësi e operimit të OJQ-ve në Kosovë. Përvoja ime është më

shumë nga këndvështrimi i mbështetjes së tyre në kontekst juridik dhe besoj që OJQ-të e dinë shumë mirë se çka heqin për të operuar në Kosovë.

Kjo është një mundësi e rrallë për ne që të kontribuojmë nëpërmjet këtij ligji për të mundësuar operimin e tyre, sa i përket për shembull eliminimit të burokracisë në ndryshimin e të dhënave, informatave, në shpenzimet e panevojshme që u krijohen një mori OJQ-ve, veçanërisht atyre që janë të huaja dhe operojnë në Kosovë, ose janë ndërkombëtare, të cilat detyrohen që çdo dokument ta dorëzojnë në njërën nga gjuhët zyrtare, unë kisha thënë dhe kisha propozuar që të shtohet edhe gjuha angleze si gjuhë e pranueshme, ashtu siç e ka bërë edhe Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve dhe e ka krijuar një precedent shumë të mirë dhe një lehtësi shumë të madhe për bizneset. Besoj se e njëjta mund të përkthehet edhe në organizatat joqeveritare që operojnë në Kosovë.

Dhe, një çështje tjetër që ndërlidhet me mbikëqyrje është qartësimi i mbikëqyrjes së OJQ-ve, veçanërisht sa i përket ndarjes së OJQ-ve nga organet shtetërore, sepse ka disa OJQ ku në bordet e tyre, për shembull, sipas detyrës zyrtare shërbejnë kryetarë të komunave, ose zyrtarë të ndryshëm. Edhe vetë fjala organizatë joqeveritare nënkupton që as qeverisja lokale, as qendrore nuk duhet marrë pjesë në vendimmarrjen e tyre. Kështu që ka shumë mundësi të kontribuohet për t'u ndihmuar organizatave joqeveritare që të operojnë sa më lehtë në Kosovë, veçanërisht duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë që kanë për t'u siguruar që shoqëria jonë vepron në mënyrën më të mirë të mundur, qoftë në aspekt të demokracisë, drejtësisë, ekonomisë, e kështu me radhë. Faleminderit!

KRYETARI: Islam Pacolli, fjala për ju!

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryetar!

Ju përshëndes edhe një herë të gjithëve!

Mendoj që tani veç po vjen radha që edhe ne t'i plotësojmë këto standarde, të cilat u përkasin standardeve evropiane dhe sigurisht se në këtë ligj sqarohet apo trajtohet mirë që secili ka një emër dhe një mbiemër. Do të thotë, edhe OJQ-të do të filtrohen më mirë, do të dihet edhe lehtësimi i punës së tyre, por edhe prapavija do të shkëputet. Sigurisht se është më mirë edhe për aspektin e sigurisë për vendin tonë, por është edhe mirë se lehtësimi i funksionimit të OJQ-ve rregullohet me ligj. Ne e përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe ky projektligj mbetet për votim në momentin kur kolegët deputetët arrijnë në numrin 61.

Ministri e ka fjalën, ju lutem, për çështjen e projektligjit të mëparshëm.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: I nderuar kryetar,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Kërkoj falje për vonesën, por është një ngarkesë në komunikacion, kështu që edhe një herë e falënderoj zëvendëskryeministrin për prezantimin.

Sa u përket çështjeve të ngritura me ndryshime, faktikisht me propozimin e ligjit të ri, një prej çështjeve kryesore ka qenë shuarja ose pezullimi i punës së OJQ-ve dhe në këtë aspekt ndalimi i veprimtarisë së OJQ-vë, i cili do të bëhet më tutje sipas propozimit të ligjit, sipas vendimit të gjykatës kompetente, të cilat mund të ndalohen nga aspekti i veprimtarisë për aktivitetet të cilat e cenojnë rendin kushtetues, shkelin liritë dhe të drejtat e njeriut, ose nxitin urrejtje racore, kombëtare, etnike a fetare.

Janë paraparë edhe procedurat e nevojshme për procedim deri te çregjistrimi. Pezullimi deri tash ka qenë kompetencë e Departamentit të OJQ-ve, sipas Udhëzimit Administrativ për regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve, por kemi pasur vërejtje nga Raporti i Progresit lidhur me këtë, andaj është adresuar më tutje që të bëhet nëpërmjet gjykatave.

Sa i përket gjuhës, unë mund të garantoj që si ministër i Administratës Publike kemi angazhuar edhe ekspertë për gjuhën serbe, që përkthimi të jetë sa më i mirë. Ndërsa sa i përket qartësisë të mbikëqyrjes ka qenë një dilemë gjithmonë derisa mund të shkohet mbikëqyrja e OJQ-ve, prapë ka mbetur një parim që çdo fushë të mbikëqyret nga institucionet kompetente. Në qoftë se janë çështje sigurie, atëherë institucionet e sigurisë, në qoftë se janë çështje financiare, të jenë nga institucionet financiare, e kështu me radhë. Ky është edhe një dakordim i përbashkët me organizatat joqeveritare.

Edhe në këtë ligj, prej fazës së planifikimit deri te hartimi i projektligjit ka qenë një bashkëpunim me të gjitha OJQ-të dhe besojmë që OJQ, ose Ligji për OJQ-të do të përmirësohet edhe tash në procedurat parlamentare me amendamentet e nevojshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Edhe kjo pikë e rendit të ditës mbetet për votim në momentin kur i kemi 61 deputetë.

24. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me Pallatin e Rinisë në Prishtinë

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me Pallatin e Rinisë në Prishtinë dhe Kuvendit i ka rekomanduar shqyrtimin e tij. Nga përfaqësuesi i Qeverisë, a e dëshiron fjalën dikush për Pallatin e Rinisë?

Unë do ta hapja debatin për shqyrtimin e tij, pasi e kisha ftuar zonjën Sala Shala-Berisha, kryetare e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Po e kemi një pikë në rend dite, të shqyrtohet propozim-vendimi i Qeverisë nr. 07/21, datë 22. 12. 2017 për heqjen e Ndërmarrjes Shoqërore Qendra Shoqërore Sportive Kulturore dhe Ekonomike Pallati i Rinisë nga menaxhimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për autorizimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që Qendra Kulturore në fjalë dhe asetet e saj të regjistrohen si ndërmarrje publike lokale.

Komisioni e ka shqyrtuar disa herë këtë propozim-vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Nuk e ka marrë pëlqimin në komision për shkak të disa paqartësive ligjore lidhur me heqjen e këtij institucioni nga AKP-ja, për shkak se Pallati i Rinisë është ndërtuar me kontributet e qytetarëve të regjionit. Pas dokumenteve që i kemi marrë, mungon dokumenti nga AKP-ja.

Komisioni e ka votuar dhe ia ka drejtuar seancës për shqyrtim, kështu që seanca vendos lidhur me këtë çështje, por duke parë se nuk ka kuorum për të vendosur, mendoj se ndoshta edhe kjo pikë duhet të shtyhet për një ditë tjetër. Komisioni ia ka drejtuar, e seanca le të vendosë për ta shqyrtuar pa rekomandim të komisionit.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

E kemi një problem me komisionet parlamentare, ka filluar të shndërrohet në praktikë, në dy-tri raste tani është duke u krijuar precedent i cili nuk është në bazë të Rregullores. Komisionet e pafuqishme për të marrë vendime, vetëm japin në shqyrtim si rekomandim. Kjo praktikë duhet të përfundojë, për arsye se nuk është në bazë të Rregullores, neni 62, nuk është sjellje adekuate, pika 1. Kështu që praktika që ia dërgon komisioni për shqyrtim seancës, e seanca shqyrton në fakt dhe vendos pastaj në fund, edhe shqyrton ashtu-kështu pa rekomandim të komisionit. Kjo nuk duhet të jetë kështu, komisionet parlamentare duhet ta japin qëndrimin e tyre në bazë të informacionet që i kanë, në mënyrë që ta orientojnë seancën, e jo ta lënë në shqyrtim, atëherë nuk ka nevojë të kemi fare komisione parlamentare, vijnë drejt në seancë parlamentare.

Kështu që radhëve tjera, nuk është vetëm kjo çështje, janë edhe çështje tjera, prandaj radhëve tjera është mirë që komisionet funksionale, të gjitha komisionet në fakt, ta sjellin rekomandimin, “po” ose “jo”. Këtë desha ta them, por unë kërkoj falje, duke e shqyrtuar këtë pikë të rendit të ditës, në rend të parë duhet t’ia jap fjalën përfaqësuesit të Qeverisë. E ftoj zëvendëskryeministrin, pastaj rikthehem prapë.

E ftoj zëvendëskryeministrin në emër të Qeverisë që ta marrë fjalën, se nga vonesa e paraqitjes së përfaqësuesit të Qeverisë e tejkaluam mënyrën e renditjes.

ENVER HOXHAI: I nderuar zoti kryetar,
Të nderuar kolegë nga Kabineti qeveritar,
Shumë të respektuar deputetë,

Zonja Sala Berisha-Shala e prezantoi në thelb se si e kemi adresuar këtë problem ne si Qeveri e Kosovës në dhjetor të vitit të kaluar, për ta hequr Ndërmarrjen Shoqërore Qendra Shoqërore Sportive Kulturore dhe Ekonomike e Pallatit të Rinisë në Prishtinë nga menaxhimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Kërkohej një votë, por para se ta votoni kërkohej që ju si Kuvend i Kosovës t'i jepni qartësi kësaj teme. Në Qeverinë e Kosovës e kemi pasur një debat shumë të gjatë për këtë temë, ka pasur edhe konsultime ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës para se të vijë në Kuvend dhe pas këtij debati do të ishte mirë që kjo temë të përmbillet dhe kjo qendër shumë e rëndësishme ta marrë një funksion më të rëndësishëm ekonomik, seç e ka pasur deri më tash.

KRYETARI: Zonja Sala Berisha-Shala përsëri, në emër të Komisionit Funkcional.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit edhe zëvendëskryeministër për fjalën tuaj.

Unë ndoshta, jo në emër të komisionit, por një mendim timin, se vërtet nuk është as e paraparë me Rregulloren e Kuvendit që komisionet parlamentare t'i drejtojnë në seancë pa i dhënë kah “e miratojmë” apo s’e “miratojmë”, por ndodhin këto situata. Dhe, mendoj se ndoshta ky duhet të jetë një rast që duhet të rregullohen mirë me Rregulloren e Kuvendit, e Rregulloren e Kuvendit ne e kemi në shqyrtim, në procedurë tash.

Unë, nga përvoja ime parlamentare në këtë Kuvend, mendoj që përveç dispozitave tjera në Rregulloren e Kuvendit duhet të ndryshohet edhe përfaqësimi i grupeve parlamentare nëpër komisione, të mos jetë aq raport i ngushtë pozitë-opozitë, sepse po e vërejmë se shumë çështje nuk po mund të ecin përpara për shkak të politikave të ndryshme që i kanë subjektet politike, pozitë dhe opozitë. Në këtë rast, kur jemi te Pallati i Rinisë, vërtet është një aset, të cilit institucionet e Kosovës duhet t'i japin drejtim. Ka nevojë të zhvillohet, të mos mbetet në aso situatë degradimi, por unë konsideroj që edhe Pallati i Rinisë në të njëjtën kohë, sikur edhe “Trepça”, se ndërmarrjet kur u ndërrohet statusi është njëfarë ngathtësie në dhënien e kahut të orientimit zhvillues të këtyre aseteve të rëndësishme për qytetarët e Kosovës. Ndoshta, në këtë rast edhe ky është i përfshirë nga ajo klimë.

Shpresoj që, nga përvoja do të dimë si t'u japim kah këtyre gjërave, po rikthehem prapë te Rregullorja e Kuvendit që të ndryshojë diçka në atë drejtim, në mënyrë që Kuvendi dhe çështjet shumë të rëndësishme të mos mbeten peng. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Islam Pacolli e ka kërkuar fjalën. Ju kisha lutur, kolegë deputetë, kërkojeni fjalën më herët...

ISLAM PACOLLI: Më fal, kryesues! Faleminderit!

Mendoj se është shumë i rëndësishëm ky trajtim, pasi Pallati i Rinisë u takon pikërisht qytetarëve dhe kontributet e baballarëve tanë nuk duhet të harrohen dhe mendoj se, edhe pse me shumë vonesë, është e rëndësishme që po trajtohet. Ne e përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Daut Haradinaj, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Nuk po e zgjas shumë, por vetëm për sqarim. Domethënë, po i kërkohet Kuvendit të Kosovës që të hiqet si ndërmarrje publike dhe të kthehet në ndërmarrje lokale, që nënkupton t'i jepet në menaxhim Komunës së Prishtinës, bile do të ishte mirë që edhe "Vetëvendosja" të jetë këtu, se në fund të ditës ata e qeverisin Prishtinën.

KRYETARI: Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Rreth kësaj çështjeje kemi pasur debate bukur të mira, të ashpra, herë me tone miqësore, e herë shumë kundërshtuese në komision. Nuk kemi arritur gjithmonë dakordancë, shpeshherë e kemi shtyrë në mungesë të kuorumit, në mungesë të palëve brenda komisionit, që e mbështetnin procedimin dhe të atyre që nuk ishin shumë të interesuar që ta shtyjmë përpara.

Do të kisha pasur vetëm një sugjerim, këshillë a lutje, si të duash quaje, që të mos e konsiderojmë në këtë pikë debatin e shteruar, të përfunduar e të shfrytëzuar, për faktin se palët që më së shumti kanë qenë të interesuara për këtë çështje mungojnë. Nuk dua të hyj në arsyet pse mungojnë, por do të ishte mirë që kjo çështje, jo vetëm të votohet, por edhe të debatohet kur të jenë edhe më shumë përfaqësues të Lidhjes Demokratike dhe të "Vetëvendosjes". Ndërsa, sa i përket "Nismës", "Nisma" e mbështet këtë transferim, bartje, si të duash quaje, me sugjerimet dhe vërejtjet, këshillat, të cilat i kemi dhënë edhe në komision.

Si ndërmarrje që ka qenë e krijuar dhe e financuar nga disa komuna, mendoj se të gjithë ata që e shohin veten si aksionarë apo edhe janë aksionarë të bëhen bashkë dhe ta ndërtojnë një ide se si do ta zhvillojmë këtë, por si aksionar kryesor sidoqoftë na del Komuna e Prishtinës dhe do ta kisha pasur të vetmen kërkesë, përpos mbështetjes, sepse fundi i fundit është një projekt që ka ardhur nga Qeveria e Kosovës dhe Qeveria në momentin kur e sjell në Kuvend supozohet që së paku ajo është unike rreth këtij qëndrimi dhe po besojmë se ka qenë unike kur e ka përcjellë për Kuvend. Kjo ishte ajo që desha të them, që nëse ka nevojë për këtë pikë debati të vazhdojë edhe kur të jenë palët që kanë më së shumti interes për këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Përshëndetje!

Besoj se kjo iniciativë veçse është e vonuar këtu dhe do të ishte mëkat që një hapësirë si ajo që e kemi në dispozicion dhe për të cilën kanë kontribuar seriozisht një numër i madh i qytetarëve tanë të mbetet peng i mungesës së vendimmarrjes politike.

Me sa kam informata, Komuna e Prishtinës është në koordinim të plotë sa i përket kësaj iniciative dhe vërtet nuk guxon të mbetet në atë gjendje Pallati i Rinisë, kur e dimë se sa janë mundësitë dhe e dimë se sa ka mungesë të hapësirave dhe kapaciteteve të tilla në kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

Kështu që unë ju kisha inkurajuar të gjithëve që sa më parë që të jetë e mundur ta shtyjmë përpara këtë iniciativë në mënyrën se si është koordinuar Komuna e Prishtinës, veçanërisht Komuna e Prishtinës me Qeverinë dhe t'i shtyjmë këto gjëra përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Milaim Zeka, fjala për ju. Deputetë të tjerë nuk ka të paraqitur në sallë.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Unë shumë shkurt.

Shpeshherë po e devijojmë debatin. Për shembull, dje ishte debati rreth pagave të kryeministrit, njerëzit debatonin këtu për çerdhe të fëmijëve, e për gjithçka. E tani, sa është i rëndësishëm Pallati i Rinisë që t'i jepet Komunës së Prishtinës, këtë e dimë. Në qoftë se flasim për kontribute, është mirë, në qoftë se jemi në fushatë, për t'i marrë disa vota prej atyre, edhe shoku Tito ka kontribuar në këtë drejtim, kështu që është edhe meritë e Titos dhe s'është mirë të harrohen kështu edhe meritat.

Tani, kur të shkojmë te "Grand Hoteli", edhe aty kemi për të folur për shokun Tito, që ka fjetur në dhomën 801, kush ia ka ndërrua "postavat", e kush e ka mbuluar, e kush e ka flladitur, prandaj mbi bazën e kësaj unë them që u bë shumë mirë që Pallati po i jepet Komunës së Prishtinës. Inshalla e kallin edhe një herë këta të "Vetëvendosjes".

KRYETARI: Nuk ka më të paraqitur për diskutim. Edhe kjo pikë e rendit të ditës mbyllet debati, mbetet për votim.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot i kemi trajtuar 20 pika të rendit të ditës, janë 15 projektligje, e kemi përmbyllur debatin për to. I falënderoj shumë të gjithë kolegët deputetë, të cilët deri në këto momente kanë qëndruar në mënyrë të dinjitetshme dhe e kanë kryer punën e tyre.

Ndërkohë, po e shoh që fjalën po e kërkon Memli Krasniqi, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Po, i nderuar kryetar, faleminderit!

Ne sot nja dy raste të mëhershme gjatë ditës, gjatë kësaj seance, diskutuam për mungesën e deputetëve.

Në vazhdim e patëm edhe një moralizim kështu goxha të mirë prej anës së deputetëve të LDK-së dhe tash po shihet që ata pikërisht e bojkotuan këtë seancë dhe s'po e bëjnë për herë të parë për ta pamundësuar funksionimin e Kuvendit të Kosovës.

Unë e shfrytëzoj rastin edhe një herë që t'i ftoj të gjithë deputetët, qofshin të koalicionit qeverisës, qofshin të opozitës, që para së gjithash t'i kenë interesat e qytetarëve që na kanë sjellë secilin prej nesh këtu dhe t'i shfrytëzojnë edhe të drejtat, por edhe përgjegjësitë që i kanë për ta kryer punën e deputetit dhe për ta zbatuar mandatin që e kemi secili, sepse ne sot kemi punuar vërtet në shqyrtimin e shumë pikave të rendit të ditës, por në pamundësi të pasjes së kuorumit ne s'po mund t'i votojmë ato formalisht. Andaj, moralizimi nuk u zgjati më shumë se tri-katër orë, për çka kërkua që të ketë më shumë nga pozita, ne sot për fat të keq jemi nja 4 më pak këtu për ta pasur kuorumin dhe ju i patë që një nga një, e dy nga dy, edhe pse kishte mjaft prej tyre në fillim, e lëshuan, për ta pamundësuar finalizimin e suksesshëm të kësaj seance, gjë që është për keqardhje. Por, është mirë ta dimë të gjithë, e besa edhe ta kemi në regjistër. Për këtë edhe e mora fjalën. Faleminderit!

KRYETARI: Sido që të jetë, unë ju falënderoj shumë, kolegë deputetë, që aktualisht jeni në sallë.

Me kaq e përfundojmë për sonte. Vazhdimin e seancës, e kemi edhe një seancë, që ka mbetur më herët dhe një tjetër. Ju lajmërojmë me mbledhjen e Kryesisë. Faleminderit!

* * *

E enjte, 15 mars 2018

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 2 mars 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuara zonja deputete dhe zotërinj deputetë,

Po e fillojmë vazhdimin e seancave të djeshme dhe pastaj votimet që i kemi.

I kemi tri pika të rendit të ditës, të cilat kërkojnë 2/3 e votave, do të thotë 80 vota dhe të tjerat kemi votime me shumicën e cilësuar, si i quajmë.

Meqenëse nuk e kemi kuorumin e duhur, unë po i heq këto tri pika të rendit të ditës që janë kryesisht marrëveshje ndërkombëtare dhe të cilat duhet ta kenë shumicën absolute të votave.

Tash u bënë 80 vota.

Kisha kërkuar deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, me qëllim që të mos futemi në votim dhe pastaj të kemi nevojë t'i përsërisim.

A jeni dakord me këto tri pika të rendit të ditës që kërkojnë 80 vota?

Është votimi i parë për Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë.

Kur të bëhen deputetët, unë i nxjerr në votim.

Tani janë 97 deputetë dhe mjafton për të futur në procedura të votimit me 2/3 marrëveshjet ndërkombëtare.

Ju njoftoj që për këto pika kanë përfunduar diskutimet.

3. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Holandës, SPARK, mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Në sallë janë 100 deputetë. Faleminderit!

Nga 100 deputetë, kanë votuar 71, kështu që numri i votave nuk ka rëndësi. Nuk ka kaluar. Shkojmë tutje.

4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim, ADA

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 80 deputetë, 80 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-053 për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim, Ada.

5. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike ReSPA

Kanë përfunduar diskutimet. Në sallë është prapë numri i njëjtë i deputetëve.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!:

Kanë votuar 77 deputetë, që do të thotë s'kemi kuorumin e kualifikuar nga 80 vota që duhet të jenë për, edhe ata disa kanë votuar kundër dhe disa për, kur të ketë disponim për ta votuar, e votojmë.

6. Votimi në parim i Projektligjit për miniera dhe minerale

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 70 deputetë, për janë 54, kundër 9 dhe një abstenim.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-027 për miniera dhe minerale.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

7. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 76 deputetë, për janë 52 vota, dikush e tërhoqi, se ishin 53, kundër 22 dhe kanë abstenuar 2 deputetë.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-225 për prokurorin e shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 05/L-034.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

8. Votimi në parim i Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!
Kanë votuar 77 deputetë, 70 vota janë për, asnjë kundër dhe 7 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

9. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!
Kanë votuar 80 deputetë, 78 vota janë për, asnjë kundër dhe 2 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

10. Votimi në parim i Projektligjit për produkte të ndërtimit

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!
Kanë votuar 78 deputetë, për janë 76 vota, asnjë kundër dhe 2 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-033 për produkte të ndërtimit.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

11. Votimi në parim i Projektligjit për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 79 deputetë, për 77 vota, kundër asnjë dhe 2 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-049 për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

12. Votimi në parim i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 78 deputetë, për 76 vota, kundër asnjë dhe 2 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

13. Votimi në parim i Projektligjit për shërbimet postare

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 76 deputetë, për 70 vota, kundër asnjë dhe 6 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-038 për shërbimet postare.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

14. Votimi në parim i Projektligjit për metrologji

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 78 deputetë, 76 vota janë për, 2 kundër, asnjë abstenim.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-037 për metrologji.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

15. Votimi në parim i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 79 deputetë, 66 vota janë për, 9 vota kundër dhe 4 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

16. Votimi në parim i Projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 72 deputetë, 72 vota janë për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

17. Votimi në parim i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 75 deputetë, 66 janë për, 8 vota janë kundër, 5 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shoqëritë tregtare

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, zonjën Sala Berisha-Shala, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Në këtë projektligj për shoqëritë tregtare propozohen 26 amendamente.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve:

Amendamenti 1.

Kundër nuk ka? Abstenim nuk ka? Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër nuk ka? Abstenim nuk ka? Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër nuk ka? Abstenim nuk ka? Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër nuk ka? Abstenim nuk ka? Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër nuk ka? Abstenim nuk ka? Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër nuk ka? Abstenim nuk ka? Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër nuk ka? Abstenim nuk ka? Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër nuk ka? Abstenim nuk ka? Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër nuk ka? Abstenim nuk ka? Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër nuk ka? Abstenim nuk ka? Miratohet.

Amendamenti 11.

Është pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë me elektronikë.

Amendamenti 11 pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL nga deputeti Korab Sejdiu, votojmë tash!

Miratohet me 54 vota, 31 vota kundër dhe 2 abstenime.

Amendamenti 12.

Nga deputetja Mimoza Kusari-Lila, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Zonja Lila, a keni sqarim për këtë?

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, nënkryetar!

Këtë amendament e kam prezantuar edhe në fjalimin tim më 8 Mars, Ditën Ndërkombëtare të Gruas, ka të bëjë me nenin 34, pika 2, të shtohen nënparagrafët.

Në pikën 2.5.1 Numri i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Shoqërive Aksionare duhet të përmbajë edhe kuotën prej 40% pjesëmarrjeve të grave në bord.

Pika 2.5.2 Zbatimi i kësaj kuote duhet të fillojë jo më vonë se gjashtë muaj pas miratimit të ligjit.

Pika 2.5.3 Pas dy vjetëve të zbatimit të ligjit kuota gjinore fillon aplikimin e saj në 50%.

Pika 2.5.4 Sanksionet për mospërfillje të kësaj kuote do të përcaktohen në masën nënligjore, të cilat burojnë në ky ligj.

Mendoj, nënkryetar dhe të nderuar deputetë, e kemi rastin e drejtpërdrejtë që në mënyrë afirmative të ndihmojmë përfshirjen e fuqizimin e gruas në ekonomi, përderisa numri i shoqërive aksionare private në Kosovë nuk e kalon numrin 240, 40% të pjesëtareve në bordet e këtyre ndërmarrjeve do të nënkuptonte që të kemi, nëse nuk janë asnjë grua e involvuar, të paktën 240 gra në borde të ndërmarrjeve private.

Ju ftoj që ta përkrahni dhe ta miratoni si një formë e drejtpërdrejtë të inkuadrimin të gruas në vendimmarrjen dhe fuqizimin ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqenëse kryetarja e komisionit nuk është këtu dhe askush nuk është i ngarkuar për të bërë opionencën, unë e ftoj ministrin që të sqarojë lidhur me këtë amendament dhe pastaj është çështje e deputetëve a do ta votojnë apo ajo.

MINISTRI BAJRAM HASANI: Pavarësisht dëshirës për të përkrahur pjesëmarrjen e 40% të gruas në borde, unë besoj që për shkak të rrethanave që janë, për shkak që u shkaktojmë shumë telashe edhe ndërmarrjeve private, propozoj që ky amendament nuk duhet të kalojë, në përjashtim mund të marrim vendim për ndërmarrjet publike.

Mirëpo për ndërmarrjet private ju siguroj që do të shkaktojë telashe, për shkak se edhe në vendet më të zhvilluara, diku 23,3% është pjesëmarrja në borde e grave, dhe ne nuk jemi të përgatitur që të kemi 40% këtë pjesëmarrje të grave nëpër borde drejtuese.

Për shkak se e thamë edhe një herë se shtetet më të zhvilluara nuk e kanë këtë kuotë, edhe nuk mund të merret një vendim të gjitha bordet të përfaqësohen. Kemi praktika evropiane që kanë kuota për sektorë të caktuar, siç janë për ndërmarrjet publike apo ndërmarrjet të cilat kanë shumë aksionarë, mirëpo këtu, ju siguroj që ky ligj na shkakton shumë telashe gjatë zbatimit nëse aprovohet ky amendament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I morët sqarimet. Është ajo që e ka bërë amendamentin, ti s'e ke bërë amendamentin.

Zonja Sala Berisha-Shala, e keni fjalën, pasi erdhët.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Për amendamentin për të cilin po flasim, Komisioni Parlamentar nuk e ka mbështetur, mirëpo nga këndvështrimi i fuqizimit të gruas, ne mendojmë se duhet të mbështetet ky amendament.

Ne e kemi një dispozitë të tillë të Ligji për ndërmarrjet publike, i cili e parasheh që në ndërmarrjet publike 50% të jenë të përfshira në bord edhe gratë.

Ne i kemi ftuar edhe përfaqësuesit e bizneseve private, ka pasur mendime të ndara në dysh. Mirëpo, ne do të fillojmë hapat, ta fuqizojmë gruan edhe në këtë sektor, kështu që kisha kërkuar të hedhim në votim, të shohim çka po vendos seanca. Mirëkuptimin tuaj, ministër. Faleminderit!

KRYESUESI: E nxjerr në votim me elektronikë, sqarimet i keni marrë.

(Reagime nga salla)

Po për çka grupet, për amendament, po s'kanë lidhje grupet me amendament.

Në emër të grupeve, po s'ka procedurë, merre dikush fjalën. Kujtimi, në emër të Grupit Parlamentar nëse flet.

KUJTIM SHALA: Jo në emër të grupit parlamentar, po për procedurë, zoti kryesues, për amendamentet të gjithë deputetët, nëse kanë vullnet kanë të drejtë që të diskutojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Mirë, pra, të gjithë diskutoni. Fjalën e ka Vjosa Osmani, si fituese. Unë e di, po veç çka po zvarritemi për çështje që më shumë po diskutoni për elektorat...

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Nuk është çështje e zvarritjes, zoti kryesues, po është çështje e sqarimit për publikun.

Zoti ministër, në qoftë se ju nuk jeni i përgatitur, gratë janë të përgatitura që më në fund ta marrin vendin e tyre të merituar jo vetëm në institucione publike, por edhe t'u ndihmojmë nëpërmjet rolit tonë që atyre t'u njihen meritat, t'u njihet profesionalizmi dhe t'u njihet përgatitja edhe në ndërmarrje shoqërore.

Ju thatë që asnjë vend i zhvilluar nuk ka një model të tillë. Norvegjia, zoti ministër, është vendi i zhvilluar, Italia, zoti ministër, është më afër rajonit dhe është vendi i zhvilluar, edhe Islanda është vend i zhvilluar dhe shembull për barazi gjinore dhe tani edhe Bullgaria është duke parë shembuj të tillë.

Mirëpo, mbi të gjitha, ne të ndalemi në Kushtetutën tonë.

Neni 24, pikë 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pa bërë dallim në mes të institucioneve publike apo ndërmarrjeve private, thotë: “Në qoftë se një grup është më pak i përfaqësuar, atëherë institucionet publike ndërmarrin masa deri në momentin kur të arrihet kjo barazi”. Pikërisht këtë po e bëjmë nëpërmjet këtij amendamenti.

Prandaj, në vend se të refuzohet, unë shpresoj shumë që jo vetëm gratë e këtij Kuvendi, por edhe burrat në Kuvend, edhe burrat si ju në Qeveri, më në fund të përkrahni masa të tilla, sepse kjo, po ju siguroj, jo që do të krijojë probleme, siç e thatë ju, por vetëm do të rrisë kualitetin dhe fitimet në këto ndërmarrje shoqërore.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Emilija Rexhepi. Tash po doni të diskutoni, regjia, tre minuta i ka secili deputet që dëshiron të diskutojë.

Zonja Emilija Redžepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se gospodine predsedavajući!

Uvaženi predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

A pre svega kolege poslanice,

Mi smo u obavezi danas da podržimo amandman koga naša koleginica Mimoza predložila i stalno se borimo za neko vrstu ravnopravnosti polova i stalno se borimo da uključimo žene u sve sfere kosovsku društva.

I ovaj amandman direktno se reflektuje na položaj žena u javnim institucijama i mi smo u obavezi da ovo podržimo. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi, e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Realisht ne duhet këtu të flasim të vërtetën se çka është duke u kërkuar të bëhet.

Duke u fshehur në petkun e fuqizimit të gruas, ky amendament tenton ta fusë shtetin në sektorin privat.

Për mua është komplet jo veç e pakuptimtë, po dyfytërsi e përtej dyfytërsie një parti që i thotë vetes parti e qendrës së djathtë të kërkojë të bëjë ligje, të cilat ia imponojnë sektorit privat, kompanive private, ndërmarrjeve private qysh duhet t'i rregullojnë punët e tyre të brendshme, ku ka është në një vend normal?

Ndërmarrjet publike në sektorin publik, unë jam 100% t'i mbështesim, jo edhe 30% që e kem në Kuvend, po hajde po e bëjmë edhe 50%, edhe në ndërmarrjet publike, në të cilat ne kemi interesin publik, po me çfarë logjike ne sot shkojmë e i themi një ndërmarrje private, një kompanie private, s'ke qare pa i pasur burra ose gra kaq shumë.

Ju e dini që shumica e ndërmarrjeve në Kosovë janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme, shumica e këtyre ndërmarrjeve janë familjare dhe sot me këtë amendament ne po u themi "s'keni qare pa i shti në bord një numër të caktuar të grave".

A jeni duke kuptuar që ky precedent që mund të shkaktohet sot, mbi të gjitha është një shkelje e sektorit privat, është një imponim që shteti do t'ia bëjë sektorit privat, është një diçka e cila neve na kthen mbrapa nga krejt arritjet që janë bërë deri sot në rregullimin e ambientit të të bërit biznes. Neve nuk na vyen rregullativë, ne duhet ta derregullojmë sa më shumë që të mundemi sektorin e biznesit. Sa më shumë që ka rregullativë prej qeverisë në sektorin privat, aq më keq i ka punët një shtet, aq më keq i ka punët biznesi. Nëse ne kemi këtë logjikë, hajde po e bëjmë edhe një amendament, po u themi, për shkak që e keni moshën e re, mosha mesatare është rreth 26 vjet, "s'keni qare pa i shti në bord 30% nën moshën 30-vjeçare".

Logjika është e njëjtë, ose po u themi "s'keni qare pa i shti mbi moshën 65-vjeçare", sepse po flasim për demografi. Nuk është e vërtetë që këtu ka të bëjë veç me fuqizimin e gruas. Unë kam përvojë edhe prej Ministrisë së Bujqësisë, gjithmonë edhe kur e kam pasur atë përgjegjësi i kemi mbështetur ato aplikime që vijnë prej grave dhe absolutisht nëse i shihni shifrat deri sot, ka qenë një numër më i madh se në krejt rajonin i përfitueseve gra, por nëse hyni dhe analizoni vërtet a janë ato gra vërtet ndërmarrëse, është një çështje tjetër. Sot po tentohet të krijohet një situatë, për të cilën do të dalë nesër sponsorizuesja e thotë: "E kam bërë një të arritur". Për mua është e habitshme, edhe në kuptimin ideologjik, edhe në kuptimin politik, kjo mund të jetë politikë skajshmërisht e majtë, po absolutisht lidhje nuk ka as me fuqizimin e gruas, as nuk ka lidhje me forcimin e biznesit, as me përmirësimin e ambientit të të bërit biznes.

Qëndrimi zyrtar i Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është që ky amendament të mos mbështetet, sepse s'e kemi mbështetur as në Komisionin Funkcional. Deputetët ndoshta mund ta votojnë, sipas bindjeve të tyre të lira, por nuk e përfaqësojnë qëndrimin tonë zyrtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Memli po thotë se ndërmarrjet private e kanë pavarësinë e tyre për të vendosur, sepse janë entitete private. Familja është edhe më private se sa një biznes, por shteti, gjegjësisht shoqëria, përmes ligjeve, në këtë rast që i miraton Kuvendi, kanë ndërhyrë edhe në këtë rast me Ligjin për

trashëgimi, sepse ka thënë që trashëgimia duhet të ndahet baras mes të gjithëve, pa marrë parasysh gjininë. Edhe në këtë rast në shoqëritë ku historikisht kanë ekzistuar padrejtësi, e në shoqërinë tonë kanë ekzistuar dhe, për fat të keq, vazhdojnë të ekzistojnë padrejtësi edhe të natyrës gjinore, është detyrë e shtetit, në këtë rast, është detyrë jona që të intervenojmë në korrigjimin e këtyre padrejtësive.

Ne nuk mund të pretendojmë të ndërtojmë një shoqëri të barabartë, kur një shans të tillë nuk ua japim grave në biznese. Kjo është një mundësi e mirë që të fillohet, sepse këto padrejtësi nuk mund të garantojmë zbatimin e ligjit, sepse ne për çdo ditë hasim në ose në moszbatim të ligjeve, ose në shkeljen e tyre, por për këtë punë e kemi edhe gjyqësorin që të kujdeset që ligji të zbatohet, por ne si ligjvënës duhet të bëjmë hapin për korrigjimin e këtyre padrejtësive, për dhënien e një mundësie më shumë grave në pavarësinë e tyre, fillimisht ekonomike, e pastaj politike, në përgjithësi. Kështu që unë i ftoj kolegët e mi burra në këtë Kuvend që të votojnë pro këtij amendamenti, sepse besoj se për koleget gra kjo nuk është tashmë as e diskutueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: A ta përmendi emrin, a? Zoti Krasniqi e ka fjalën për replikë.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Fillimisht, e përgëzoj edhe e uroj zonjën Pantina për grupin e ri parlamentar, u uroj punë të mbarë dhe suksese, po ashtu edhe një bashkëpunim konstruktiv pozitiv-opozitiv. E dyta, nuk duhet të përzihen mollët dhe dardhat, sepse unë nuk fola për të drejtat fundamentale të njeriut garantuar me Kushtetutë. E drejta në trashëgimi, e drejta për jetën e garantuara edhe çështje të tjera janë pjesë e Kushtetutës të Kosovës, janë pjesë e deklaratave universale të drejtave të njeriut e kështu me radhë.

Ne po flasim këtu për ushtrimin e një biznesi, ne po flasim këtu për sektorin privat, për kapitalin privat. Shteti nuk mundet, nuk duhet, në komunizëm ua ka imponuar, në demokraci, keni këtu deputetë që janë biznesmenë, që janë afaristë, që kanë kompani private, pyetni këta, pyetni a është normale shteti t'u kallëzojë kënd ta shtinë në Bord? Kënd ta bëjnë drejtor, kënd jo? Unë jam 100% në favor që të arrihet ai nivel, jo veç 40%, le të bëhen 80%, jam i bindur që shumica e bizneseve, besa edhe ndërmarrjeve publike, ndoshta më mirë udhëhiqen prej grave se sa prej burrave. Problemi është që s'duhet t'ua imponojmë ne si shtet. Është e tepërt nëse ne fillojmë ta rregullojmë sektorin privat deri në këtë nivel. Kjo është shkarje prej demokracisë, kjo është imponim, ky është vendim autokratik sot nëse kalon në këtë Kuvend. Nuk ka të bëjë me të drejtat dhe liritë e garantuara themelore fundamentale, për këtë arsye, zonja Pantina, nuk po flasim për ato që i përmende ti, po flas për sektorin privat, për të drejtën e të ushtruarit biznes.

Nuk është kushtetuese, mbi të gjitha, dhe nesër nëse e kalojmë unë jam i bindur iniciativa e parë në Gjykatën Kushtetuese do ta kthejë mbrapsht, sepse nuk ka bazë kushtetuese kjo punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina më duket ka kërkuar kundër-replikë.

SHQIPE PANTINA: Sërish po them, shteti ndikon dhe ndërhy në korigjimin e pabarazive në çfarëdo fushe. Ato mund të duken diskriminuese, e në rregullimin tonë shoqëror kemi mjaft ligje të tilla që në dukje të parë janë diskriminuese, por janë bërë për të siguruar barazinë, për të korigjuar pabarazitë. Prandaj, edhe kjo, edhe sektori privat nuk mund të veprojë i mbyllur dhe nuk është i përjashtuar nga shoqëria edhe sektori privat është pjesë e shoqërisë, për më tepër këtu po kërkohet vetëm përfaqësim në borde. As nuk po kërkohet ndërhyrje në menaxhim, as nuk po kërkohet ndërhyrje në pronësi.

Bordet duhet të përfaqësojnë shoqërinë në përgjithësi, edhe ndarjen në baza gjinore. Kështu që unë edhe një herë ju ftoj të gjithë deputetëve dhe e falënderoj zonjën Kusari-Lila për iniciativën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Në këtë rast më habit fakti qëndrimi i ministrit në fjalë, i cili vjen nga një subjekt që deklarohet me program social-demokrat, i cili ka për obligim afirmimin e rolit të gruas në shoqëri, prandaj besoj që në këtë rast subjekti i vet ishte dashur të distancohet nga qëndrimi i ministrit këtu sot.

Unë i ftoj të gjithë deputetët që ta përkrahin amendamentin në fjalë, sepse ne si shoqëri a si shtet kemi obligim të vendosim mekanizma për afirmimin e rolit të gruas në shoqëri, në veçanti në biznes, sepse tash këtu edhe u tha që gratë janë treguar si shumë ndërmarrëse të suksesshme, qoftë biznese familjare, qoftë në biznese private, por edhe në të gjitha institucionet publike. Kudo që gruaja në baza meritore e ka marrë postin, ajo e ka ushtruar dinjitetshëm dhe me sukses, duke pasur parasysh që jemi 50% me 50% të popullatës, duke pasur parasysh që kemi gra të shkolluara dhe shumë të zonja, nuk e shoh asnjë problem, bile as më të voglin, pse të mos jenë të përfaqësuara jo 40%, por edhe 50% aq sa e meritojnë, po ta lëmë këtë moment me kaq, prandaj ju ftoj që ta përkrahim amendamentin në fjalë dhe ta votojmë ashtu siç është propozuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Shpresoj që të mos shndërrohet ky debat tash në luftë mes gjinive, së paku këtë shpresoj, pas krejt kësaj të mos shndërrohet në debat luftë mes dy gjinive. Çka nuk u tha, komunizëm, majtizëm ekstrem, social-demokraci e djathtë, qendër e djathtë, a i lamë këto debate për ndonjë debat tjetër, për ndonjë moment tjetër.

Në komunizëm s'ka hiq pronë private, veç ndonjë kotec pule të lejohet. E nëse hyjmë në atë aspekt, se ky ligj po e shndërroka shoqërinë në komunizëm, ky nen, përkatësisht nuk e bën komuniste, sepse komunizmi nuk e lejon fare pronë private apo ka lejuar ndonjë pulë të mbahet eventualisht, përjashto disa versione të tjera. Por, po hyj unë në temë, imja dhe jona, po përpiqem përmes këtyre dy nocioneve ta shpjegoj se pse dy sistemet kanë dështuar, se ku kanë dështuar dy sistemet, apo përkatësisht se pse njëri ka dështuar e tjetri ka ecur përpara. Në komunizëm gjithçka ka qenë jona dhe meqë gjithçka ka qenë jona, ajo pastaj ka qenë e askujt dhe duke mos u ndjerë askush përgjegjës për atë pronë të përbashkët, ajo ka dështuar. Ky farë kapitalizmi, për të cilin edhe social-demokracia e mbështet, edhe pse jo atë kapitalizmin e egër neoliberal, kjo vlen për kolegen Kollçaku, se s'ka lidhje kjo me social-demokracinë çka po propozohet me këtë nen.

Sepse, demokracia nuk është kundër ekonomisë së tregut, por edhe është kundër apo nuk është për ndërhyrjen në çdo sferë të shtetit në ekonominë e vendit. Ajo që unë tash do të flas lidhur me këtë amendament, jam anëtar i këtij komisioni dhe kemi debatuar në komision rreth kësaj çështje. Unë edhe me kolegen Mimoza kemi biseduar, nuk jemi kundër që një e drejtë e tillë t'u sigurohet femrave, çështja është duke e miratuar një ligj, një nen, përkatësisht në kuadër të këtij ligji që japim një të drejtë një gjinie, pa marrë parasysh në këtë rast a është mashkullor apo femëror, por i ndërhyjmë në atë që quhet imja. Pra, ai zotëria apo zonja që e ka themeluar një firmë me krejt të drejtën kushtetuese, e ka themeluar si pronë të vetën, Parlamenti ka të drejtë të miratojë ligje që atij i ndihmojnë që të avancojë biznesin e tij. Unë kam frikë se duke i imponuar rregullativat e tilla, mund të shndërrohemi në pengesë për zhvillimin e biznesit, jo se femrat janë më pak të zonja, të mos e ngatërrojmë këtë, të mos e shndërrojmë në luftë të gjinive, por sepse është e drejtë ekskluzive e tij të përcaktohet se me kënd do të bashkëpunojë edhe me kë do ta zhvillojë, ta rrisë biznesin e tij, ndërmartjen e tij.

Nëse ne i themi tash jo, ti nuk mund të vendosësh se kush me kë do të bashkëpunojë, do ta zhvillojë biznesin, afarizmin e tij, unë mendoj që jemi duke ndërhyrë në një fushë të rrezikshme ku, pajtohem plotësisht me kolegun paraprak, është çështje që Gjykata Kushtetuese nuk do ta lejojë një gjë të tillë. Po ndërhyjmë në pronën private, të mos e krahasojmë pronën private të një familje të përbashkët që e kanë krijuar bashkë, që lidhet me trashëgiminë, ku natyrisht secili ka kontribuar për atë pronë dhe i takon secilit dhe secilës të marrë hise nga ajo, me pronën tënde apo pronën time, ku përveç një ligji mua më jepet mundësia të ndërhyjë në pronën tënde dhe ti detyrohesh apo unë detyrohem të marr dikë tjetër të punojë.

Këto dilema i kemi pasur në komision, unë vazhdoj t'i kem këto dilema që a po e ndihmojmë biznesin apo jo. Përmes këtij ligji a po ndërhyjmë në një të drejtë kushtetuese që secili ka të drejtë të zhvillojë biznes me këdo dhe si do. Po flas për sferën private, jo për atë publike, sepse për atë jemi marrë vesh, çdo kund ku ka mundësi të imponojmë me ligj kuotë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Së pari, mendoj që një çështje që do të duhej të dihej apriori është që edhe barazia, edhe drejtësia fillojnë dhe zhvillohen në shoqëri dhe, në këtë drejtim shoqëria edhe ekonomia janë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën, sepse ekonomia është segmenti më i rëndësishëm i zhvillimit shoqëror, i cili pastaj i mundëson edhe zhvillimet e tjera edhe segmentet e tjera të shoqërisë, të cilat janë të domosdoshme të ndodhin në Republikën e Kosovës.

Në këtë drejtim dhe duke pasur parasysh të dyja këto çështje që për mua janë parimore, atëherë institucionet publike natyrisht që janë të detyruara të miratojnë masa përmes të cilave ekonomia vihet në funksion të mirëqenies shoqërore, të zhvillimit shoqëror, të barazisë dhe të drejtësisë dhe në këtë drejtim po e shoh edhe këtë amendament. Pra, më shumë se sa ndërhyrje në lirinë e ndërmarrësisë edhe të tregut që u paraqit këtu, më shumë po e shoh si një kornizim të një shoqërie të drejtë, obligim për të cilën e kemi ne si Kuvend, e ka Qeveria si ekzekutiv dhe secili institucion tjetër publik në Republikë e Kosovës.

Mendoj që ato që u thanë si postulate doktrinarë, kryesisht nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, nuk qëndrojnë as teorikisht, as praktikisht. Pra, është dëshmuar tashmë, veçanërisht prej vitit 2008 e tutje që në fakt, tregjet ose sektorët e tregjeve që janë absolutisht të parregulluara shkaktojnë kokëçarjet më të mëdha ekonomike, edhe krizat më të mëdha ekonomike. Dhe, përgjithësisht ndikojnë edhe në uljen e intensitetit dhe rritjes ekonomike të vendeve që i kanë aplikuar metoda të tilla. Po kjo nuk do të thotë tash që duhet të lëvizin në këtë drejtimin tjetër dhe në ekstremin tjetër dhe të themi që çdo gjë duhet rregulluar skajshmërisht. Ky amendament nuk po e thotë këtë, ky amendament po e propozon në lloj dizajnimi, do të thosha ashtu, të bordeve të ndërmarrjeve, në këtë rast private, për ato ndërmarrje që kanë borde, e duhet të thuhet po ashtu që është absolutisht e pasaktë, thuhet që ndërmarrjet e vogla edhe të mesme në Kosovë të gjitha funksionojnë me borde. Këto borde do të duhej të dizajnoheshin në atë mënyrë që të ketë prani në to jo vetëm të pronarëve e të atyre hisedarëve të drejtpërdrejtë në korporata, t'i quaj ashtu, por edhe një prani të shoqërisë për ta balancuar dhe për të arritur dimensionin e përgjegjësisë sociale që korporatat e ndërmarrjet duhet ta kenë për ekonominë dhe shoqërinë në përgjithësi në Republikën e Kosovës.

Dhe, ky nuk është rast i vetëm që po propozohet e po diskutohet këtu në Kosovë, ka raste të shumta nëpër ekonominë e zhvilluara të tregut në vendet perëndimore, ku ka të obligueshëm

prani, ta zëmë, të përfaqësuesit të punëtorëve, përfaqësuesit e shoqërisë civile, ku ta di unë organizatave të mbrojtjes së mjedisit e kështu me radhë nëpër bordet e korporatave, në mënyrë që të ketë edhe zë edhe votë përfaqësimi për këto pjesë të shoqërisë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Blerim Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Një pjesë të fjalëve që pata ndërmend t'i them i tha zoti Memli Krasniqi dhe vërtet e tha në formën e duhur. Po unë po them që e mirëkuptoj betejën e kolegëve për avancim në role të grave në shoqëri, por nuk ka kuptim të kalohet prej një ekstremi në ekstrem tjetër. Forma e ngadaltë, forma e një tranzicioni do të ishte shumë më mirë se sa kjo formë, sepse do të prishë shumë ekuilibra në zhvillimin ekonomik.

Po ashtu, dua të shtoj ne assesi nuk e kemi shtruar këtë debat me vetë ata, të cilët dëmtohen ose përfitojnë në këtë aspekt. Vetë shoqëritë apo ndërmarrjet kosovare, vetë biznesin privat në këtë formë ua bëjmë atyre një të padrejtë. Ne kemi komunikuar në mes vete, po asnjë debat me ta nuk e kemi shtruar. Kjo formë nuk ka kuptim sidomos në shoqërinë kosovare, prish ekuilibrat dhe çrregullon zhvillimin ekonomik, edhe është një ndërhyrje te bizneset private, jo vetëm ata që janë këtu, por edhe ata të cilët presin me të drejtë të vijnë nesër. Po ashtu, lufta e kolegeve tona në këtë formë po më duket e pakuptimtë. Unë e kuptoj që edhe ato e kanë për votë, por duke luftuar shumë për votë, do ta prishim biznesin apo ekuilibrin e bizneseve tona në Kosovë. Dikush e përmendi, pyetni ata, të cilët kanë kompani. Unë e kam një kompani, do të ishte e padrejtë të insistohet përmes kësaj ndërhyrje dhe kjo është ndërhyrje në biznesin privat, e sidomos në ekonominë e tregut të lirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kujtim Shala e ka fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Do të përpiqem të bëj dy-tri saktësime përtej imtësive pa lidhje, për të djathtën e për të majtën. Po përpiqem të jem krejt konkret. E para, amendamenti është propozuar nga një deputete që është kolege jona, do të thotë s'është amendament i një grupi parlamentar dhe grupi ynë parlamentar nuk e ka një qëndrim për këtë amendament. E kjo do të thotë që kolegët e grupit tim do të vendosin sipas bindjes, e unë do të them bindjen time që kam për këtë propozim, asgjë më shumë.

E para, unë mendoj që ky amendament ka bazë kushtetuese të kontestueshme, s'jam i sigurt që ka bazë kushtetuese, ose më shqip, nuk jam i sigurt që s'është në kundërshtim me dispozitat kushtetuese të Republikës së Kosovës.

E dyta, nëse kjo shtrohet si çështje e përfaqësimit dhe lidhet me cilësinë, unë nuk e kuptoj aty ku pretendohet që ka cilësi, pse duhet të ketë kuota.

E treta, nëse doni t'u ktheheni qëndrimeve dhe politike, edhe ideologjike, për funksionimet e djathta ose të majta, unë mendoj që kjo s'ka të bëjë aspak me tregun e lirë, s'ka të bëjë me ekonominë e tregut, e as me atë që qendra e djathtë e quan "ekonomia sociale e tregut". Për shkak se kam dilema të tilla, unë për vete nuk mund të mbështes një propozim të tillë. Të tjerët vendosin vetë sipas bindjes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Arsyeja se pse e mora fjalën është për shkak se kemi pasur diskutime dhe në Komisionin për Legjislacion sa i përket këtij amendamenti. Fatkeqësisht Komisioni për Legjislacion nuk e ka përkrahur, përveç meje, pra vetëm unë si kryetare e komisionit e kam përkrahur si amendament, por jo edhe anëtarët e tjerë të komisionit, edhe nga radhët e LDK-së që kanë qenë të pranishëm nuk e kanë përkrahur këtë amendament. Shpresoj që tash ta kenë ndryshuar mendjen dhe ta votojnë amendamentin e tillë.

Po flitet shumë për Kushtetutën, për vlerat, për barazinë gjinore jo shumë larg 8 Marsit jemi, pikërisht në ditën ku në këtë Kuvend flitej për barazi gjinore dhe po më duken qëndrimet e sotme goxha si kthesë apo regres në këtë drejtim. Edhe bazuar në Kushtetutën e vendit, duke qenë që Komisioni për Legjislacion edhe ka për detyrë t'i vlerësojë amendamentet në aspektin kushtetues, unë vetëm, pa dashur që ta zgjas shumë dua ta lexoj nenin 7 të Kushtetutës që ka të bëjë me vlerat, paragrafi 2: "Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore". Edhe një herë po e them që ne si grup parlamentar do ta përkrahim këtë amendament dhe uroj që njësoj do të veprojnë edhe deputetët e grupeve të tjera parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje ministra,

Kolegë dhe kolege,

Në lidhje me amendamentin 12, të koleges Mimoza Kusari, mendoj se po bëhet një debat i panevojshëm, sepse pikërisht gratë dhe burrat, të cilët i njohin të drejtat e njeriut duhet ta përkrahin këtë amendament. Me këtë desha të them unë diferencohem nga qëndrimi i Partisë Demokratike, sepse mendoj se gratë janë të diskriminuara në përfaqësimin e bordeve në përgjithësi, në përfaqësimin e udhëheqjes së shtetit në përgjithësi, në marrjen e vendimeve ato marrin pjesë shumë pak. Prandaj, kujtoj nuk është përzierje në të drejtën e familjes dhe në të drejtën e pronës nëse kërkojmë që në bordet e ndërmarrjeve private të ketë edhe femra dhe të përfaqësuara si duhet, sepse sot në tregun e punës ka gra që janë të kualitetit dhe ka gra që mund të jenë përfaqësuese të tilla dhe t'i ndihmojnë bizneset.

Tek e fundit, gratë kanë mjaft afinitet sa u përket bizneseve, por nuk e kanë pasur rastin dhe mundësinë. Ne duhet të diskutonim pse në bordet e ndërmarrjeve publike nuk ka gra, kjo është tema që duhet ta debatonim, e jo që të ndërtojmë mekanizëm në të cilën do të përfaqësoheshin edhe gratë me kuotën e caktuar. Unë s'besoj që do të arrijmë në 30, sepse të gjithë paskan shumë paragjykime në shoqërinë tonë. Por, ky mekanizëm do ta ndryshojë këtë paragjykim. Në tregun e punës të gjithë kemi gra më të shkolluara, më të përgatitura dhe pse të mos i shtyjmë më tutje që të jenë edhe në ndërmarrësi. Tek e fundit, ndoshta me përfaqësimin e grave ne do të kemi edhe përmirësim në vetë menaxhimin e një ndërmarrjeje, sepse gruaja ka një intuitë ndryshe. Jam dhe apeloj që gratë, jo vetëm gratë deputete, por edhe të tjerët që përkrahin barazinë gjinore dhe me këtë përkrahin edhe një shoqëri demokratike, ku gruaja do t'i ketë mundësitë e barabarta, ta votojnë amendamentin e koleges. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ju kisha lutur, se të gjithë keni çka të flisni, qëndrimet e grupeve më mirë është t'i thoni, e deputetët të vendosin, se qysh jeni duke u paraqitur, krejt gratë janë paraqitur të diskutojnë edhe nga një herë. Në rregull, meqenëse vendosëm të hapet debati për këtë nen, e vazhdojmë, besoj që në rregull është. Direktivat i dëgjojmë ne, po s'i zbatojmë. Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Zoti kryesues, unë të betohem kështu në Bibël dhe në Kuran që askund nuk është ideja e as qëllimi të mbrohen këtu të drejtat e grave. Kjo është demagogji që të nxirret ndonjë votë te nënat e shkreta, se po të kishin dashur këta deputetë të luftojnë për të drejtat e grave, ju a kishit bërë sigurimet shëndetësore, ju a kishit bërë pushimin e lehonisë 12 muaj, kishit bërë ligje që favorizojnë gruan edhe e rrisin forcën e gruas në shoqëri.

Le të dalë zoti Behxhet Pacolli në foltore e le të na tregojë a i ndërhyt shteti i Zvicrës se sa njerëz i çon në bord kompania e tij? Kjo hajgare të krahasohemi me Norvegjinë e Suedinë, kur ne jemi jashtëtokësorë, ne jemi shtet jashtëtokësor, dëgjo, në Suedi e ke 18 muaj pushimin e lehonisë, në Suedi e merr baba pushimin e lehonisë, në Suedi e ke shërbimin shëndetësor për fëmijë, edhe te mjeku i dhëmbëve falas deri në moshën 18-vjeçare. E ne s'kemi këtu ndihma sociale, s'kemi këtu kurrigjë hiq, ju s'keni sjellë kurrfarë ligjesh në favorin e grave, e tash po

çoheni hop, po i qesim në bord atje 40%. Kjo ndërhyrje flagrante në punën organizative të ndërmarrjeve private, prandaj unë personalisht, duke qenë mbrojtësi më i madh i të drejtave të grave, të fëmijëve dhe të pleqve në këtë vend, i ftoj të gjithë kolegët e mi të votojnë kundër këtij amendamenti, sepse do të qeshë dynjaja me neve që ne të ndërhyjmë te ndërmarrjet gjoja po bëjmë diçka për gra.

T'i bëjmë ligjet e tjera, e këtë e bëjmë pas 3-4 vjetësh. Prandaj, të nderuar deputetë, dijeni mirë që ky është një amendament që shkel të drejtat absolute të ndërmarrjeve private.

KRYESUESI: Zoti Zemaj e ka fjalën, s'qenka këtu. Zoti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Ky debat po tregon edhe një herë cili është niveli, respektivisht cilat janë vlerat që ne jo veç si shoqëri, por edhe këtu si Kuvend kemi sa i përket barazisë gjinore.

Para pak ditësh kemi pasur një debat interesant dhe të rëndësishëm kundër dhunës ndaj grave. Jam i habitur që sot në këtë Kuvend me të njëjtën përmbajtje ka tendenca të instalimit të dhunës ndaj grave përmes kundërshtimit të krijimit të kushteve që gratë të përfshihen në qeverisje ekonomike. Ajo që më habit më së shumti është që nga të gjithë diskutuesit e deritanishëm, asnjë, përveç Visar Ymerit, nuk pati që mbrojti këtë amendament për barazinë e grave, ndërsa të gjithë diskutuesit e tjerë që janë meshkuj e kundërshtuan këtë amendament. Ndërsa, nga ana e grave qenë të gjitha, pavarësisht nga partia politike që kjo çështje të rregullohet kështu siç është propozuar me ligj.

Barazia nuk është ekstreme, nuk është ekstremitet, barazia është e drejtë fundamentale. Barazia nuk është çështje private, nuk do të thotë që dikush në ndërmarrjet private mund të bëjnë çfarë të dojë, ne jemi edhe si grup i ri parlamentar të interesuar ta mbështesim këtë amendament dhe besoj që edhe nga deputetët meshkuj do të ketë të tillë, të cilët do ta mbështesin këtë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

E para, po më vjen shumë keq që ky debat po shndërrohet në njëfarë lloj debati mes dy gjinive. Nuk korrigjohet pabarazia me rregullativa, shihni shefat e grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës, të gjithë janë burra, shihni Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, shumica janë burra. Zoti Topalli, nuk korrigjohet pabarazia gjinore duke e rregulluar barazinë gjinore te fqinjët, përpara se në shtëpinë tënde. Realisht është tepër pretenduese të kërkohet, për shembull, që ne t'u imponojmë kompanive private 40% të pjesëmarrjes së grave në bordet e tyre, ndërkohë që nuk jemi aspak të gatshëm ta bëjmë të njëjtën gjë në shtëpinë tonë.

E ka dhënë një sqarim për mendimin tim bukur përmbajtjesor shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Krasniqi. E dëgjova edhe zotin Zeka dhe Bilall Sherifin, unë besoj për shembull, që ne nuk kemi nevojë që tash të dalim kush është për barazi të grave dhe kush kundër, po besoj që ky votim i këtij amendamenti në thelb është diskriminues. Leni gratë të marrin pjesë me 50%, me 60% atje ku munden, por jo përmes rregullativave, se rregullativat në thelb janë diskriminuese.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do të votojë kundër, sepse beson fuqishëm se një amendament i tillë është ndërhyrje flagrante në lirinë e të bërit biznes në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Thënë të drejtën, nuk desha që të kyçem, por po mendoj se është shumë me rëndësi të potencoj atë se barazia nuk krijohet vetëm me rregulla, por ajo edhe fitohet. Duke krijuar rregulla strikte, obligative, të kësaj natyre, unë po mendoj se gjinia femërore po pasivizohet.

Në anën tjetër, ne e dimë se në institucionet publike është e rregulluar me përqindje, por edhe në këtë drejtim ka pabarazi mes vetë gjinisë femërore, sepse ta zëmë, në Parlament ke femra që janë me nga 20 -30 mijë vota dhe ke femra që janë me nga 200 vota. Atëherë shtrohet pyetja, çfarë barazie është brenda të njëjtës gjini? Unë prita nga Blerimi që, në fakt, meqë ka një ndërmarrje private, një kompani me qenë më konkret, por ndërhyrja e kësaj natyre në bizneset private është edhe një mundësi që bizneset të bëhen të papërgjegjshëm. Unë në këtë drejtim do t'i marr dy momente interesante, të cilët janë përditshmëri e jetës sonë. Ta zëmë, ne kemi ndërmarrje ndërtimore, të cilat obligohen për shkak të kërkesave në tregun e punës që të kenë inxhinierë, në fakt i paguajnë deri në 900 euro apo 1 mijë e 200 euro diplomën e një inxhinieri, ndërsa inxhinieri kurrë nuk shkon në punë.

Ose barnatoret. Për t'u licencuar, duhet pasur një person të diplomuar në farmaceutikë dhe, në anën tjetër, ai kurrë nuk shkon në barnatore dhe punojnë njerëzit joprofesionistë dhe ne në këtë drejtim, nëse i obligojmë ndërmarrjet private të jenë 40%, ato mund të figurojnë edhe në letër, por në fakt, nuk po e rregullojmë domethënë, nuk po e bëjmë atë që po pretendojmë. Më shumë mendoj se kjo tendencë për ta futur këtë nen ka të bëjë më shumë me fushatë, ose prezantim individualë të deputetit, se realisht të realizuar si qëllim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përnjëmend, e keni ndërmend të bëni fushatë elektorale krejt, a qysh është puna? Hajde, zonja Halimaj, edhe ti e ke fjalën.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Nëse barazia na qenka e drejtë elementare, atëherë nuk e kuptoj pse u bëjnë të padrejta grave. Nuk po mund ta kuptoj këtë vullnetin e grave që t'i kufizojnë vet gratë. Pra, pse zonja e cila ka paraqitur këtë amendament nuk i ka kufizuar burrat duke thënë që në Bord të jenë 40% e burrave, pse grave, bre? Pse jemi të pritura t'i dallojmë ato? Pse jemi të pritura t'i kufizojmë ato? Çka, nëse në një ndërmarrje në Bord do të duhej të ishin 100% gra? Pse more ta kufizojmë vetveten?

Nuk mendoj se bëjmë ndërhyrje të mirë, prandaj uroj që vota ime të mos keqkuptohet. Unë jam kundër.

KRYESUESI: Zoti Adem Mikullovc i ka fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Të nderuar deputetë,

E kam vetëm një lutje. Të mos vazhdojmë sikur dje që e patëm "kodër pas bregut". Po përsëriten gjërat. Kjo është krejt e qartë. Nuk kemi të drejtë t'ua imponojmë kompanive private kënd ta marrin në punë e qysh ta marrin në punë. Kaq! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Së pari kolegut tonë Hajdar Beqës i uroj lindjen e djalit. Ju them që vota ime do të jetë për këtë amendament të zonjës Kusari-Lila.

KRYESUESI: Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Përshëndetje, të nderuar!

Unë vetëm desha ta marr fjalën dhe t'i potencoj disa gjëra, pasi që pothuajse tërë jetën profesionale jam marrë me të drejtën korporatave dhe e kam përcjellë edhe imponimin e kuotave nëpër vende të ndryshme të Botës. Desha të kontribuojë në aspekt faktik, se sa në dhënien e një mendimi të caktuar. E vërteta qëndron se disa shtete të Evropës Perëndimore kanë imponuar kuota të tilla, si Norvegjia, Spanja, Italia, pastaj edhe Gjermania kohëve të fundit. E vërteta, ose fakti tjetër qëndron që këto kuota nuk janë imponuar në mënyrë të përgjithshme por janë imponuar për disa lloje dhe për kompani të madhësive të ndryshme, do të thotë kompani që janë me numër më të lartë të aksionarëve.

Njëkohësisht, duhet ta kemi parasysh edhe anën tjetër të medaljonit, që është çështja e ngarkesës dhe vështirësisë që bizneset në Kosovë kanë për të operuar dhe çfarëdo ngarkese shtesë, besoj që do të indikonte ata në aspekt negativ, por në të njëjtën kohë duhet të balancohet ajo edhe me

gjendjen alarmante që ekziston sa i përket pjesëmarrjes së gruas edhe në vende të punës, po edhe në menaxhimin e korporatave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Topalli e ka fjalën dhe le të përgatiten, të fundit janë dy diskutueset, njëra në emër të komisionit dhe tjetra si sponsorizuese e amendamentit.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Faleminderit për fjalën!

Me të vërtetë u diskutua gjerë e gjatë për këtë amendament. Morëm opinione të ndryshme në raport me këtë temë. Qëllimi është shumë i mirë, mirëpo realisht ne jemi qytetarë të këtij vendi dhe i dimë të gjitha shqetësimet që po ndodhin për çdo ditë në ndërmarrjet private, sidomos kur po është edhe kriteri i punësimit për femrat, puna e tepërt që po u ngarkohet punëtorëve për çdo ditë, kështu që përkundër asaj se ne e dimë që Kosova është ekonomi e tregut të lirë dhe po shihet se ka edhe arsyetime të bollshme, që neve po na japin një sinjal që po punojnë kundër asaj se... kundër Kushtetutës, unë konsideroj se është e drejtë e secilit që këtu sot të japim një votë. Vota ime është për. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë po e toleroj edhe zonjën Myfera Shinik, meqenëse nuk ka diskutuar dhe është përfaqësuese e Grupit “6+”. Të tjerë të mos paraqiten se kemi diskutuar mjaft. Tash fjalën e ka njëherë Mimoza Kusari-Lila, pastaj Sala Berisha, e më vonë Mufera Shinik, fjalën dhe e mbyllim me deputetë.

MÜFERA SERBICA-ŞINIK: Teşekkür ederim sayın başkan vekili. Bugün bu amandmanın burada konuşulması gerşekten Kosovada cinsiyet eşitliğinin olmadığının bir kanıtıdır. Kadınlar eğer bir toplumun bütün dünyada yüzde 50’sini oluşturuyorsa yüzde 30’luk yasadaki kota burda öngörülen öneriler yasa tasarısındaki yüzde 40’lık kotayı ben kadınlara karşı bunu az görüyorum hatta hakaret görüyorum. Eğer ki bir toplum yüzde 50’si ile kadınlarda oluşturuyorsa bunun yüzde 50 olmasını temmeni ediyorum ve öneriyorum.

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kusari-Lila, e keni fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Falënderoj të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës për debatin!

Po konsideroj që vetëm dy-tri sqarime të cilat e pashë se u prezantuan si të keqkuptuara, e para ky ligj ose ky amendament prek vetëm shoqëritë aksionare. Do të thotë, jo të gjitha ndërmarrjet, se u fol këtu për ndërmarrje të vogla, u përmendën edhe feramat, do të thotë janë 240 afërsisht

shoqëri aksionare në Kosovë, të cilat edhe me ligj kanë përgjegjësi publike. Ato raportojnë tek Bordi për mbikëqyrje financiare në Ministrinë e Financave.

Prandaj, nuk mundemi përgjegjësinë publike për raportim financiar me e marrë për të qenë, ndërsa përgjegjësinë publike për barazi me thënë, jo se qenka shkelje. Përderisa, shteti me politikat e veta, natyrisht ka politika tatimore e politika tjera, të cilat drejtpërdrejtë ndikon në ndërmarrjet private apo vetëm shoqëritë aksionare, për çka është edhe ky amendament.

Gjithashtu, vetëm një rikujtim për të gjitha gratë dhe burrat deputetë në këtë Kuvend të Kosovës. Nëse nuk do të ishte kuota ne nuk do ta kishim sot grupin më të madh parlamentar, Grupin e Grave në Parlamentin e Kosovës, kjo përfundimisht nuk ka të bëjë as me fushatë elektorale, as nuk ka të bëjë me çështje të votave, ka të bëjë me barazi në shoqëri për një kategori të bizneseve që e kanë mundësinë e angazhimit dhe për një kategori të grave profesionale, që kanë mundësi të angazhohen. Ndërsa, sikur të mos ishte ky amendament në rrethana tjera nuk do të ishin. Gjithashtu, konsideroj se diversiteti dhe llojllojshmëria në secilën ndërmarrje private, në shoqëri aksionare sjell përfitime më të mëdha të dokumentuara çdo kund anembanë Botës, prandaj ne nuk mund të jemi përjashtim i rastit. Faleminderit të gjithëve dhe natyrisht, i ftoj të gjithë që ta mbështetin këtë amendament.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Berisha, e keni fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Shumë mirë bërë që i dhe fund këtij debati, sepse edhe mu a po më duket shumë i panevojshëm. Veç po dua të rikujtoj diçka. Ky debat në lidhje me këtë amendament mendoj se nuk e la një shije shumë të mirë, sepse shpërfaqti mendësi jo të këndshme dhe në emër të dy pozicioneve. Një pozicion në emër të mbrojtjes së bizneseve dhe mos cenimit të privatësisë, asaj që është private dhe një pozicion tjetër, në emër të fuqizimit të gruas.

Unë po dua veç ta rikujtoj një rast, kur në vitin 2007 është vendosur që me Ligj zgjedhor të votohet me lista të hapura, duke besuar shumë në mbështetjen e grave ndaj njëra-tjetrës e i pata thënë një kolegut tim, zyrtar i lartë i partisë, se do ta shihni Kuvendin e Kosovës 70% gra, 30% burra, duke u bazuar në atë sepse burrat janë më të zotët në shtyrje të bërrylave për të ecur përpara dhe për të marrë pozita. Ndërkohë që nuk ndodhi ashtu siç mendova. Ne si gra kemi obligim, këto që jemi në pozita të larta vendimmarrëse, të punojmë e të krijojmë hapësirë sa më të madhe për gra dhe mbështetje më të madhe në fuqizimin e tyre.

Megjithatë, nuk është qëllimi ynë të bëjmë debalanca tjera në rregullimin e jetës. Po rikujtoj edhe diçka tjetër, se në vitin 2015 kam qenë në një pozitë të tillë, kur është bërë plotësim-ndryshimi i Ligjit për ndërmarrjet publike dhe pata kërkuar nga kolegët e mi në komision që ta mbështesin amendamentin i cili parasheh 50% përfshirjen e grave në borde të ndërmarrjeve publike. Sot jemi

në vitin 2018 dhe nuk është zbatuar asnjë herë kjo dispozitë ligjore. Kështu që, ne kemi shumë punë për të bërë. Nuk është zbatuar aty ku e kemi mundësinë me i kontrollua vet, dhe kemi mundësinë që nuk prishin kurrfarë balance. Sidoqoftë, kjo është shoqëria jonë e cila është e tillë dhe asnjëherë nuk më shkon mendja që personalisht të zhgënjehem.

Sidoqoftë, pavarësisht prej prononcimit apo përcaktimit të kolegëve dhe kolegeve të mija deputete lidhur me këtë amendament unë do të vazhdoj t'i respektoj edhe kolegët edhe koleget, ashtu si edhe më parë dhe jemi bashkërisht në luftën tonë për ta zhvilluar Kosovën, para së gjithash. Natyrisht, për t'i përfshirë të gjithë qytetarët, pa dallim gjinie dhe pa i paragjykuar asnjëherë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E qes në votim amendamentin e 12-të të deputetes Mimoza Kusari-Lila, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Kanë votuar 94 deputetë, 54 vota janë për, 35 vota kundër, 5 abstenime. Konstatohet se është miratuar amendamenti i 12-të i Zonjës Kusari-Lila. Ju kërkoj ndjesë, amendamenti ka pasur... Vjosa, e ka paguar veten debati.

Amendamenti i dytë, e kemi kaluar pa e kontrolluar unë, me gabimin tim, është deputeti i Korab Sejdiut, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Meqenëse, është pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, nuk llogaritet i merituar, prandaj duhet të rikthehem edhe një herë që ta votojmë me elektronikë. Në qoftë se, dikush ka diçka, ose deputeti Korab Sejdiu, ose kush e do fjalën? Zoti Sejdiu e ka fjalën. Edhe komisioni nëse do edhe jo më shumë. Faleminderit!

Zoti Sejtiu, e keni fjalën.

KORAB SEJDIU: Ky amendament, në fakt, është bërë vetëm sepse në kontekst të nomenklaturës si term është i gabueshëm, pasi që jo të gjitha ndërmarrjet në Kosovë merren me tregti dhe jo të gjitha ndërmarrjet janë shoqëri, pasi që kemi edhe biznese individuale dhe terminologji më e mirë do të ishte "ndërmarrje afariste" do të thotë që emri ose titulli i ligjit të jetë "Ligji për ndërmarrjet afariste":

KRYETARI: Faleminderit! Nga komisioni nuk është paraqitur askush. Atëherë, kalojmë në votim elektronik.

Edhe një herë, amendamentin e dytë të cilin më parë e patëm miratuar në votim me... pa elektronikë. Votojmë tani!

Kanë votuar 78 deputetë, 34 vota janë për, 38 kundër, 6 abstenime. Nuk miratohet amendamenti i dytë.

Vazhdojmë me amendamentin e 13-të nga deputeti Korab Sejdiu me përkrahjen e Komisionit Funksional. Kundër s'ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 14 i Komisionit Funksional.
Kundër s'ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 15 i Komisionit Funksional.
Kundër s'ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 16 i deputetit Korab Sejdiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Zoti Sejdiu, e dëshironi fjalën? Fjala për ju!

KORAB SEJDIU: Tash fillojmë me disa amendamente që i kam bërë, që janë të natyrës tërësisht teknike dhe burojnë nga praktika. Kjo ka të bëjë me dokumentacionin që mbahet tek një shoqëri tregtare, përfshirë edhe ato kontabile dhe në praktikë çka ndodh shpesh është që kontabilisti, veçanërisht te bizneset që janë më të vogla dhe që nuk kanë kontabilistë brenda shoqërisë tregtare, ata natyrisht që dokumentacionin e tyre financiar e mbajnë te kontabilisti, ndërsa me ligj këtu po obligohen që në vazhdimësi ta mbajnë në zyrën e shoqërisë tregtare.

Kjo në praktikë paraqet një obligim që me siguri edhe nuk do të zbatohet, po do të jetë një pengesë e panevojshme dhe që nuk ka kurrfarë përfitimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga komisioni e dëshiron dikush fjalën? S'ka të paraqitur. Atëherë e fus në votim elektronik amendamentin 16 të deputetit Korab Sejdiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tani.

Kanë votuar 85 deputetë. 46 janë për, 35 kundër, 4 vota janë abstenim. Miratohet amendamenti 16 i deputet Korab Sejdiu.

Amendamenti 17 i deputetit Korab Sejdiu me përkrahjen e Komisionit Funksional. Kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 18 i Komisionit Funksional.
Kundër s'ka. Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 19 i deputetit Korab Sejdiu pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Zoti Sejdiu e dëshironi fjalën?

KORAB SEJDIU: Faleminderit!

Edhe një herë, në këtë rast thjesht e kam bërë një përkthim pak më të mirë, sepse versioni aktual i kësaj dispozite nuk ka kuptim në mënyrën se si është përkthyer prej anglishtes dhe do të ketë problem të jashtëzakonshëm në zbatim, prandaj nuk është se kam shtuar diçka të re, po atë që kanë dashur ata ta përkthejnë e kam përkthyer pak më mirë, me qëllim që mos me krijua probleme në praktikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E fus në votim amendamentin e 19 të deputetit Korab Sejdiu pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tani!

Kanë votuar 77 deputetë. Për janë 51, kundër 25, 1 abstenim. Konstatohet se është miratuar amendamenti 19 i zotit Sejdiu.

Amendamenti 20 i deputetit Sejdiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tani! A dëshiron sqarim? Po, zoti Sejdiu dëshiron sqarim.

KORAB SEJDIU: Kemi ardhur te një grup i amendamenteve të cilat janë të ndërlidhura me njëri-tjetrin dhe kjo buron nga një problem që është paraqitur për bizneset e Kosovës, të cilat janë themeluar si biznese individuale dhe në rritjen e tyre kanë dëshiruar që ta ndërrojnë statusin e tyre juridik prej biznesit individual ose ortakërisë, në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare.

Me insistimin e botës së biznesit në Kosovë, kjo është lejuar. Me legjislacionin aktual nuk është shprehimisht, por është lejuar nga ORBK-ja edhe në bashkëpunim me ATK-në. Mirëpo, fatkeqësisht, kjo që veç është duke ndodhur nuk është paraparë në ligjin aktual. Çka paraqet kjo? Edhe ju kisha lutur për vëmendje, sepse është një problem jashtëzakonisht i madh për bizneset e Kosovës, të cilat për shkak se në një periudhë kohore nuk janë lejuar të shndërrohen dhe janë detyruar ta shuajnë biznesin disavjeçar e të fillojnë një biznes tjetër, kanë humbur referencat e tyre me ç'rast janë përjashtuar nga grande multimilionëshe, qoftë nga Bashkimi Evropian ose nga donatorë të ndryshëm.

Kështu që, është jashtëzakonisht e rëndësishme për komunitetin e biznesit dhe këto amendamente, po flas prej këtij aktual e më tutje, janë bërë në koordinim dhe duke i dëgjuar edhe shqetësimet e botës së biznesit, përfshi edhe odat ekonomike. Kështu që, nuk ka të bëjë asgjë me ndonjë diçka të keqe, thjesht ka të bëjë me lehtësimin e operimit të bizneseve në Kosovë dhe avancimin dhe rritjen e tyre të mëtutjeshme në një ambient që nuk është dhe aq i mirë për bizneset. Ju falënderoj shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! E hap votimin për amendamentin 21, me elektronikë. Votojmë tani!

Kanë votuar 79 deputetë. 44 janë për. 33 kundër, 4 abstenime. Miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21, Deputeti Korab Sejdiu pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Zoti Sejdiu, e keni fjalën.

KORAB SEJDIU: Po, do të thotë kjo ndërlidhet tash, edhe 21-shi edhe 22-shi, janë në pako, do të thotë për ta mundësuar këtë shndërrimin, ose transformimin e shoqërive tregtare, që janë jokorporata, në korporata. Kështu që janë pako që duhet, ose krejt, ose asnjërin, sepse pastaj krijojmë konfuzion në ligj.

KRYESUESI: Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Por, seriozisht në bisedë me nënkryetarin e Komisionit edhe nuk ia jep fjalën pak më herët, joserioziteti i deputetit Sejdiu për një amendament këtu që gjuhësisht ta rregullojë dhe ta bëjë amendament për shkak të një rregullimi gjuhësor është një joseriozitet dhe këtu e kam përshtypjen që atëherë nuk po dimë edhe çka po votojmë. Seriozisht, nëse si deputet ka kërkuar që të bëhet amendament në komision dhe shumë herë ne kemi propozuar dhe propozojmë, por komisioni e pranon kur të ketë diçka teknike. Ama, nëse ti kërkon vetëm sa për tu dukur që është amendament yti dhe me të dalë emri yt përderisa thua që është krejt teknike, një rregullim gjuhësisht, unë mendoj që është shumë joserioze dhe normalisht që edhe ministri nuk e di a po e shikon telefonin a... nuk e di ku... asnjë reagim më të voglin, përderisa nënkryetari kërkoi fjalën dhe tha se një amendament që ne e propozuam nuk është dhe nuk do të duhej të votohej.

Prandaj, të jemi pak seriozë dhe ministri le të jetë këtu, a je këtu, a s'je këtu, a...

KRYESUESI: Deputetja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe unë desha ta bëj një sqarim të tillë, pikërisht këtë që e tha kolegja ime Teuta Haxhiu.

Unë kam tërhequr vërejtjen gjatë punës në fazën e amendamentimit të këtij projektligji në grupin punues, sepse ne e kemi në Kuvendin e Kosovës një zyrë për harmonizim dhe standardizim edhe të gjuhëve edhe shumë çështje tjera, që është e panevojshme të bëjmë amendament, mirëpo ajo për çka dua ta tërheq vërejtjen, më me rëndësi është se kisha dashur që kryesuesja që e ka udhëhequr grupin e punës gjatë fazës së amendamentimit, deputetja Hykmete Bajrami, ka qenë mirë të jetë këtu dhe me i dhënë arsyetimet, sepse ky projektligj është i njëjti projektligj kur ajo ka qenë ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe ka qenë krejt i gatshëm projektligji, ndërkohë që me të gjitha këto amendamente që i ka bërë deputeti Korab Sejdiu nuk është pajtuar, as Hykmetja e as komisioni. Tani, në qoftë se seanca i voton këto amendamente pa mbështetjen e komisionit, vërtet ligji do të ketë çrregullime dhe e ka një zbatim bukur të vështirë që lidhet me bizneset dhe me të tjerat.

Kështu që, kisha dëshiruar meqenëse deputeti e ka të drejtën për ta marrë fjalën që ta bind seancën për amendamentet e tij, është mirë të jetë këtu edhe Hykmete Bajrami dhe të tregojë pse komisioni nuk e ka mbështetur propozimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Kërkoj ndjesë prej deputetëve. Ndoshta, unë me vonesë e preka tastin, por amendamentet që u votuan më herët kanë të bëjnë me bartjen e referencave të një biznesi, i cili konvertohet, reregjistrohet apo shndërrohet prej biznesit individual në lloj tjetër të organizimit. Dhe, ky historik është çështje procedurale, që ne si komision e kemi trajtuar me ARBK-në dhe në atë formë jemi siguruar, që referencat për biznesin të barten e në të njëjtën kohë të mos krijojmë telashe ligjore e gjithashtu, edhe sa i përket obligimeve që mund t'i ketë një biznes individual e i cili mund të tentojë që ta heq historikun.

Pra, këtë e kemi trajtuar në komision dhe arsyeja pse kemi qenë kundër këtij amendamenti ka qenë fakti se referencat, bartjet e referencave të një biznesi prej një modusi operimi ligjor në një tjetër, është çështje komplet teknike. Pra, brenga e zotit Sejdiu është me vend, por kjo brengë nuk trajtohet me këtë amendament, trajtohet me procedurë të ARBK-së. Pra, një diskutim për këtë amendament u votua tashmë. Besoj që edhe proceduralisht tashmë është problematike me e kthye, por nuk do të duhej që këto tema që janë thjesht procedura të një institucioni të ndërtohen apo të mbivendosen në ligje.

Edhe për amendamentin për të cilin po votojmë, komisioni i ka diskutuar jo vetëm me anëtarë të komisionit, por edhe me ekspertë të jashtëm, temën e Ligjit për shoqëri tregtare, sepse është një prej ligjeve fundamentale që organizon botën, të themi, në shoqëri tregtare. Këto i kemi diskutuar. Ato amendamente që kemi konsideruar se janë në rregull i kemi përkrahur, ato që kemi konsideruar se krijojnë një lloj telashe në koherencën ligjore të këtij ligji, nuk i kemi përkrahur.

Këtë amendament tani që e kemi në votim është gjithashtu i tillë, pra ka implikime në rrjedhën dhe mendimin për ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamentit nr. 22. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 74 deputetë, 78 janë për, 44 kundër, 12 abstenime. Nuk miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.
Kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 24, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë me elektronikë. Zoti Korab Sejdiu, e dëshironi fjalën?

KORAB SEJDIU: Zoti kryesues!

Ato që u thanë më herët nuk qëndrojnë fare dhe me gjasë nuk i kanë hulumtuar mjaft problemet që kanë pasur bizneset nja dy vjet derisa ARBK-ja është bindur...

KRYESUESI: E kemi kaluar atë. Veç për këtë amendament...

KORAB SEJDIU: Po, po, po dua ta ndërlihdh me amendamentet tjera që janë në pako. Kjo është pako, domethënë ose i bën krejt ose asnjë. Tash, në aspekt procedural s'di qysh mund të shkojmë prapa, ose duhet me e heq edhe atë të parim që e bëmë, ose duhet krejt, tash... se është... do të thotë krejt procedura është dizajnuar në ligj me amendamente. Natyrisht ai që s'u votua, tash duhet tërhequr edhe këtë aktualin.

KRYESUESI: Cilin do ta tërheqësh, ti? Ne ata që i kemi kaluar, ti s'mund t'i tërheqësh. Këtë mund të kërkosh mos me ta votua, këtë po, ata që i kemi kaluar...

KORAB SEJDIU: Amendamentin 24 do të thotë. Po!

KRYESUESI: Atëherë, Korab Sejdiu e tërheq amendamentin 24, s'ka nevojë të votohet.

Amendamenti 25.

Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 26.

Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Faleminderit! Kanë votuar 71 deputetë. 68 deputetë janë për, 3 vota janë kundër, asnjë abstenim. Konstatoj që Kuvendi miratoi Ligjin nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.

20. Përzgjedhja e një kandidati për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar listën e kandidatëve të përzgjedhur nga paneli përzgjedhës i Bankës Qendrore për guvernator të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar përzgjedhjen e njërit prej kandidatëve të propozuar për guvernator të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, që të paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në bazë të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës Bordi i BQK-së ka emëruar panelin seleksionues për përzgjedhjen e kandidatit për guvernator të BQK-së.

Paneli ka njoftuar se ka zhvilluar procedurat e konkursit dhe pas vlerësimit të integritetit, kualifikimeve profesionale dhe performansës së aplikantëve të ftuar për intervistë, ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret formale dhe profesionale që kërkohen me Ligjin e BQK-së.

Kuvendi në bazë të nenit 32.8 të Ligjit për BQK-në përzgjedh kandidatin për pozitën e guvernatorit të Bordit të BQK-së bazuar në rekomandimet e panelit seleksionues të BQK-së dhe pas konsultimit me Qeverinë, e cila brenda afatit të paraparë ligjor prej 15 ditësh i ka dërguar Kuvendit mendimin dhe e cila është deklaruar se pajtohet me kandidatët e propozuar nga paneli seleksionues i Bankës Qendrore.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar propozimet e panelit seleksionues dhe ka vlerësuar se katër kandidatët e propozuar i plotësojnë kriteret formale juridike, të parapara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe i ka rekomanduar Kuvendit që me votim të fshehtë të përzgjedhë njërin prej katër kandidatëve të propozuar, të cilët janë: Fehmi Mehmeti, Shkëndije Himaj, Besnik Bislimi dhe Safet Merovci.

Më pas, kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi i dërgohet presidentit për miratim dhe emërim në pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në qoftë se grupet parlamentare dëshirojnë të deklarohen diçka lidhur me këtë çështje? Nuk dëshiron askush. Atëherë, besoj që të gjithë i dinë këto këshilla juridike, se s'e keni për herë të parë.

Në bazë të nenit 38, pika 2, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës nga lista e kandidatëve të propozuar Kuvendi i Kosovës përzgjedh një kandidat për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Pas zgjedhjes nga Kuvendi i Republikës së Kosovës do t'i dërgohet presidentit për miratim dhe emërim.

Komisioni ka përzgjedhur 4 kandidatë, por me ligj nuk është përcaktuar mënyra dhe forma e përzgjedhjes. Andaj, votimi do të jetë i fshehtë dhe kandidati që fiton shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, do të përzgjidhet për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kandidatët e propozuar janë:

1. Fehmi Mehmeti,
2. Shkëndije Himaj,
3. Besnik Bislimi dhe
4. Safet Merovci.

